



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 17

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 17

Janar-Dhjetor 2020

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
ISSB	Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MeF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJSHEF	Organizatata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2021),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 17, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	15
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	23
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	25
3.1. Ekonomia e brendshme-----	26
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	29
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	31
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	34
Kutia 2. Tërheqja e 10 përqind të mjetve nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)-----	34
4.1. Aktiviteti bankar -----	39
Kutia 3. Anketa e Kreditimit Bankar -----	44
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	50
5.1. Rreziku kreditor -----	51
Kutia 4. Masat e ndërmarra nga BQK për adresimin e sfidave të shkaktuara nga Covid-19-----	52
Kutia 5. Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF 9) dhe provizionimi i humbjeve -----	53
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit -----	58
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja -----	61
5.4. Kapitali-----	62
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	65
5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test -----	68
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	75
6.1 Sektori Pensional-----	75
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	77
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	81
7. Infrastruktura financiare në Kosovë-----	87
7.1. Sistemi i pagesave -----	87
8. Korniza për Makroprudencë -----	90
8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës -----	90
8.2. Kapitali shtesë kundërciklik -----	90
8.3. Bankat me rëndësi sistemike -----	92
9. Shtojca Statistikore -----	97

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	17
Grafik 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja	17
Grafik 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar	19
Grafik 4. Harta e stabilitetit financiar	23
Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar	24
Grafik 6. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje	26
Grafik 7. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve	26
Grafik 8. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor	27
Grafik 9. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial	29
Grafik 10. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë	29
Grafik 11. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja	29
Grafik 12. Borxhi i ndërmarrjeve	29
Grafik 13. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK	31
Grafik 14. Normat e interesit për ndërmarrjet	31
Grafik 15. Borxhi i ekonomive familjare	31
Grafik 16. Depozitat e ekonomive familjare	32
Grafik 17. Normat e interesit për ekonomitë familjare	32
Grafik 18. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së	34
Grafik 19. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar	36
Grafik 20. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar	37
Grafik 21. Struktura e asetëve të sektorit bankar	39
Grafik 22. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar	40
Grafik 23. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja	40
Grafik 24. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve	41
Grafik 25. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët	41
Grafik 26. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	41
Grafik 27. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	42
Grafik 28. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë	42
Grafik 29. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit	42
Grafik 30. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit	42
Grafik 31. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve	44
Grafik 32. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve	45
Grafik 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet	46
Grafik 34. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare	46
Grafik 35. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare	47
Grafik 36. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare	47
Grafik 37. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit	48
Grafik 38. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar	48

Grafik 39. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	50
Grafik 40. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	50
Grafik 41. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	51
Grafik 42. Kreditë e ristrukturuara, sipas fazave -----	51
Grafik 43. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla -----	52
Grafik 44A. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e vjetër -----	53
Grafik 44B. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re -----	53
Grafik 45. Kreditë joperformuese -----	56
Grafik 46. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	56
Grafik 47. Pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ndaj gjithsej kredive në sektorët pëkratës ---	57
Grafik 48. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	57
Grafik 49. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	58
Grafik 50. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	58
Grafik 51. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	59
Grafik 52. Kontribuuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	59
Grafik 53. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	59
Grafik 54. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	59
Grafik 55. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	60
Grafik 56. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	60
Grafik 57. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	60
Grafik 58. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	61
Grafik 59. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	62
Grafik 60. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	62
Grafik 61. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	62
Grafik 62. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	63
Grafik 63. Struktura e kapitalit rregullator -----	63
Grafik 64. Norma e levës -----	63
Grafik 65. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit -----	64
Grafik 66. Asetet e peshuara me rrezik kreditor -----	64
Grafik 67. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut -----	64
Grafik 68. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor -----	64
Grafik 69. Struktura e financimit -----	65
Grafik 70. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	65
Grafik 71. Struktura e depozitave -----	66
Grafik 72. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	66
Grafik 73. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	66
Grafik 74. Indikatorët e likuiditetit -----	67
Grafik 75. Rezervat e likuiditetit -----	67
Grafik 76. Hendeku i likuiditetit -----	68
Grafik 77. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit -----	70

Grafik 78. Rezultatet e stres testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi-----	71
Grafik 79. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 1 -----	73
Grafik 80. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2 -----	73
Grafik 81. Asetet e sektorit pensional-----	75
Grafik 82. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	75
Grafik 83. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensioneale-----	76
Grafik 84. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	76
Grafik 85. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	77
Grafik 86. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve-----	77
Grafik 87. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	77
Grafik 88. Asetet e sektorit të sigurimeve-----	77
Grafik 89. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve -----	79
Grafik 90. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	79
Grafik 91. Primet bruto të arkëtuara-----	79
Grafik 92. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	81
Grafik 93. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	82
Grafik 94. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar-----	82
Grafik 95. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit-----	83
Grafik 96. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik-----	83
Grafik 97. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare-----	83
Grafik 98. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	84
Grafik 99. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	84
Grafik 100. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	85
Grafik 101. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	85
Grafik 102. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	85
Grafik 103. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	86
Grafik 104. Hendeku i kreditimit-----	92
Grafik 105. Kapitali shtesë kundër-ciklik -----	92
Grafik 106. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike -----	93
Grafik 107. Kriteri i madhësisë -----	94
Grafik 108. Kriteri i zëvendësueshmërisë-----	94
Grafik 109. Kriteri i ndërlidhjes -----	94
Grafik 110. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit -----	95
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës -----	37
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës -----	38

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar-----	16
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë -----	25

Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare -----	33
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	37
Tabela 5. Klasifikimi i kredive, provizionimi dhe akumulimi i interesi sipas SNRF 9-----	54
Tabela 6. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor -----	72
Tabela 7. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit -----	73
Tabela 8. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit -----	74
Tabela 9. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	80
Tabela 10. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit-----	80
Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së -----	88
Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar-----	88
Tabela 13. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	89
Tabela 14. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë.	93

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) i prezanton publikut numrin e 17-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar dhe të rrisë transparencën e nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Dinamikat që e karakterizuan ekonominë globale në muajt e parë të vitit 2020 dhe kriza e paprecedent ekonomike dhe sociale që rezultoi si pasojë e përpjekjeve për të menaxhuar me krizën shëndetësore të pandemisë u përkthyen në rritje të rreziqeve për ekonominë dhe tregjet e jashtme financiare. Pasiguritë e shumta që po vazhdojnë të shoqërojnë përfundimin potencial të pandemisë si pasojë e vështirësive rreth vaksinimit masiv dhe efektivitetit të pakove monetare, fiskale dhe financiare për të mbështetur rimëkëmbjen, mund të dëmtojnë tutje besueshmërinë e akterëve në treg në muajt në vijim.

Shoku ekonomik i nxitur nga pandemia Covid-19 rezulton të jetë më i larti ndonjëherë në ekonominë e Kosovës. Ngjashëm me dinamikat në nivel global, rimëkëmbja e ekonomisë nga ky shok është subjekt i shumë pasigurive që ndërlihen me kohëzgjatjen e pandemisë dhe efektet zingjirë të vazhdimësisë së krizës shëndetësore dhe dinamikave politike të cilat kanë efekt të drejtpërdrejtë në efektivitetin e realizimit të planit të rimëkëmbjes.

Efkti i shokut ekonomik në performancën financiare të agjentëve ekonomikë paraqet rrezikun kryesor ndaj sistemit financiar dhe stabilitetit të tij. Masat fiskale dhe financiare të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) kanë zbutur efektin e menjëhershëm të pandemisë në ambientin makroekonomik dhe stabilitetin financiar.

Në vitin 2020, në kushtet e ballafaqimit me krizën pandemike, BQK ka adaptuar kornizën rregullative dhe ka ndërmarrë vendime prudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbështetjes së kredimarrësve dhe ekonomisë së vendit.

Megjithatë, në afat të mesëm, dobësitë ndaj stabilitetit financiar janë rritur si pasojë e rritjes së nivelit të borxhit dhe dobësitit të aftësisë paguese të sektorit privat, dinamika që pritet të reflektohen në rrezik të shtuar kreditor në periudhën në vijim.

Treguesit e shëndetit të sektorit bankar në vitin 2020 qëndruan në nivele të larta, të përafërta me vitin paraprak, pa ndonjë përkeqësim si pasojë e krizës pandemike. Ngjashëm, edhe pozita e likuiditetit të sektorit bankar ka mbetur e favorshme, me rritje në treguesit kryesorë të likuiditetit në periudhën raportuese.

Në kuadër të sistemit financiar, me ngadalësim të aktivitetit u karakterizuan sektori pensional dhe sektori mikrofinanciar, ndërlidhur me efektet negative që i atribuohen kryesisht pandemisë Covid-19. Në këtë periudhë, rritje e aktivitetit u shënuar tek sektori bankar, sektori i sigurimeve dhe sektori i ndihmësve financiar.

BQK ka vazhduar punën në fushën e makroprudencës, duke mbikëqyrë zhvillimet në indikatorët makroprudencë në Kosovë. Me qëllim të promovimit të stabilitetit financiar, BQK ka vazhduar punën në plotësimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative të sistemit financiar në përgjithësi dhe sektorit bankar në veçanti, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar.

Fehmi MEHMETI

Guvernator

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Përhapja e pandemisë Covid-19 ka rritur ndjeshëm rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Goditja ekonomike e nxitur nga përhapja e pandemisë ishte më i larti ndonjëherë në ekonominë e Kosovës, dhe ecuria e rimëkëmbjes po shoqërohet me shumë pasiguri që ndërlidhen me kohëzgjatjen e pandemisë, shkallën e masave parandaluese të përhapjes së saj, si dhe efektivitetin e masave në planin e rimëkëmbjes ekonomike. Efekti i goditjes ekonomike në performancën financiare të agjentëve ekonomik paraqet rrezikun kryesor ndaj sistemit financiar dhe stabilitetit të tij. Masat lehtësuese të ndërmarra nga qeveria si dhe Banka Qendrore, në linjë me masat e ndërmarra në nivel global, kanë zbutur bartjen e efektit të menjëhershëm të pandemisë në sistemin financiar. Por, në afat të mesëm, dobësitë ndaj stabilitetit financiar janë rritur si pasojë e dobësisë të aftësisë paguese të sektorit privat, përkatësisht rënies së qarkullimit të ndërmarrjeve dhe nivelit të ardhurave të ekonomive familjare, dinamika që priten të reflektohen në rrezik të shtuar kreditor.

Pasiguritë e vazhdueshme rreth pandemisë kanë ndikuar në rritjen e rreziqeve për sistemin financiar dhe stabilitetin e tij. Masat kufizuese të lëvizjes së qytetarëve dhe ndërprerjet në funksionimin e rregullt të ndërmarrjeve kanë ndikuar dhe vazhdojnë ende të ndikojnë në aftësinë e tyre për realizimin e të ardhurave, e që pritet të krijoj vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare dhe rritjen e kreditimit. Ndikimi është asimetrik ndërmjet sektorëve ekonomik, me ç'rast sektorë të caktuar si ai i shërbimeve janë prekur më shumë, reflektuar edhe nga të dhënat e qarkullimit të këtij sektori dhe kredive të ristrukturuara. Kjo situatë ka ndikuar edhe punëmarrësit dhe të ardhurat e ekonomive familjare, pasi rënia e aktivitetit të

ndërmarrjeve ka rezultuar në rritje të papunësisë dhe reduktim të nivelit të të ardhurave, që në një masë është kompensuar nga dërgesat më të mëdha të diasporës. Masat ndihmëse qeveritare si dhe lehtësimet rregullative të BQK-së, të cilat u ndërmorën në kohë dhe në linjë me masat lehtësuese të ndërmarra në nivel global, ndihmuan në mbështetjen e ekonomisë dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Sektori bankar hyri në fazën e pandemisë me nivele të larta të tregueseve të shëndetit financiar të cilët i krijoi ndër vite. Andaj, përkundër rënies së të ardhurave të sektorit - të ndikuar nga ngadalësimi i aktivitetit kreditor, masat lehtësuese/ristrukturimet, rritja e kredive joperformuese si dhe shpenzimet më të larta për provizione - treguesit e shëndetit financiar mbesin në nivele të larta për absorbim të humbjeve të mundshme.

Ambienti makroekonomik i brendshëm dhe i jashtëm u karakterizuan me rritje të theksuar të rreziqeve si rezultat i pandemisë Covid-19, të cilat u reflektuan në zhvillime të pafavorshme për sistemin financiar. Perspektiva ekonomike dhe ndikimi i saj në sistemin financiar vazhdon të ndikohet nga një shkallë e lartë e pasigurisë, që ndërlidhet me kohëzgjatjen e pandemisë. Masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së pandemisë kanë ndikuar në rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në vitin 2020 në të gjitha vendet anëtare të Eurozonës dhe në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ekonomia e Eurozonës, partnerit kryesor tregtar të Kosovës dhe vendit me origjinën më të lartë të remitencave, në vitin 2020 ka shënuar rënie prej mesatarisht 6.6 përqind. Ballkani Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare ekonomike prej 5.6 përqind, e cila ishte më e theksuar në shtetet si Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Ekonomia e Kosovës, e cila ka varësi të lartë nga diaspora dhe eksporti i shërbimeve të udhëtimit nga vizitat e diasporës në Kosovë, u ndikua konsiderueshëm nga përhapja e pandemisë. Rënia e investimeve si dhe rënia e shërbime të eksportit ishin komponentët dominuesë me ndikim në rënie prej 3.9 përqind të aktivitetit ekonomik në vitin 2020.

Tabela 1. Rrezikët kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar sektorit bankar*

Rrezikët	2018	2019	TM1 2020	TM2 2020	TM3 2020	TM4 2020	Trendi i rrezikut
Rrezikët							
Rreziku makroekonomik	Yellow	Green	Yellow	Red	Red	Red	Down
Rreziku kreditor	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Up
Rreziku në të hyrat (profitabiliteti)	Green	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Yellow	Up
Qëndrueshmëria e sektorit							
Kapitalizimi	Green	Green	Green	Green	Green	Green	Down
Likuiditeti dhe financimi	Green	Green	Green	Green	Green	Green	Up
<p>Qëndrueshmëri e lartë Q. Mesatare Q. e ulët Q. e shumë e ulët</p> <p>Rrezik i ulët Rrezik i mesëm Rrezik mbimesatar Rrezik i lartë</p>							

Burimi: BQK.

*Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar bazohet pjesërisht në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës (sipas së cilës vlera e treguesëve kryesorë përkatës notohet në relacion me historikun e tij) si dhe në vlerësimin e gjykimit të analistëve.

Kahja e shigjetës sugjeron për tendencën e rrezikut/qëndrueshmërisë në periudhën e fundit (tremujorin e fundit), si dhe pritjet për zhvillimet në periudhën vijuese një vjeçare.

Rënia ekonomike e shkaktuar nga pandemia Covid-19 paraqet sfidën më të madhe të përjetuar ndonjëherë në ekonominë e Kosovës. Pas lehtësimit të masave të kufizimit të lëvizjes të ndërmarra në tremujorin e dytë, pandemia ka vazhduar të përhapet me ritëm më të shpejtë në Kosovë në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe në vitin 2021, duke rritur pasigurinë rreth prospekteve të aktivitetit ekonomik dhe për pasojë, sistemit financiar. Aktiviteti ekonomik në Kosovë ka shënuar rritje prej 1.3 përqind në tremujorin e parë, dhe rënie prej 9.3 përqind dhe 7.3 përqind respektivisht në tremujorët pasues. Në tremujorin e katërt është shënuar rritje e aktivitetit ekonomik prej 0.7 përqind. Vlerësimet preliminare të ASK-së për rritjen mesatare të BPV-së në vitin 2020 sugjerojnë për rënie prej 3.9 përqind. Aktiviteti ekonomik pritet të rikuperohet drejt niveleve të para krizës, përkatësisht rritje vjetore prej 4.3 përqind gjatë vitit 2021, por këto pritje janë subjekt i pasigurive të mëdha të ndërlidhura me kohëzgjatjen e pandemisë dhe shkallën e masave kufizuese, programin e vaksinimit, rimëkëmbjen ekonomike të vendeve të EU-së,

efektivitetin e planit të rimëkëmbjes ekonomike, si dhe aftësinë e sektorit privat për të përshtatur modelet e biznesit konform rrethanave të reja. Zgjatja e pandemisë rritë rrezikun për rimëkëmbje ekonomike marrë parasysh ngushtimin e hapësirës fiskale për mbështetje të rritjes, si rezultat i të hyrave më të ulëta dhe shpenzimeve më të larta në vitin 2020 për të zbutur efektet e menjëhershme të krizës nga pandemia.


Masat qeveritare për adresimin e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19 kanë ndikuar në rritjen e deficitit buxhetor si dhe borxhit publik. Të hyrat buxhetore shënuan rënie vjetore prej 8.8 përqind ndërsa shpenzimet u rritën për 6.5 përqind. Si rezultat, deficitit buxhetor arriti në 7.1 përqind të BPV-së. Me rritje prej 23.9 përqind u karakterizua edhe borxhi publik, që arriti vlerën prej 1.5 miliardë euro. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik arriti në 21.8 përqind nga 17.5 përqind në dhjetor 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 21.5 përqind (i cili ka arritur në 961.9 milionë euro), dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 28.6 përqind duke arritur në 525.8 milionë euro.

* Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut bazohet në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës. Ndërtimi i kësaj table përfshinë shtesë treguesin e Zhvillimeve kreditore dhe atë të Ekspozimeve. Treguesi i Zhvillimeve kreditore përfshinë nën-treguesit si: Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së, Rritja e kreditimit të sektorit privat, Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së, si dhe rritjen në sektorët e veçantë si ai i ndërmarrjeve

dhe atë të ekonomive familjare. Përderisa, në llogaritjen e Qëndrueshmërisë së sektorit bankar, përveç treguesve të hartës së Stabilitetit Financiar është shtuar edhe treguesi i Ekspozimeve, i cili matë ekspozimet e sektorit bankar ndaj letrave me vlerë të qeverive, kreditë në valutë, pjesëmarrjen e detyrimeve të jorezidentëve si dhe pozicionet e hapura në valutë.

Trendi i rritjes së borxhit të brendshëm të sektorit privat është ngadalësuar, ndikuar nga ngadalësimi i rritjes kreditore, ndërsa borxhi i jashtëm për ndërmarrjet ka shënuar rritje. Pandemia Covid-19 ndërpreu trendin ndër vite të rritjes dyshifrore të kreditimit të sektorit privat. Stoku i kredisë së ndërmarrjeve nga sektori bankar ngadalësoi rritjen në 7.2 përqind nga 9.8 përqind një vit më parë, kryesisht si rezultat i përgjysmimit të rritjes së kredive të reja në 4.4 përqind (9.7 përqind rritje në 2019). Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiar, të cilat kanë peshë të ulët në gjithsej kreditë, shënuan rënie prej 1.9 përqind. Ndërsa borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve ka shënuar rritje prej 26.0 përqind duke arritur në 25.0 përqind të gjithsej borxhit nga 22.0 përqind sa ishte në vitin 2019.

Grafik 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, në milionë euro




Burimi: BQK.

Kreditë e sektorit bankar ndaj ekonomive familjare ngadalësuan rritjen në 7.1 përqind nga rritja vjetore 10.4 përqind një vit më parë, si rezultat i rënies vjetore prej 2.4 përqind të kredive të reja. Ndërsa, kreditë nga institucionet tjera financiare si dhe borxhi i jashtëm shënuan rënie prej 9.2 përqind dhe 19.9 përqind respektivisht. Për të mbështetur vazhdimin e kreditimit të ekonomisë nga sektori bankar, janë ndërmarrë masa lehtësuese operative dhe rregullative nga BQK, si dhe masa mbështetëse për qasje në financa. Roli i Fondit Kosovar për Garanci

Kreditore (FKGK) është fuqizuar tutje dhe zë vend kyç në planin e rimëkëmbjes ekonomike.

Sipas Anketës së Kreditimit Bankar,² dinamika e aktivitetit kreditues për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare, në gjysmën e parë të vitit u ndikua negativisht si nga oferta ashtu edhe nga kërkesa kreditore, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit oferta dhe kërkesa shënuan përmirësim. Faktorët kryesor që ndikuan në përmirësimin e ofertës kreditore ishin mbështetja e ndërmarrjeve nga FKGK, përmirësimi i perspektivës në tregjet globale, si dhe masat lehtësuese të ndërmarrja për menaxhimin e efekteve të pandemisë (ristrukturimet).

Grafik 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja



Burimi: BQK.

Kërkesa për kredi u përmirësua, por me ndryshime më të mëdha mes segmentëve. Në mesin e ndërmarrjeve, kërkesa nga korporatat shënoi rënie, ndërsa për NVM-të u rrit deri në një masë, për financim të nevojave operative. Kërkesa nga ekonomitë familjare shënoi rritje, por më e theksuar për kreditë hipotekare në krahasim me ato konsumuese. Pritjet e bankave për dinamikën e kreditimit në TM1 2021 ishin optimiste, nën supozimet e mbështetjes së kreditimit nga FKGK si dhe rimëkëmbjen ekonomike. Sidoqoftë, bankat deklaruan rritje të rreziqeve në ambientin e funksionimit të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, dhe rrjedhimisht rritje të rrezikut kreditor.

Pozicioni financiar i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare është përkeqësuar si

² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga BQK për të spiëguar dhe kuptuar më mirë dinamikën e kreditimit në vend. Për më shumë informata,

raporti i plotë i Anketës së Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit mund të gjindet në web faqen e BQK-së, përdërisa një përmbledhje e saj mund të gjindet në Kutinë 3.

pasojë e pandemisë Covid-19. Dobësitë e rritura të sektorit privat dhe ecuria e rimëkëmbjes së tij pritet të ndikojnë ecurinë e rreziqeve për sektorin bankar.

Masat kufizuese për parandalimin e pandemisë kanë ndikuar performancën e ndërmarrjeve, me ndikim më të theksuar në sektorë të caktuar si ai i shërbimeve, ndërtimit dhe tregtisë. Treguesit e pozicionit financiar të ndërmarrjeve janë përkeqësuar. Qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve, sipas raportimeve në Administratën Tatimore të Kosovës, ka shënuar rënie prej 9.5 përqind. Statistikat afatshkurtëra nga ASK tregojnë për rënie në indeksin e vëllimit të prodhimit industrial, indeksin e qarkullimit në tregtinë me pakicë, si dhe indeksin e aktivitetit në sektorin e shërbimeve. Pozicioni financiar i ekonomive familjare është dëmtuar gjithashtu. Papunësia është thelluar tutje. Rënia në të hyrat e ndërmarrjeve ka ndikuar në rënien e të hyrave të punësuarve në sektorin privat³, të cilët kanë punuar me orar më të shkurtuar apo janë obliguar në pushim pa pagesë.⁴ Në anën tjetër, remitencat janë rritur dukshëm në këtë periudhë, si kontribut për gjendjen e rënduar të ekonomive familjare. Bartja e efekteve të përkeqësimit të tillë të pozicionit financiar të sektorit privat në sektorin bankar, në afat të shkurtër është menaxhuar përmes moratoriumit dhe ristrukturimit të kredive, si dhe në masë më të vogël përmes ndihmës qeveritare për sektorin privat. Sektori i ekonomive familjare, përkundër rritjes më të lartë të kreditimit të shënuar në vitet e fundit, ka rezultuar më pak i ndjeshëm ndaj krizës së pandemisë, gjykuar në bazë të nevojës për ristrukturim të kredive. Kjo për faktin se një pjesë e madhe e ekonomive familjare nuk kanë borxh në sektorin financiar (gjykuar nga niveli relativisht i ulët i kredive të ekonomive familjare ndaj BPV-së prej 19.6 përqind, si dhe nga përgjigjet e ekonomive familjare në një anketë për qëllime të brenshme të porositur nga BQK në muajin mars 2021, sipas së cilës 60.3 përqind e respondentëve kanë deklaruar se

nuk kanë kredi), dhe pjesa që kanë mund të jetë më e koncentruar drejt punëtorëve me të ardhura në sektorin publik dhe punëmarrës më stabil. Kjo, së bashku me ndihmat nga remitencat, kursimet në formë të depozitave, dhe fondet e tërhequra parakohe nga Trusti pensional, mund të kenë ulur ndjeshmërinë e sektorit të ekonomive familjare. Sidoqoftë, shtrirja e krizës pandemike në vitin 2021 rritë rrezikun e rikuperimit të aktivitetit ekonomik ndaj dhe rritë më tej rrezikun e rënies së aftësisë paguese të borxhit nga sektorit privat.

Ngadalësimi i aktivitetit kreditues si dhe rritja e kërkesës për provizione ndikuan në rënien e lehtë të tregueseve të performancës së sektorit bankar.

Profiti i sektorit bankar të Kosovës shënoi rënie vjetore prej 7.4 përqind, ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve për provizione për humbje nga kreditë. Të hyrat u karakterizuan me rritje më të ngadalshme, ndërsa të gjitha kategoritë e shpenzimeve, me përjashtim të shpenzimeve nga interesi, shënuan rritje. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës zbriti në 1.8 përqind, përkatësisht 15.6 përqind, nga 2.2 dhe 18.9 përqind një vit më parë. Rënia në nivelin e profitit dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit ishte më e ulët se rënia në vendet e rajonit, duke rritur dallimin mbi mesataren e rajonit që ka sektori bankar i Kosovës. Në vijim, të hyrat e sektorit bankar pritet të ballafaqohet me presionin e shkaktuar nga kriza e pandemisë Covid-19. Dobësimi i aftësisë paguese të klientëve si dhe rritja e nevojës për ndarje të shpenzimeve për provizione për të mbuluar humbjet e mundshme, mund të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve.

Rreziku kreditor i sektorit bankar është karakterizuar me rritjen më të ndjeshme si rezultat i pandemisë Covid-19. Cilësia e portfolios kreditore ka filluar përkeqësimin, e reflektuar përmes migrimit të kredive nga shtylla e parë me

³ Në një anketë për qëllime të brenshme të porositur nga BQK me ekonomitë familjare në muajin mars 2021, 31.1 përqind e respondentëve kanë deklaruar rënie të të hyrave të ekonomisë familjare si rezultat i krizës së shkaktuar nga Covid-19.


⁴ Anketa e Pulsit të Biznesit për Kosovën nga Banka Botërore (World Bank Business Pulse Survey)

klasifikimin më cilësor kreditor drejt shtyllës së dytë. Materializimi i plotë i rritjes së rrezikut kreditor në bilancin e gjendjes së bankave, sidoqoftë, është evituar përmes masave lehtësuese të ndërmarra nga BQK, përkatësisht moratoriumit, pezullimit të dispozitave rregullative në provizionim dhe klasifikim të rregullt kreditor, si dhe ristrukturimit të kredive. Norma e kredive joperformuese ndryshoi trendin rënës që kishte në gjashtë vitet e fundit, duke u ngritur në 2.7 përqind në dhjetor 2020, nga niveli më i ulët historik prej 2.0 përqind që shënoi në fund të vitit 2019. Rritja fillimisht i atribuohet ndryshimit metodik të vlerësimit të rrezikut kreditor⁵ sipas SNRF9. Si rezultat i këtij ndryshimi, norma e KJP-ve u ngrit në 2.5 përqind në muajin shkurt 2020. Në vijim, rritja e KJP-ve reflekton rritjen e rrezikut të nxitur nga situata pandemike. Stoku i kredive joperformuese në fundvit shënoi rritje vjetore prej 39.8 përqind dhe arriti në vlerën 85.9 milionë euro (nga 61.5 milionë euro në vitin 2019). Kërkesa për ristrukturim të kredive, gjegjësisht shtyrje të afatit të pagesës në qershor 2020 ishte 63.2 përqind të gjithsej kredive, 40.9 përqind e të cilave u aprovuan. Pjesëmarrja e ristrukturimeve në këtë fazë ishte më e lartë për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të huamarrësve të shkaktuar si rezultat i mbylljes totale të ekonomisë. Ndërsa në fazën e dytë të riskturkturimeve, që filloi nga muaji qershor, pjesëmarrja e kredive të riskturkturuara ishte më e ulët, përkatësisht zbriti në 11.5 përqind ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2020. Efektet e rritjes së rrezikut nga pandemia Covid-19 në normën e KJP-ve pritët të ndjehen pas përfundimit të masave lehtësuese të ristrukturimit, përkatësisht në fund të vitit 2021 kur maturojnë masat lehtësuese të të gjitha kredive të ristrukturuara. Përkundër shpenzimeve më të larta të provizioneve në këtë periudhë, raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit ka shënuar rënie në 139.4 përqind nga mbulueshmëria 163.5 përqind në dhjetor 2019.

Sektori bankar hyri në fazën e pandemisë me nivele të kënaqeshme në treguesit kyç të shëndetit dhe performancës së tij financiare, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të larta përkundër rritjes së rreziqeve. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit për 0.7 pikë përqindje në 16.5 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (profitit të mbajtur). BQK, si masë preventive ndaj efekteve të mundshme të krizës së pandemisë Covid-19 në pozitën e kapitalit, kishte rekomanduar mosshpërndarjen e dividendës për sektorin bankar.

Norma e kapitalizimit ishte më e lartë për bankat me rëndësi sistematike, por dallimi mes normës individuale të bankave dhe mesatares së sektorit për bankat që gjenden poshtë mesatares, është zvogëluar këtë periudhë. Pozita e mirë e kapitalizimit të sektorit reflektohet edhe në pjesëmarrjen e lartë të kapitalit të klasit të parë prej 88.7 përqind, i cili në tërësi përbëhet nga kapitali bazë i klasit të parë. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik qëndroi në 14.7 përqind.

Grafik 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK.

Vazhdimi i gjendjes pandemike, sidoqoftë, pritët të shtoj presionin në të hyrat e sektorit, profitabilitetin e tij dhe nivelin e kapitalit, si rezultat i efektit të krizës në ekonominë e vendit dhe rrezikun kreditor. Analiza stres test sugjeron që sektori është në përgjithësi rezistent ndaj skenarëve më të rënduar të humbjeve të pritura, me ndjeshmëri më të theksuar në nivel të disa bankave të cilat

⁵ Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditorprill2019.pdf (bqk-kos.org)

mund të ballafaqohen me sfida në mirëmbajtjen e nivelit të kapitalit në nivelin e kërkuar rregullativ.

Pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet e favorshme, e karakterizuar me rritje në treguesit kryesorë të likuiditetit.

Kriza e nxitur nga pandemia shkaktoi presion të menjëhershëm në menaxhimin e likuiditetit nga sektori bankar, megjithatë, si pasojë e pozicionit të favorshëm të likuiditetit para krizës së pandemisë, sektori u gjend mirë i mbuluar dhe me rezerva të mjaftueshme për të tejkaluar rrezikun e menjëhershëm të krizës, si dhe për të mbështetur aktivitetin bankar në vend në vazhdimësi. Në funksion të menaxhimit më të mirë të situatës, BQK ka përsheptuar nxjerrjen e rregullores për hua brenda-ditore dhe një ditore, që bankat mund të marrin nga BQK në rast të vështirësive të tyre për qasje në likuiditet afatshkurtër. Me këtë rast janë bërë edhe përgatitjet dhe zhvillimet e nevojshme teknike për ekzekutimin e këtyre instrumenteve në rast nevojë, megjithëse niveli i likuiditetit në sektorin bankar është dëshmuar se është i lartë dhe i ka përballuar situatës pa pas nevojë të ndonjë intervenimi të veçantë nga BQK.

Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra u përmirësua në 39.8 përqind krahasuar me 37.6 përqind në dhjetor 2019. Po ashtu edhe raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve u rrit në 30.1 përqind. Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 82.3 përqind. Depozitat, të cilat në dhjetor 2020 përbënin 81 përqind të burimeve të financimit, shënuan rritje vjetore prej 12 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme të ekonomive familjare, të nxitura nga kursimi më i madh si rezultat i rritjes së pasigurive, tërheqja e 10 përqind të kursimeve pensionale dhe niveli më i lartë i remitencave.

Pasiguritë e lidhura me kohëzgjatjen e pandemisë, programin e vaksinimit, si dhe nivelin e masave qeveritare kufizuese për mbrojtje nga përhapja e virusit mbeten ende prezent, dhe paraqesin sfida për ekonominë e

vendit. Në rrethana të tilla, depozitat pritet të ngadalësojnë rritjen si rezultat i efektit të pandemisë në tregun e punësimit dhe rënien e të ardhurave, si dhe në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve të cilat do të shfrytëzojnë mjetet në dispozicion për mbulimin e nevojave të tyre të likuiditetit.

BQK, megjithëse më e kufizuar në spektrin e mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg (në mungesë të politikës monetare, BQK ka në dispozicion instrumentin e Fondit të Likuiditetit Emergjent për injektim direkt të mjeteve në sektorin bankar), nevojat e mundshme për likuiditet mund t'i përmbushë edhe përmes mekanizmave tjera si menaxhimit të rezervave të likuiditetit, marrëveshjeve ndërbankare për likuiditet si dhe financimit nga bankat amë.

Sektori pensional u karakterizua me ngadalësimin më të theksuar të rritjes që nga fillimi i funksionimit në vitin 2004, si pasojë e rritjes më të ulët të arkëtimeve të reja dhe kthimit më të ulët në investime të ndikuar nga kriza pandemike, si dhe tërheqjes së parakohshme të 10 përqind të mjeteve të trustit prej kontributdhënësve.

Asetet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind, dhe arritën vlerën 2.0 miliardë euro. Arkëtimet e reja përgjysmuan shkallën e rritjes në 4.1 përqind nga 8.1 përqind një vit më parë, si rrjedhojë e efekteve të shkaktuara nga përhapja e pandemisë Covid-19, veçanërisht në fillim të pandemisë, ku kishte mbyllje të aktivitetete të të gjitha ndërmarrjeve jo-esenciale dhe kufizim të lëvizjes. Kthimi në investime shënoi rënie vjetore prej 55.4 përqind dhe zbriti në 72.3 milionë euro. Si rrjedhojë e përhapjes së pandemisë Covid-19, tregjet e jashtme pësuan rënie të konsiderueshme në tremujorin e parë të vitit, kur edhe fondet pensionale shënuan humbje të theksuara, kurse gjatë tremujorit të dytë të vitit, stabilizimi në tregjet e jashtme ndikoi që sektori të rikuperonte tërësisht humbjet dhe të realizoj në fund të vitit kthimin e mësipërm pozitiv. Në kuadër të planit të rimëkëmbjes ekonomike, është aprovuar masa e ofrimit të mundësisë së tërheqjes së parakohshme të 10% të kursimeve pensionale

nga kontribut-dhënësit, me vlefshmëri për aplikim në periudhën dhjetor 2020 – prill 2021. Deri në fund të vitit 2020, rreth 61.7% e kontributdhënësve kanë tërhequr kursimet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 185.4 milionë euro. Tërheqja e mjeteve do të ndikojë ecurinë e aseteve të sektorit pensional edhe në vitin 2021, por në shkallë më të ulët.⁶

Sektori i sigurimeve u karakterizua me zgjerim të aseteve, nivel të ngjashëm të primeve, ndërsa nivel më të ulët të dëmeve të paguara krahasuar me vitin paraprak. Përhapja e pandemisë Covid-19 kishte efekt më të theksuar në rënien e nivelit të dëmeve të paguara, si rezultat i kufizimit të lëvizjes, ndaj dhe ndikoi pozitivisht në performancën financiare të sektorit. Në vitin 2020, primet e sektorit të sigurimeve u rritën për 0.1 përqind në 99.3 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara shënuan rënie vjetore prej 6.6 përqind dhe zbritën në 51.5 milionë euro. Rrjedhimisht, raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara u zvogëluar për 3.7 pikë përqindje, në 51.8 përqind dhe sektori e mbylli vitin me rezultat pozitiv financiar prej 4.1 milionë euro, për dallim nga humbja prej 4.7 milionë euro në vitin e kaluar. Ngritje shënuan edhe treguesit e shëndetit të sektorit si: niveli i përgjithshëm i kapitalizimit, treguesit e likuiditetit (raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave dhe ndaj detyrimeve), si dhe vlera e provizioneve teknike për primet dhe dëmet.

Sektori mikrofinanciar shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes, të ndikuar nga aktiviteti i ngadalësuar kreditor dhe ai i lizingjeve, si dhe nga implikimet e revokimit të licencës së dy institucioneve mikrofinanciare. Varësia e sektorit nga burimet e jashtme të financimit e bënë sektorin të ndjeshëm ndaj zhvillimeve në tregjet globale financiare, ndaj dhe kriza globale e shkaktuar nga pandemia Covid-19 ndikoi në nivelin e financimit të sektorit.

Huazimet nga sektori i jashtëm, që paraqesin burimin kryesor të financimit të aktivitetit, shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes, të ndikuar gjithashtu nga kërkesa më e ulët për financim të aktivitetit të sektorit. Kreditimi i sektorit shënoi rënie vjetore prej 6.8 përqind. Rënia, e cila ndodhi për herë të parë në shtatë vitet e fundit, nuk reflekton vetëm goditjet që ka marr sektori nga pandemia Covid-19, por edhe revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare, asetet e të cilave janë duke u zbritur nga zërat bilancor të sektorit. Kreditë ndaj ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e kredive, shënuan rënie më të theksuar, përkatësisht 9.2 përqind rënie kundrejt rritjes 21.9 në vitin 2019. Ndërsa kreditë e korporatave jofinanciare u karakterizuan me rënie më të lehtë prej 1.9 përqind nga 15.3 përqind rritje në vitin 2019.

Normat e interesit, në mesatare qëndruan në nivel të ngjashëm. Sektori realizoi fitim në vlerë dukshëm më të ulët krahasuar me trendin e pesë viteve të kaluara, si rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi dhe rritja e shpenzimeve për provizione. Niveli i kredive joperformuese u rrit në 3.0 përqind nga 2.6 përqind në vitin 2019, përderisa mbulueshmëria e tyre me provizione arriti në 142.2 nga 117.0 përqind në vitin 2019.

Sektori i ndihmësve financiar është sektori i vetëm që shënoi rritje të theksuar të aktivitetit dhe fitimit neto në këtë periudhë, si rezultat i rritjes së burimit kryesor të të hyrave të tij, përkatësisht transfereve nga jashtë. Ky sektor, me peshë të ulët prej vetëm 0.2 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Asetet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 13.2 përqind, dhe neto fitimi u rrit për 34.2 përqind. Rritja e aktivitetit të sektorit është ndikuar nga dinamikat e ndërlydhura me pandeminë Covid-19. Në pamundësi të qarkullimit si pasojë e pandemisë, emigrantët rritën ndihmat e tyre për familjarët (remitencat arritën në vlerë rekorde afër 1.0

⁶ Sipas planit të rimëkëmbjes ekonomike, është mundësuar lejimi i tërheqjes së shumës prej 10 përqind të mjeteve të kursyera në fondet pensionale për kontribut-paguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila mundësi mund të

shfrytëzohet për një periudhë 4-mujore. Për kontribut-paguesit me kursime të përgjithshme nën shumën 10,000 euro, qeveria do të klompensojë shumën e tërhequr prej 10 përqind në afat prej pesë viteve.

miliardë euro), shumica e të cilave u dërguan përmes ATP-ve.

Gjatë vitit 2020, në kushtet e ballafaqimit me krizën pandemike, BQK ka adaptuar kornizën rregullative dhe ka ndërmarrë vendime prudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbështetjes së kredi- marrësve dhe ekonomisë së vendit. Njëkohësisht, janë vazhduar proceset e avancimit të infrastrukturës financiare në mbështetje të zhvillimit të sistemit financiar.

Menjëherë pas shpalljes së gjendjes pandemike, më 16 mars 2020, BQK mori vendim për pezullimin e përkohshëm të zbatueshmërisë së dispozitave të caktuara të disa rregulloreve të mbikëqyrjes së institucioneve kredidhënëse, si mbështetje për sfidat e krijuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe sistemin financiar. Masat e ndërmarra nga BQK ishin në linjë me masat emergjente të ndërmarra në nivel ndërkombëtar për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbështetjen e ekonomisë dhe kredimarrësve. Këto masa përgjithësisht konsistojnë në nxjerrjen e moratoriumit në pagesat e kredisë, përkatësisht shtyrjen e pagesave të detyrimeve kreditore për 3 muaj; pezullimin përkohshëm të aplikimit të dispozitave të rregullta në klasifikimin kreditor dhe provizionim; si dhe lejimin/udhëzimin për ristrukturimin e kredive për huamarrësit në vështirësi financiare. Tutje, BQK ka aprovuar masa lehtësuese për ristrukturimin e kredive për kredimarrësit e afektuar nga gjendja pandemike, të cilat, sipas udhëzuesit të fundit për ristrukturim të muajit shkurt 2021, maturojnë në tërësi në fund të vitit 2021.

Sistemi i pagesave, pavarësisht mbylljes së ekonomisë dhe kufizimit të lëvizjes si rezultat i pandemisë, ka operuar pa ndërprerje duke ofruar sigurinë, efikasitetin dhe fleksibilitetin e duhur për pjesëmarrësit, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe identifikimit dhe adresimit të hershëm të problemeve të mundshme.

Gjatë kësaj periudhe, BQK ka luajtur rol të rëndësishëm mbështetës për ekonominë edhe përmes operimit efikas të Regjistrimit të Llogarive Bankare, duke ndihmuar institucionet në shpërndarjen e lehtë dhe të sigurt të mjeteve në kuadër të masave emergjente fiskale të ndërmarra për mbështetjen e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve më të afektuara nga situata e pandemisë, si dhe në shpërndarjen e 10 përqind të mjeteve të trustit pensional tek kontribut-dhënësit.

Infrastruktura rregullative dhe financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin. Në shtator të vitit 2020, BQK licencoi për operim në Kosovë një bankë të re, 'Banka Credins Kosovë' SH.A, duke kontribuar në rritjen e konkurrencës në sektorin bankar. Në muajin shkurt të vitit 2020, është bërë avancimi i infrastrukturës së duhur rregullative të instrumenteve të parasë elektronike, e cila ka mundësuar autorizimin e katër institucioneve financiare jo-bankare të regjistruara për ofrimin e shërbimeve të pagesave elektronike, dhe emetimit të parave elektronike. Me hyrjen në treg të këtyre shërbimeve, pritet të rritet konkurrenca dhe njëkohësisht efikasiteti në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të reja të pagesave elektronike, të cilat pritet të ndikojnë në uljen e përdorimit të parasë së gatshme.

Pandemia Covid-19 ka nxitur përsheptimin e trendit të avancimit teknologjik të sektorit, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara. Rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara njëkohësisht ka rritë shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut operacional si dhe nevojën për mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar⁷


Harta e stabilitetit financiar⁸ paraqet zhvillimet në treguesit kryesorë të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës (grafik 4). Viti 2020 është karakterizuar me rritje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në pothuajse të gjitha dimensionet e rrezikut dhe indikatorët përbërës përkatës, zhvillime këto të nxitura nga shpërthimi i pandemisë Covid-19. Rreziku nga ambienti makroekonomik i jashtëm dhe i brendshëm është rritur dukshëm në vitin 2020 (veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit), pas shpërthimit të pandemisë. Rreziku nga veprimtaria e agjentëve ekonomikë si ndërmarrjet dhe sektori qeveritar gjithashtu shënuan rritje, kurse treguesi i ekonomive familjare, në mesatare, ka rezultuar me rrezik në rënie për shkak të efektit pozitiv që kishte rritja e lartë e remitencave gjatë vitit 2020. Treguesit e brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit kanë reflektuar zhvillime të ndryshme. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit është karakterizuar me rritje të rrezikut, ndërsa rreziku nga struktura e sektorit bankar ka vazhduar rënie graduale që ka ndër vite. Treguesi i likuiditetit dhe financimit, i cili u karakterizua me notën më të lartë të rrezikut në vitet e fundit, ka shënuar rënie rreziku në këtë periudhë, mbështetur edhe nga tërheqja e 10 përqind të mjeteve të trustit dhe transferimi në llogari bankare të qytetarëve. Për dallim nga viti i kaluar, kur dy tregues qëndruan mbi nivelin e rrezikut mestar historik, në vitin 2020 pesë tregues qëndruan mbi këtë nivel (grafik 5) e që reflekton efektet e pandemisë Covid-19.⁹

Rreziku i rritur në treguesin e ekonomisë së jashtme reflekton rënie ekonomike të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës. Shpërthimi i pandemisë Covid-19 dhe masat kufizuese që u aplikuan gjatë vitit, e në veçanti gjatë tremujorit të dytë të vitit në këto vende, kanë nxitur recesionin ekonomik më të lartë të shënuar në periudhën 15 vjeçare të cilën e mbulon harta e stabilitetit financiar. Treguesit tjerë që dhanë kontribut në rritje rreziku ishin rritja e papunësisë në vendet partnere si dhe prospektet pesimiste për ciklin e ndërmarrjeve në Evropë nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në Evropë. Efekt pozitiv në zbutjen e rrezikut kishin

rënia e çmimeve të naftës si dhe rënia në normat bazë të interesit.

Rreziku nga ekonomia e brendshme është rritur kryesisht si rezultat i rënies së BPV-së gjatë TM2 dhe TM3, rënie kjo e nivelit më të lartë të shënuar ndonjëherë në ekonominë e Kosovës. Si rrjedhojë, hendeku i prodhimit, që informon për rritjen aktuale ekonomike në raport me potencialin e tij afatgjatë, ka kaluar në territor negativ. Borxhi i jashtëm është rritur në vlerë absolute, por rënia e BPV-së ka ndikuar që raporti i tij ndaj BPV-së të rritet në shkallë më të lartë, duke kontribuar në rritje të notës së rrezikut. Kurse efekt pozitiv në zbutjen e rrezikut kishte rënia e çmimeve të konsumit.

Grafik 4. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me rritjen më të lartë të rrezikut, të ndikuar nga ecuria negative në të gjithë treguesit, ecuri kjo e nxitur nga shpërthimi i pandemisë Covid-19 dhe masave kufizuese përcjellëse. Ndikimin më të lartë e kishte ulja e ndjeshme e aktivitetit të sektorit të tregtisë, hendeku i kreditimit ndaj BPV-së, dhe rënia e indeksit të qarkullimit industrial. Kreditë me probleme, pavarësisht nivelit të ulët të tyre, treguan tendencë të rritjes krahasuar me një vit më parë.

Rreziku nga ekonomitë familjare qëndroi në nivel të përafërt me vitin e kaluar. Treguesit si hendeku i kreditimit ndaj BPV-së dhe cilësia e portfolios kreditore shënuan rritje rreziku, efekti i të cilave u neutralizua pothuajse tërësisht nga rritja e theksuar e dërgesave të emigrantëve. Rreziku nga sektori qeveritar shënoi rritje, të ndikuar nga ecuria e rritjes së rrezikut në të gjithë treguesit përbërës. Kontributin kryesor e kishte rënia e të ardhurave

⁷ Kalkulimi i treguesëve bazohet në vlerën e BPV-së deri në muajin mars 2021, dhe nuk përfshinë revidimin e fundit të BPV-së në prill 2021.

⁸ Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe

zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

⁹ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërës në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

tatimore e ndikuar nga masat parandaluese ndaj shpërndarjes së pandemisë Covid-19 dhe masat fiskale si lehtësira tatimore, etj. Treguesit tjerë me kontribut në rritjen e rrezikut nga sektori qeveritar, ecuria e të cilëve u ndikua kryesisht nga pandemia Covid-19, ishin rritja e primit të rrezikut sovran, bilanci negativ buxhetor dhe zgjerimi i borxhit publik.


Në kuadër të treguesve të brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit, treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit ka shënuar rritje të rrezikut, të ndikuar nga ecuria rritëse e rrezikut në të gjithë komponentët përbërës. Rritja e ekspozimeve të mëdha kreditore ishte faktori me efektin më të lartë në rritje rreziku, pasuar nga rënia e të hyrave neto nga interesi në raport me asetet (ndikuar nga rritja e shpenzimeve të interesit). Po ashtu, edhe fitim neto i sektorit ishte më i ulët, ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve për provizione. Niveli i kredive joperformuese, edhe pse në nivel të ulët, që nga fillimi i vitit 2020 ka shënuar tendencë të rritjes si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Struktura e sektorit bankar ka vazhduar përmirësimin gradual të ndikuar nga rritja e përgjithshme e konkurrencës. Nota e rrezikut vazhdoi rënien, si rezultat i zhvillimeve pozitive në të gjithë komponentët përbërës.

Përmirësimi më i theksuar është shënuar në komponentin e devijimit negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit, që nënkupton që bankat kanë konvergjuar drejt mesatares së normës së kapitalizimit të sektorit, kjo si rezultat i rritjes së normës së kapitalizimit të bankave më të vogla krahas rënies së normës mesatare të kapitalizimit të sektorit.

Zhvillimet tjera pozitive përfshijnë diversifikimin më të lartë të portfolios së përgjithshme kreditore, rënien e koncentrimit të portfolios kreditore të ndërmarrjeve, diversifikimin më të lartë të burimeve të financimit të bankave si dhe vazhdimin e rënies së shkallës së koncentrimit të aseteve të tri bankave më të mëdha.

Treguesi i likuiditetit dhe financimit të sektorit shënoi rënie rreziku në pothuajse të gjithë treguesit përbërës. Kontributin kryesor në rënie e kishte ngadalësimi i rritjes së kreditimit në njërën anë, dhe rritja e depozitave në anën tjetër, zhvillime këto që ndikuan në rënien e raportit të gjithsej kredive ndaj depozitave të sektorit. Ngushtimi i hendekut të likuiditetit dhe rritja e raportit të likuiditetit ishin treguesit tjerë që kontribuan në ulje rreziku.

Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Faktorët të cilët shënuan rritje të rrezikut ishin rritja e pjesëmarrjes së detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm në burimet e financimit/detyrimet e sektorit, dhe rritja më e ngadalësuar e depozitave të ekonomive familjare krahasuar me ritmin e rritjes një vit më parë. Nota mesatare e rrezikut të treguesit të likuiditetit dhe financimit, si rezultat i rënies në këtë periudhë, ngushtoi devijimin më të theksuar mbi nivelin e mesatares historike që e kishte ndër vite, i cili në masë të madhe reflekton natyrën e komponentëve të përfshirë në tregues.¹⁰

¹⁰ Treguesi i normës kredi/depozita ka përcjellë trend natyreshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit, dhe periudhat e fundit reflektojnë raport më të lartë (notë më të lartë rreziku). Ngjashëm, trendi i normës së rritjes së depozitave të ekonomive familjare është karakterizuar me fluktuime të

theksuara përgjatë viteve, duke qenë më i lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyreshëm ka filluar të bie si rezultat i zhvillimit të sektorit, por që përsëri është rritur në periudhat e fundit.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Aktiviteti ekonomik në nivel global u karakterizua me një goditje të paprecedentë në vitin 2020. Kriza shëndetësore si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe masat që u ndërmoren për ruajtjen e shëndetit publik, kryesisht në kontekst të kufizimit të lëvizjes dhe distancimit fizik, u reflektuan në rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik në pothuajse të gjitha vendet e eurozonës.

Kriza shëndetësore, ekonomike dhe sociale që u nxit nga pandemia Covid-19 ndikoi edhe vendet në Ballkanin Perëndimor. Perspektiva ekonomike dhe prognozot për procesin e rikuperimit vazhdojnë të shoqërohen me një shkallë të lartë të pasigurisë, duke qenë subjekt i përmbylljes së krizës shëndetësore (dinamikat në valët e përhapjes së virusit dhe vaksinimi masiv), pasojave shoqëruese në akterët kryesor në tregje dhe efektivitetit të pakove/masave stimuluese monetare, fiskale dhe financiare.

Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë

Përshkrimi	BPV -ja reale				Norma e papunësisë				Inflacioni			
	2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021
Eurozona	1.9	1.3	-6.6	4.4	8.2	7.6	7.9	8.7	1.8	1.2	0.3	1.4
Gjermania	1.3	0.6	-4.9	3.6	3.4	3.2	4.2	4.4	1.9	1.4	0.4	2.2
Franca	1.9	1.5	-8.2	5.8	9.0	8.5	8.2	9.1	2.1	1.3	0.5	1.1
Italia	0.9	0.3	-8.9	4.2	10.6	9.9	9.1	10.3	1.2	0.6	-0.1	0.8
Spanja	2.4	2.0	-11.0	6.4	15.3	14.1	15.5	16.8	1.7	0.7	-0.3	1.0
Kosova	3.8	4.9	-3.9	4.3	29.6	25.7	25.6	n/a	1.1	2.7	0.2	1.6
Mali i Zi	5.1	4.1	-15.2	9.0	n/a	n/a	n/a	n/a	2.6	0.4	-0.2	0.4
Maqedonia e Veriut	2.9	3.2	-4.5	3.8	20.7	17.3	16.4	16.3	1.5	0.8	1.2	2.0
Bosnja dhe Hercegovina	3.7	2.8	-5.5	3.5	18.4	15.7	19.0	17.5	1.4	0.6	-0.6	1.2
Serbia	4.5	4.2	-1.0	5.0	13.3	10.9	13.3	13.0	2.0	1.9	1.7	2.2
Shqipëria	4.1	2.2	-3.5	5.0	12.3	11.5	12.5	14.0	2.0	1.4	1.6	2.0

Burimi: FMN, WEO prill 2021, ASK dhe BQK për Kosovën.

Si pasojë e masave të ndërmarra për të luftuar pandeminë Covid-19, ekonomia e Eurozonës në vitin 2020 ka shënuar rënie prej 6.6 përqind, për shkak të tkurrjes së konsumit privat, investimeve dhe eksportit. Efektet e pandemisë u ndjenë veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit 2020, kur edhe u shënuar rënie prej 14.8 përqind. Shtetet që shënuan rënie më të thellë ekonomike ishin Spanja dhe Italia, prej rreth 11.0 përqind përkatësisht 8.9 përqind, ndërsa Gjermania shënoi rënie prej 4.9 përqind (tabela 2). Në kushtet e rënies së aktivitetit ekonomik, edhe presionet inflacioniste mbetën të dobëta, ndikuar kryesisht nga rënia e ndjeshme e kërkesës globale që ndikojnë në rënie të çmimeve të naftës. Për të parandaluar thellimin e krizës, qeveritë e vendeve të Eurozonës ndërmoren masa fiskale e financiare, që kryesisht kishin për objektive zbutjen e efekteve negative të pandemisë në tregun e punës dhe mbështetjen e konsumit dhe financimin me likuiditet të ndërmarrjeve. Paralelisht, BQE mirëmbajti

politikë të lehtësuara monetare përmes programit të lehtësimit sasior.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare prej 5.6 përqind. Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina shënuan rënie më të lartë të aktivitetit ekonomik. Përveç problemeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19, edhe pasiguria e rritura politike në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të pasqyrohen në rënie të mëtejme të besueshmërisë së investitorëve dhe konsumatorëve, duke ndikuar kështu ecurinë e rikuperimit potencial të aktivitetit ekonomik.


Rritja e paprecedent e rreziqeve të jashtme dhe të brendshme si pasojë e pandemisë Covid-19 kanë ndikuar që Kosova të shënojë rënie të parë të BPV-së në vitin 2020, përderisa sinjalet e para të vitit 2021 sugjerojnë për një rikuperim gradual që është subjekt i zhvillimeve në ekonominë e jashtme dhe përkeqësimit eventual të krizës shëndetësore dhe masave

kufizuese potenciale brenda vendit, në pritje të vaksinimit masiv.

3.1. Ekonomia e brendshme

Përhapja e pandemisë Covid-19 ka krijuar vështirësi të menjëhershme për shoqërinë dhe rreziqe të mëdha për ekonominë e vendit, dinamika që rezultuan në krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Për të menaxhuar me pandeminë dhe krizën shëndetësore, ngjashëm me qeveritë në mbarë globin, edhe qeveria e Kosovës ka ndërmarr masa kufizuese si në aspekt të lëvizjes, udhëtimit, aktiviteteve publike dhe jopublike, veprimtarive të disa prej shërbimeve të ndërmarrjeve, etj. Këto masa kufizuese janë përkthyer në ngadalësim të aktivitetit ekonomik prej 1.3 përqind në tremujorin e parë dhe rënie të aktivitetit ekonomik prej 9.3 përqind dhe 7.3 përqind në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020. Tremujori i katërt rezultoi në rikuperim, me rritje reale të BPV-së prej 0.7 përqind.

Grafik 6. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK.


Vlerësimet preliminare të ASK-së, bazuar në shumën e tremujorëve, sugjerojnë se ekonomia e Kosovës ka shënuar rënie ekonomike prej 3.9 përqind në vitin 2020. Aktiviteti ekonomik pritet të rikuperohet drejtë niveleve të para krizës në vitin 2021, me një rritje prej rreth 4.3 përqind.

Komponentët që kontribuan në rënien ekonomike gjatë vitit 2020 ishin investimet me 5.7 pikë përqindje dhe eksportet neto me 4.7 pikë përqindje. Komponenta e konsumit është vlerësuar të ketë mbështetur aktivitetin ekonomik me 6.5 pikë përqindje (grafik 6).

Në baza sektoriale, sektorët që shënuan rënie të vlerës së shtuar në BPV ishin sektori i hoteleve dhe restoranteve, transporti dhe magazinimi, sektori i ndërtimtarisë, aktivitetet administrative dhe mbështetëse, tregtia, etj. Ndërsa, sektorët që regjistruan rritje të aktivitetit ishin sektori i shëndetësisë dhe punës sociale, furnizimi me energji elektrike dhe gaz, industria përpunuese, informimi dhe komunikimi, industria nxjerrëse, etj.

Dy sektor të rendësishëm të ekonomisë së vendit, sektori i shërbimeve dhe industrisë, rezultojnë të jenë përballur me rënie të theksuar të aktivitetit dhe rënie të shkallës së punësimit, sipas ASK-së, dinamika të ndikuara kryesisht nga kriza ekonomike e nxitur nga pandemia Covid-19. **Mesatarja e indeksit të shitjeve neto në sektorin e shërbimeve rezultoi të ketë shënuar rënie prej 36.2 përqind në vitin 2020 (23.1 përqind rritje në vitin 2019), dhe indeksi mesatar i numrit të punësuarve shënoi rënie prej 6.4 përqind (13.2 përqind rritje në vitin 2019)** (grafik 7).

Grafik 7. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve (2015=100)




Burimi: ASK.

Të gjithë sektorët e paraqitur në këtë publikim kanë shënuar rënie të shitjeve. Rënia më e lartë është shënuar tek hotelet (-63.8 përqind), pasuar nga agjencitë e udhëtimit (-59.9 përqind), bar-restoranet (-34.9 përqind), tregtia (-28.2 përqind), transporti dhe magazinimi (-27.3 përqind), si dhe informacioni dhe komunikimi (-4.4 përqind). Njëkohësisht, mesatarja e peshuar e vëllimit të prodhimit industrial rezultoi të ketë shënuar rënie prej 0.9 përqind (rritje prej 10.2 përqind

në vitin 2019), përderisa numri i të punësuarve rezulton të ketë shënuar rënie mesatare prej 1.5 përqind (rritje prej 10.1 në vitin 2019).

Rënia e kërkesës së përgjithshme dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione të dobëta inflacioniste në Kosovë. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2020, e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), ishte 0.2 përqind (2.7 përqind në vitin 2019) (grafik 8).

Grafik 8. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK.

Sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla e inflacionit në vitin 2021 do të jetë 1.6 përqind, ndërkohë që pritjet e bankave komerciale¹¹ sugjerojnë nivel të inflacionit prej 0.9 përqind në vitin 2021.

Dinamikat që e karakterizuan sektorin fiskal gjatë vitit 2020 rezultuan në rënie të të hyrave buxhetore për 8.8 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore për 6.5 përqind. Si pasojë e rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve buxhetore, deficitin buxhetor ka arritur në 7.1 përqind e BPV-së. Me rritje prej 23.9 përqind u karakterizua edhe borxhi publik, që arriti vlerën prej rreth 1.5 miliardë euro. **Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 21.8 përqind nga 17.5 përqind sa ishte në vitin 2019.** Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 21.5 përqind (i cili ka arritur në 961.9 milionë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 28.6 përqind duke arritur në 525.8 milionë euro. Rritja më e

lartë e borxhit publik në vitin 2020 krahasuar me vitet paraprake kryesisht i atribuohet rritjes së nevojave të buxhetit për të përballuar rritjen e shpenzimeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Kriza ekonomike dhe sociale e shkaktuar nga pandemia ka ndikuar më së shumti sektorin e jashtëm të ekonomisë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse është rritur për 20.4 përqind në vitin 2020, duke shënuar vlerën prej 480.7 milionë euro. Në raport me BPV-në, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka arritur në 7.1 përqind (5.6 përqind në vitin 2019). Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse i është atribuuar kryesisht rënies së eksportit të shërbimeve, përderisa komponentët tjerë të llogarisë rrjedhëse rezultojnë të kenë zbutur efektet negative të rënies së eksportit të shërbimeve. Bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje, ndërkohë që edhe deficitin tregtar i mallrave ishte dukshëm më i ulët.

Rritja e eksportit të mallrave dhe veçanërisht rënia e konsiderueshme e importit, si pasojë e rënies së kërkesës së përgjithshme në vend, janë përkthyer në rënie vjetore të deficitit të mallrave prej 9.4 përqind¹² (4.5 përqind rritje në vitin 2019), përderisa vlera e shënuar ishte rreth 2.8 miliardë euro. Vlera e eksportit të mallrave ishte 475.0 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 23.8 përqind (4.4 përqind rritje në 2019). Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë – si kategori që dominon strukturën e eksporteve, pasuar nga produktet e industrisë kimike, perimet, plastika dhe goma, si dhe ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani. Në anën tjetër, importi i mallrave u karakterizua me rënie prej 5.7 përqind dhe shënoj vlerën prej 3.3 miliardë euro. Me rënie është karakterizuar kryesisht importi i produkteve minerale (kryesisht derivate të naftës) dhe metaleve bazë, kategori të cilat dëshmojnë për rënie të aktivitetit ekonomik përveç karakterizimit me rënie të çmimeve në tregjet ndërkombëtare si efekt i pandemisë Covid-19. Me rënie të theksuar është përballur edhe

¹¹ Bankat raportojnë në BQK për pritjet e tyre lidhur me inflacionin në frekuencë tremujore dhe për tërë vitin.

¹² Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

importi i mjeteve të transportit si dhe tekstili dhe artikujt e tekstilit.

Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime ishte komponenta që pësoi rënien më të madhe si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Komponenta e shërbimeve shënoj vlerën prej 391.5 milionë euro, që paraqet rënie prej 57.7 përqind krahasuar me vitin 2019. Vlera e shërbimeve të eksportuara ishte 994.0 milionë euro apo 40.7 përqind më pak krahasuar me vitin 2019, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara ishte 602.5 milionë euro apo 19.6 përqind më pak krahasuar me vitin 2019. Kufizimet ndërkombëtare në udhëtim, si një ndër masat kryesore të ndërmarra në funksion të parandalimit të përhapjes së Covid-19, si dhe masat për izolim të detyruar të shtetasve të BE-së pas kthimit kanë dekurajuar diasporën për të vizituar Kosovën gjatë vitit 2020, gjë që ka thelluar krizën ekonomike në vend veçanërisht në TM3 2020. Rrjedhimisht, eksporti i shërbimeve të udhëtimit ka shënuar rënie prej 52.2 përqind, dhe eksporti i shërbimeve të ndërtimit dhe eksporti i shërbimeve të transportit kanë shënuar rënie për 46.1 përkatësisht 29.7 përqind. Dinamika të ngjashme karakterizuan edhe importin e shërbimeve, ku rënien më të madhe e shënuan shërbimet e udhëtimit, shërbimet kompjuterike, shërbimet e transportit si dhe shërbimet e ndërtimit – të ndërlidhura me masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19.

Kufizimet në udhëtim të ndërmarra si nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe nga qeveritë e vendeve ku janë të koncentruar emigrantët kosovar dhe punëtorët sezonal, si dhe masat tjera kufizuese për parandalim të përhapjes së virusit Covid-19, u reflektuan në rënie të ardhjes së diasporës kosovare gjatë vitit 2020 dhe për rrjedhojë, rritjes së të hyrave të dërguara nga jashtë si kompenzimi i punëtorëve dhe remitencat. Të ardhurat nga

kompensimi i punëtorëve¹³, që është kategoria kryesore e të ardhurave parësore, shënuan rritje për 3.7 përqind, ndërsa remitencat arritën vlerën prej 980.1 milionë euro në vitin 2020 dhe shënuan rritje vjetore prej 15.1 përqind duke arritur në 14.4 përqind të BPV-së. Flukset hyrëse të remitencave janë karakterizuar me rritje përgjatë gjithë vitit, me përjashtim të muajve mars dhe prill kur shënuan rënie. Remitencat përmes operatorëve që transferojnë para kanë shënuar rritje më të lartë për 60.0 përqind, ndërsa remitencat përmes bankave kanë shënuar rritje për 14.9 përqind. Në anën tjetër, duke pasur parasysh masat kufizuese në udhëtim, remitencat që vijnë përmes “kanalit jo-formal” kanë shënuar rënie prej 46.0 përqind.


IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 341.7 milionë euro në vitin 2020, e që janë për 34.2 përqind më të larta krahasuar me vitin paraprak. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i aktiviteteve financiare, energjetikës, si dhe xehtarisë dhe guroveve, ndërsa sektori patundshmërive si sektori me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej strukturën e IHD-ve shënoi rënie prej 10.1 përqind. IHD-të në sektorin e aktiviteteve financiare rezultojnë të ketë rritur pjesëmarrjen në 24.7 përqind në vitin 2020, nga 5.5 përqind sa e kishin në vitin 2019. Rritja e investimeve në këtë segment kryesisht ndërlidhet me masat e ndërmarra nga BQK për të ndihmuar ekonominë që të përballojë në mënyrë sa më të lehtë sfidat e krizës pandemike. Konkretisht, me qëllim të mbajtjes së niveleve të shëndosha të kapitalit brenda sistemit bankar dhe për të mbështetur ekonominë e Kosovës nëpërmjet kreditimit, BQK-ja ka marrë vendim për të pezulluar shpërndarjen e dividendës nga ana e bankave për vitin 2019 dhe 2020, gjë që u reflektua në rritje të kapitalit aksionar të institucioneve financiare dhe si rrjedhojë, rritje të këtij pozicioni në IHD në vend.

¹³ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Këtu përfshihen punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit).

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Zhvillimet në treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për rënie të vëllimit të prodhimit industrial dhe rënie të qarkullimit në tregtinë me pakicë në vitin 2020.

Grafik 9. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)



Indeksi i peshuar i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, është karakterizuar me rënie prej 1.2 përqind në vitin 2020. Rënie është shënuar tek furnizimi me ujë (23.7 përqind) dhe industria nxjerrëse (4.5 përqind), ndërsa tek sektori i furnizimit me rrymë dhe industria përpunuese është shënuar një rritje prej 2.0 përkatësisht 0.8 përqind (grafik 9).


Grafik 10. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2015=100)



Mesatarja e indeksit të qarkullimit në tregtinë me pakicë ka shënuar rënie prej 16.5 përqind, që është normë më e lartë e rënies krahasuar me sektorin e industrisë (grafik 10).


Si rezultat i përkeqësimit të aktivitetit ekonomik, iniciativa ndërmarrëse rezulton të ketë shënuar rënie.

Grafik 11. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja



Në vitin 2020 u regjistruan 9,805 ndërmarrje të reja apo 2.0 përqind më pak krahasuar me vitin 2020, ndërsa u mbyllën 1,326 ndërmarrje apo 25.0 përqind më pak krahasuar me vitin 2019. Sektorët të cilët shënuan rënien më të lartë në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara ishin kryesisht sektorët të cilët u ndikuan më së shumti nga masat kufizuese të qeverisë për të parandaluar përhapjen e virusit Covid-19, ndërkohë që kishte edhe sektorë në të cilët është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara (grafik 11).

Grafik 12. Borxhi i ndërmarrjeve



Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar të rritet por me ritëm më të ngadalësuar. Gjithsej borxhi i ndërmarrjeve shënoj rritje vjetore prej 11.0

përqind në vitin 2020 (grafik 12) dhe arriti në 41.7 përqind të BPV-së.

Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve kreditdhënëse në vend është rritur për 6.8 përqind (10.0 përqind rritje në vitin 2019), si rezultat i rritjes së kredive bankare prej 7.1 përqind, ndërsa kreditë e ndërmarrjeve të lëshuara nga ndërmjetësit tjerë financiarë shënuan rënie prej 1.9 përqind, por që mbesin me peshë të vogël në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve ndaj sektorit financiar (3.3 përqind). Në anën tjetër, borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve ka shënuar rritje prej 26.0 përqind duke arritur në 25.0 përqind të gjithsej borxhit nga 22.0 përqind sa ishte në vitin 2019.

Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në procesin e përafrimit të shkallës së ndërmjetësitimit financiar drejt vendeve të rajonit. Raporti i kreditimit të ndërmarrjeve nga institucionet kredi-dhënëse në vend, ndaj BPV-së, arriti në 31.2 përqind në vitin 2020 (28.0 përqind në 2019). Kjo rritje e raportit të kreditimit ndaj BPV-së ishte kryesisht rezultat i vlerësimeve për rënie të BPV-së ndërkohë që kreditimi shënoj rritje të ngadalësuar dhe rrjedhimisht hendeku i kredisë ndaj BPV-së ishte pozitiv.¹⁴

Pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoj rritje. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan normë të rritjes prej 10.9 përqind, ndërsa norma e rritjes së kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve ishte 6.8 përqind. Këto ecuri rezultuan në rritje të pozicionit debitor të ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar për 4.3 përqind (2.6 përqind rritje në 2019). Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të kredive dhe depozitave në valutë, në 0.02 përqind për kreditë në valutë ndaj gjithsej kredive, dhe 3.1 përqind për depozitat në valutë ndaj gjithsej depozitave të ndërmarrjeve.

Kreditë e reja për ndërmarrjet shënuan rritje për 4.4 përqind në vitin 2020 (9.7 përqind rritje në vitin 2019). Sipas qëllimit, kreditë e reja jo-investuese shënuan rënie prej 12.8 përqind dhe e zvogëluan pjesëmarrjen në strukturë nga 39.7 përqind në 33.2 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Kreditë e reja investuese shënuan rritje prej 15.3 përqind dhe e rritën pjesëmarrjen në strukturë nga 58.5 përqind në 64.6 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Në aspektin e maturimit, kreditë me maturitet mbi 5 vjet përbëjnë rreth 27.1 përqind të kredive të reja (15.9 përqind në vitin 2019) dhe shënuan rritje prej 76.8 përqind. Kategoritë tjera të kredive shënuan rënie. Kreditë mbi 2 vite deri në 5 vite, si kategoria kryesore, zvogëluan pjesëmarrjen nga 52.0 përqind në 44.7 përqind në strukturën e përgjithshme të kredive të reja për ndërmarrje.


Huamarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është mbështetur edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Në dhjetor 2020, numri i kredive të garantuara nga FKGK ishte 6,103 ndërsa shuma e miratuar e garancive arriti në 115.0 milionë euro. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, ku dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësim prej 9.1 përqind në gjithsej portfolion e kredive të garantuara.

Dinamikat e ndryshuara gjatë vitit 2020 dhe përballja me krizën ekonomike dhe sociale si pasojë e masave të ndërmarra për të menaxhuar krizën shëndetësore kanë fuqizuar tutje rolin e FKGK-së në mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike përmes lehtësimit të qasjes në financa. Për të mbështetur nevojat e sektorit privat për likuiditet afatshkurtër dhe investime përmes krijimit të dritareve garantuese për segmente të caktuara të tregut

¹⁴ Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

që janë prekur më shumë nga pandemia, në vitin 2020, FKGK ka nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Kosovës për rritje të kapitalit garantues për 22.3 milionë euro. Po ashtu, janë nënshkruar edhe dy marrëveshje të tjera financiare për rritje të kapitalit garantues me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) në vlerë prej 6.5 dhe 5.0 milionë euro.

Grafik 13. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK




Burimi: FKGK.

Gjithashtu, në vitin 2020, me qasje të fokusuar në adresimin e sfidave të ngritura nga kriza pandemike, FKGK në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe donatorë ndërkombëtar lansuan Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike. Kjo pako përbën një linjë të re garantuese që ka për qëllim mbështetjen e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përmes garantimit të kredive. Kjo pako i ka mundësuar FKGK-së rritjen e mbulueshmërisë me garanci kreditore nga 50 përqind në 80 përqind, duke ofruar më shumë siguri bankave që në këtë mënyrë të rrisin kreditimin dhe ta zvogëlojnë mungesën e likuiditetit në treg. Në kuadër të kësaj pakoje do të operojnë pesë dritare të cilat do të adresojnë nevojat e segmenteve të caktuara të tregut, në vlerë deri në 202 milionë euro për një periudhë një vjeçare. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike, kryesisht do të mbështesë kreditimin në sektorin e prodhimit, agrobiznesit, shërbimeve, tregtisë, me fokus të veçantë gratë në biznes, bizneset e reja dhe investimet në eficiencë të energjisë.

Kostoja e huamarrjes për sektorin e ndërmarrjeve ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak.

Norma mesatare e interesit në kreditë e reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 6.0 përqind në vitin 2020, që paraqet një rënie të lehtë krahasuar me normën prej 6.3 përqind në vitin 2019, kryesisht si rezultat i rritjes së presioneve të konkurrencës në treg (grafik 14).

Grafik 14. Normat e interesit për ndërmarrjet




Burimi: BQK.

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare, sikurse ai i ndërmarrjeve, është rritur por me ritëm të ngadalësuar. Gjithsej borxhi i ekonomive familjare shënoi rritje prej 4.3 përqind në vitin 2020 dhe arriti në 19.3 përqind të BPV-së. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar ka shënuar rritje prej 7.0 përqind, ndërsa borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare shënoi rënie prej 9.2 përqind.

Grafik 15. Borxhi i ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Në anën tjetër, borxhi i jashtëm i ekonomive familjare ka shënuar rënie prej 19.9 përqind dhe ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e ekonomive familjare (2.6 përqind) (grafik 15).

Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare shënuan rënie. Gjithsej borxhi i ri ndaj bankave ishte më e ulët për 2.4 përqind krahasuar me vitin 2019. Sipas qëllimit, kreditë e reja konsumuese dhe ato investuese ishin më të ulëta për 4.0 përkatësisht 52.1 përqind, ndërsa kreditë hipotekare shënuan rritje për 12.7 përqind. Rënia e kredive konsumuese ndikoi që pjesëmarrja e lartë e këtyre kredive në gjithsej kreditë e reja për ekonomitë familjare të zvogëlohet në 70.5 përqind, nga 71.7 përqind sa ishte në vitin 2019. **Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje si rezultat i përshpejtimit të rritjes së depozitave krahasuar me kreditë.**

Grafik 16. Depozitat e ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 2.9 miliardë euro¹⁵, që paraqet rritje vjetore prej 12.9 përqind (grafik 16). Gjithashtu, kreditë vazhduan rritjen prej 7.0 përqind dhe arritën vlerën 1.2 miliardë euro. Si rezultat, pozicioni kreditor, që tradicionalisht këtë pozicion e kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar, shënoj rritje prej 17.2 përqind. Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rritje të pozicionit të tij kreditor në valutë për 12.7 përqind, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë prej 12.2 përqind, përdërisa kreditimi në valutë, që ka një pjesëmarrje prej vetëm 0.2 përqind të gjithsej kredive për ekonomitë familjare, shënoj rënie prej 11.3 përqind. **Kursimet e ekonomive**

¹⁵ Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

familjare, në formë të depozitave të transferueshme, depozitave të afatizuara dhe depozitave të kursimit shënuan rritje. Rritja e depozitave të ekonomive familjare, mund t'i atribuohet, ndër të tjera, rritjes së të hyrave në ekonomi (rritja e remitencave, tërheqja e 10 përqindëshit të kursimeve pensionale në FKPK-së, kufizimit të shpenzimeve si pasojë e pasigurive të shkaktuara nga pandemia Covid-19), si dhe ngritjes graduale të normës së interesit në depozita e cila ka ndikuar në zvogëlimin e kostos oportune të mbajtjes së kursimeve dhe afatizimit të mjeteve, gjegjësisht në rritjen e kursimeve të ekonomive familjare, përkundër rënies së aktivitetit ekonomik (grafik 17).

Grafik 17. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Gjithsej depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 12.9 përqind (11.5 përqind rritje në vitin 2019). Depozitat e afatizuara shënuan rritje prej 2.2 përqind, ndërsa norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara ishte 1.43 përqind apo 0.09 pikë përqindje më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Edhe depozitat e kursimit shënuan rritje prej 7.3 përqind ndërkohë që norma e interesit në depozita të kursimit ishte e pandryshuar (0.35 përqind) krahasuar me vitin 2019. Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare shënoj rënie të lehtë, ndikuar nga presionet konkurruese si dhe rënies së aktivitetit ekonomik. Norma mesatare e interesit në kreditë e reja konsumuese prej 7.0 përqind në vitin 2019 zbriti në 6.7 përqind në vitin 2020. Ndërsa, norma e interesit tek kreditë investuese ra në 9.7 përqind nga 10.6 përqind sa ishte në vitin 2019.

Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	900.6	1001.1	1,104.7	1,182.2
prej të cilave në valutë	3.0	2.6	2.6	2.3
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,164.2	2,334.2	2,601.9	2,937.0
prej të cilave në valutë	122.6	140.4	138.5	155.4
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,263.5	1,333.1	1,497.3	1,754.8
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	2,522.1	2,901.0	3,041.4	3,211.7
Shkalla e varësisë ekonomike	250.0%	268.0%	253.0%	255.0%

Burimi: BQK.

Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, ku remitencat u rritën për 15.1 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve¹⁶ shënoi rritje vjetore prej 3.7 përqind. Deri në shtator të vitit 2020, paga mujore neto, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore¹⁷, ishte në intervalin 400 deri në 500 euro. Sa i përket tregut të punës, shkalla pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte 37.3 përqind deri në shtator 2020 apo 3.2 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Pra është rritur shkalla e jo aktivitetit për 3.2 pikë përqindje dhe ka arritur në 62.7 përqind.

Shkalla e punësimit ka rënë në 27.8 përqind që është për 2.3 pikë përqind më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Edhe treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin në mes të popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, deri në shtator 2020 është rritur në 255.0 përqind, nga 253.0 përqind sa ishte në vitin 2019. Në anën tjetër, shkalla e papunësisë mbeti e pandryshuar (25.6 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.


¹⁶ Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks.gov.net/media/5369/anketa-e-fuqise-punetore-afp-2019.pdf>

4. Zhvillimet në sistemin financiar

Sistemi financiar shënoi rritje të aktivitetit gjatë vitit 2020, përkundër përbaljes me sfidat e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Të gjithë sektorët përbërës kontribuan në rritje, rritje që ishte më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Vlera e aseteve të sistemit financiar arriti në 7.91 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 8.9 përqind (rritje prej 14.9 përqind në vitin 2019). Shkalla e ndërmjetësimit financiar (raporti i aseteve ndaj BPV-së) u rrit për 13.8 pikë përqindje, në 116.2 përqind, ndikuar kryesisht nga rënia e BPV-së në vitin 2020 si pasojë e ndikimit negativ të Covid-19 në aktivitetin ekonomik në vend dhe jashtë tij (grafik 18).

Grafik 18. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së



Burimi: BQK.


Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, zërat që kishin kontributin më të madh në rritje ishin kreditë dhe bilanci me BQK, përderisa rritja e aseteve të sektorit mikrofinanciar i atribuohet kryesisht rritjes së bilancit me bankat komerciale. Sektori pensional, përkundër masës së tërheqjes së 10 përqind të mjeteve nga kontribut-dhënësist, shënoi rritje të aseteve, të mundësuar nga rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe si dhe nga kthimi pozitiv nga investimet. Asetet e sektorit të sigurimeve u zgjeruan po ashtu, me rritje më të theksuar në kategorinë e depozitave të mbajtura në bankat

komerciale, (kryesisht në formë të depozitave të afatizuara), pasuar nga investimi në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Kutia 2. Tërheqja e 10 përqind të mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)

Ligji nr. 07/L-016 për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19 i cili hyri në fuqi me datën 4 dhjetor 2020 mundësoi tërheqjen e 10 përqind të mjeteve pensionale nga qytetarët kontributdhënës, me vlefshmëri për aplikim për katër muajt vijues. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) zotëron 99.6 përqind të mjeteve të sektorit pensional, në vlerë prej 1.99 miliardë euro.

Grafik 1. Tërheqja e 10% të mjeteve të trustit, dhjetor 2020




Burimi: FKPK.

Që nga fillimi i aplikimit për tërheqje të mjeteve e deri më 31.12.2020, FKPK-ja ju ka kthyer qytetarëve mjete të kursyera¹⁸ në vlerë prej 185.4 milionë euro. Pra, deri në fund të dhjetorit 2020, 397.6 mijë persona kanë shfrytëzuar të drejtën për të tërhequr kursimet e tyre nga 644.6 mijë sa janë në total, apo në përqindje i bie rreth 61.7 përqind e kontributdhënësve kanë shfrytëzuar këtë të drejtë. Kurse, deri në 6 prill 2021, ditën e fundit për aplikim për tërheqje të mjeteve nga FKPK-ja, shuma e tërhequr arriti në 198.0 milionë euro, ku rreth 66.3 përqind e kontributdhënësve shfrytëzuan këtë të drejtë.

Siç mund të shihet dhe në grafikun 1, të drejtën për të tërhequr mjetet në trust shfrytëzuan në masë më të madhe kontribut-dhënësit të cilët kishin nivel më të lartë të kontributeve të kursyera. Rreth 93.7 përqind e qytetarëve me të drejtë të tërheqjes nga 501 - 1,000 euro shfrytëzuan këtë të drejtë.

¹⁸ Kontributet e arkëtuara dhe kthimi në investime nga mjetet e investuara në tregun e jashtëm dhe të brendshëm. Të dhënat janë marrë prej Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.


Grafik 2. Kursimet në trust të qytetarëve, dhjetor 2020



Burimi: FKPK.

Kjo kategori përfaqëson 11.3 përqind të gjithë kursimeve të trustit (grafik 2), dhe tërhoqi mjete në vlerë prej 50.8 milionë euro. Ndërsa, pjesëmarrjen më të lartë në gjithë kursimet e trustit, prej 21.0 përqind, kishin qytetarët të cilët mund të tërhoqnin mjete nga 11 - 50 euro, dhe këtë të drejtë shfrytëzuan vetëm 41.3 përqind e qytetarëve.

Grafik 3. Shuma mesatare e tërhequr në trust, sipas kategorive



Burimi: FKPK.


Pra, në grafikët 1 dhe 2 mund të vërehet që pjesa dërmuese e qytetarëve (79.5 përqind) kanë mundur të tërhoqnin mjete në vlerë nën 500 euro, kurse pjesa tjetër prej 20.5 përqind mbi 500 euro.

Në grafikun 3 është paraqitur shuma mesatare e cila është tërhequr sipas kategorive të caktuara. Qytetarët të cilët kanë aplikuar për tërheqje të mjeteve në vlerë deri në 10 euro, në mesatare kanë arkëtuar shumën prej 6 euro, kurse në ekstrem tjetër, qytetarët të cilët kanë pasur kursime në vlerë mbi 4,000 euro, kanë arkëtuar në mesatare shumën prej 5,526 euro. Vlen të cekët që mesatarja e tërhequr nga trusti prej kontribut-dhënësve ishte rreth 466.22 euro për person, e që është lehtësisht më e lartë se paga mesatare neto në Kosovë për vitin 2019 prej 430 euro.

Në kuadër të ligjit për rimëkëmbje ekonomike Covid-19, mjetet e tërhequra nga pjesëmarrësit të cilët kanë kursime deri në 9,999 euro do të kompensohen në formë të rimbursimit duke filluar nga vitit 2023. Pra, rreth 346.6 mijë pjesëmarrësve, të cilët përfaqësojnë 59.1 përqind të gjithë

kontributdhënësve, do t'i rimburohen mjetet e tërhequra, shuma totale e të cilave kapë vlerën prej rreth 96.4 milionë euro.

Grafik 4. Zhvillimet në FKPK gjatë vitit 2020



Burimi: FKPK.


FKPK-ja, si rezultat i tërheqjes së 10 përqind të mjeteve pensionale, shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes së aseteve, përkatësisht rritje vjetore të aseteve prej 1.1 përqind në dhjetor 2020, e që paraqet rritjen më të ngadalësuar që prej fillimit të funksionimit. Megjithatë, kontributet e arkëtuara gjatë vitit 2020 si dhe kthimi në investime kompenzuan në masë të madhe tërheqjen prej 185.4 milionë euro gjatë muajit dhjetor 2020, ndaj dhe FKPK-ja mbylli vitin me rezultat pozitiv (rritje). Vetëm në TM4 2020, FKPK arkëtoi të hyra në vlerë prej 118.0 milionë eurosh (58.7 milionë euro prej kontributeve të arkëtuara dhe 59.4 milionë euro kthim prej investimeve) (grafik 4). Kurse, gjatë tërë vitit 2020, pavarësisht përballjes me pandeminë Covid-19 dhe efekteve negative të shkaktuara në tregjet financiare, politikat konservatore të FKPK-së rezultuan në kthim në investime prej 71.9 milionë euro dhe kontribute të arkëtuara në vlerë prej 194.4 milionë euro.

Efektet e tërheqjes së mjeteve të trustit në sektorët tjerë financiar

Tërheqja e 10 përqind të mjeteve pensionale ka ndikuar në rritje të theksuar të aseteve të sektorit bankar, të cilat në dhjetor u shtuan për 225.6 milionë euro krahasuar me 78.3 milionë euro në nëntor 2020 (mesatarja mujore e rritjes gjatë periudhës janar-nëntor 2020 ishte për 33.4 milionë euro). Niveli i depozitave në dhjetor 2020 u rrit për 215.4 milionë euro krahasuar me 66.9 milionë euro në nëntor 2020 (mesatarja mujore e rritjes gjatë periudhës janar-nëntor 2020 ishte 21.4 milionë euro). Kryesisht, rritja e theksuar e depozitave reflekton ecurinë e depozitave të ekonomive familjare, të cilat historikisht paraqesin edhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit të bankave.

Për më tepër, në dhjetor 2020, niveli i rezervave mbi rezervën e obliguar ishte për 302.1 milionë euro më e lartë, e që është dukshëm më e lartë se + 179.6 milionë euro në muajin paraprak, dhe +186.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 5).

Grafik 5. Rezerva e aseteve mbi apo nën rezervën e obliguar




Burimi: BQK.

Transferimi i mjeteve pensionale në llogari bankare të qytetarëve ka ndikuar edhe në rritje të theksuar të numrit dhe vlerës së transaksioneve përmes sistemit të pagesave i cili operohet dhe mbikëqyret nga BQK-ja.

Numri i transaksioneve të kategorisë ‘pagë/pension’ në dhjetor 2020 arriti vlerën në 879.5 mijë sosh (mesatare mujore prej 472.5 mijë sosh gjatë periudhës janar-nëntor 2020), kurse vlera e transaksioneve arrit në 316.0 milionë euro (119.9 milionë euro mesatarja mujore gjatë periudhës janar-nëntor 2020) (grafik 6).


Grafik 6. Vëllimi i transaksioneve të SPN-së paraqitur në numër dhe vlerë në kategorinë ‘pagë pension’



Burimi: BQK.

Numri i bankave komerciale që operojnë në Kosovë u rrit në 11, si rezultat i licencimit të një banke të re me kapital të huaj. Ndërsa numri i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jo-bankare u zvogëluua në 18, si pasojë e tërheqjes së licencës së dy institucioneve.

Grafik 19. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar



Burimi: BQK.

Në tremujorin e tretë të vitit 2020, BQK licencoi për operim në Kosovë një bankë të re, ‘Banka Credins Kosovë’ SH.A. Themelues dhe aksionar i vetëm i saj është “Banka Credins

Sh.A.” nga Shqipëria, e cila operon nga viti 2003 dhe është një prej bankave më të mëdha.¹⁹ Numri i fondeve të pensioneve, kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve në sigurime mbeti i pandryshuar nga viti i kaluar (tabela 4). Ndhimesit financiarë kanë numrin më të madh të institucioneve financiare, megjithëse pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit financiar vazhdon të qëndroj në 0.2 përqind (grafik 19).

Kapitali i huaj mbizotëron pjesën më të madhe të sektorëve të sistemit financiar, e veçanërisht sektorëve që merren me aktivitet kreditues (grafik 20). Sektori bankar dominohet nga kapitali me prejardhje nga BE, që përbën 55.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Bankat vendore kishin prezencë të ngjashme me vitin e kaluar në tregun bankar prej 13.5 përqind. Bankat me origjinë nga Turqia shënuan rënie të lehtë të pjesëmarrjes në treg, me një pjesëmarrje prej 16.0 përqind në 2020 (16.5 përqind në 2019).


¹⁹ Banka Credins Kosova nuk është e përfshirë në statistikat e raportuara për sektorin bankar në vitin 2020.

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
Bankat komerciale	10	10	10	10	11
Siguruesit	15	15	14	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	48	52	51	54	61
Ndërmjetësuesit në sigurime	15	16	13	16	16
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	16	18	22	20	18

Burimi: BQK.

Rritja në konkurrencën e shërbimeve u reflektua në uljen e shkallës së koncentrimit bankar²⁰ në 55.8 përqind nga 56.8 përqind në vitin e kaluar. Sektori i sigurimeve vazhdon të ketë nivel më të ulët të koncentrimit si rrjedhojë e shpërndarjes më të baraspeshuar të aseteve në treg. Për më tepër, të dhënat tregojnë rënie të mëtutjeshme të koncentrimit krahasuar me vitin e kaluar.


Grafik 20. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2020


Burimi: BQK.

Kompanitë e sigurimit me kapital vendor përbëjnë 50.9 përqind të gjithë aseteve të sektorit, nga 49.9 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, kompanitë me kapital të huaj me pjesëmarrje prej 49.1 përqind kanë vend të origjinës Austrinë, Slloveninë dhe Shqipërinë (grafik 20).

Sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë të bilancit, përkitazi me modelin tradicional të aktiviteteve, me ndërlidhje minimale ndërmjet sektorëve të sistemit. Gjatë këtij viti, shkalla e ndërlidhjeve të bankave të huaja me bankat e tyre amë është rritur, nxitur nga rritja e pasigurive dhe njëkohësisht

nevojës së sigurimit të linjave emergjente për likuiditet, përkatësisht rritje të kapacitetit absorbues për humbje të mundshme si rezultat i krizës pandemike.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës


Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion, përjashtuar Qeverinë Qendrore ku është marrë për bazë gjithë detyrimet që i ka në formë të letrave me vlerë ndaj këtyre institucioneve. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2020.

Ndërlidhjet mes akterëve të sektorit nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në vitin 2020. Lidhjet kryesore qëndrojnë në formë të depozitave në BQK dhe banka komerciale (figura 1). Megjithatë, niveli i këtyre ndërlidhjeve është i ulët, duke minimizuar kështu mundësitë e bartjes së problemeve dhe rreziqeve nga një institucion në tjetrin.

Ndërlidhja më e theksuar qëndron në mes të bankave komerciale dhe BQK-së, që

²⁰ Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithë aseteve të sektorit


përfaqësohet në formë të depozitave për rezervën e detyrueshme dhe tepriçën e kësaj rezerve që bankat e mbajnë në BQK. Kompanitë e sigurimeve dhe fondet pensionale po ashtu mbajnë kërkesa, në formë të depozitave (llogarive rrjedhëse) ndaj BQK-së, e që së bashku me bankat komerciale në dhjetor 2020 përbënin 51.0 përqind të gjithsej depozitave të BQK-së. Depozitat që institucionet financiare jo-bankare mbajnë në banka komerciale paraqesin ekspozim të konsiderueshëm ndër-institucional (përfshirë ekspozimin ndaj qeverisë) për disa nga këto institucione. Kompanitë e sigurimeve mbajnë si depozita në banka komerciale rreth 46.4 përqind të asetëve të tyre. Ndihmësit financiar, në dhjetor 2020, zvogëluan pjesëmarrjen e bilancit me bankat komerciale në gjithsej asetet e tyre në 42.5 përqind nga 45.3 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, fondet pensionale dhe mikrofinancat kishin 6.5 përqind dhe 10.7 përqind, respektivisht, të asetëve të tyre si depozita në banka komerciale. Depozitat e këtyre institucioneve konsistojnë 6.0 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar. Rrjedhimisht, rëndësia e sektorit bankar në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar është e pa kontestueshme dhe likuiditeti i sektorit bankar paraqet faktor me rëndësi në funksionimin stabil të këtyre institucioneve, pasi që në kontekst të ndërlidhjeve, depozitat përbëjnë kanal kryesor për bartje të mundshme të problemeve ndër-institucionale. Ndërsa, kërkesat e bankave komerciale ndaj institucioneve të tjera financiare jo-bankare, që përfaqësohen në formë të kredive, përbëjnë rol minor në ndërlidhjet financiare marrë parasysh që këto kredi përbëjnë vetëm 0.2 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar.

Në figurën e ndërlidhjes është përfshirë edhe ekspozimi i sistemit financiar ndaj Qeverisë Qendrore, i shprehur në formë të letrave me vlerë. BQK është një ndër investuesit kryesor në letrat me vlerë të qeverisë, përmes tregut sekondar, pasuar nga fondet pensionale dhe bankat komerciale. Institucionet e tjera financiare gjithashtu kanë kërkesa ndaj Qeverisë në formë të letrave me vlerë qeveritare, ndërsa qeveria ka kërkesa

(ekspozim) vetëm ndaj BQK-së dhe bankave komerciale përmes depozitave që mban në këto institucione.

Lidhjet ndërbankare janë akoma më të koncentruara se sa ato ndër institucionale, ku disa banka që janë relativisht më të vogla kanë ekspozime të theksuara ndërmjet tyre brenda sistemit financiar në vend (figura 2). Bankat e mëdha ekspozimet kryesore i kanë në tregjet e jashtme, ndaj bankave amë apo edhe bankave e institucioneve të tjera financiare.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e asetëve të secilit institucion bankar, përfshirë bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia vizë-lidhëse dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2020.

Lidhjet e theksuara ndërmjet katër bankave në vend të paraqitura në grafikun më lartë, përfaqësohen kryesisht në formë të burimeve të financimit siç janë depozitat. Lidhja më e theksuar paraqitet në mes të bankës H me bankën I, për shkak të kërkesave financiare në formë të depozitave të afatizuara që banka H ka ndaj kësaj banke, e që njëkohësisht përbën burim financimi për këtë të fundit. Njëkohësisht, Banka C ka ndërlidhje të theksuar me bankën I dhe bankën B, në formë të kërkesave ndaj tyre po ashtu në formë të depozitave. Krahasuar me vitin paraprak, ndërlidhja e disa prej bankave të sektorit me bankat amë u shumëfishua gjatë këtij viti, për shkak të kërkesave për rritjen e kapacitetit absorbues në rast të përkeqësimit të portfolios

kreditore si pasojë e ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit. Ndërlidhjet me bankat amë përkatëse janë më të theksuarat tek bankat G, F, E dhe B, kryesisht në formë të detyrimeve në formë të depozitave si dhe borxhit të ndërvarur. Përderisa, banka D ka ndërlidhje të theksuar me bankën amë në formë të kërkesave ndaj saj, përkatësisht depozitave në bankën amë dhe degët e tjera të grupit.

4.1. Aktiviteti bankar


Sektori bankar gjatë vitit 2020 u karakterizua me rritje të aktivitetit, përkatësisht rritje të kreditimit, dhe zërave tjerë bilancor si paraja e gatshme dhe bilanci me BQK, si dhe bilanci me bankat komerciale. Asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 12.4, dhe arritën vlerën prej 5.35 miliardë euro. Aktiviteti kreditor shënoi ngadalësim të rritjes, kryesisht si pasojë e krizës pandemike dhe efekteve të saj në ekonomi.

Në rrethana të rritjes relativisht të lartë të depozitave të arkëtuara gjatë vitit, si dhe në pamundësi të alokimit të mjeteve në kreditim, bankat plasuan mjetet në zëra tjerë bilancor. Rritje të lartë vjetore kishin kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK (rritje vjetore prej 27.0 përqind) dhe kategoria e bilancit me bankat komerciale (rritje vjetore prej 27.1 përqind). Në kuadër të kategorisë së parasë së gatshme dhe bilancit me BQK, rritje kishin rezervat e mbajtura nga bankat komerciale në BQK, përderisa në kategorinë e bilancit me bankat komerciale, rritje kishte plasimi i mjeteve në sektorin e jashtëm kryesisht në formë të depozitave të transferueshme. Pasiguritë dhe mundësitë e kufizuara për investim të mjeteve ndikuan që rezervat e mbajtura në BQK nga bankat të rritën për 34.6 përqind krahas vitit paraprak, përkundër vazhdimit të normës negative të interesit të aplikuar nga BQK mbi tepricën e rezervës obligative.

Sektori nuk ka pësuar ndryshime strukturore në anën e aseteve ndër vite, me përjashtim të nënkategorisë së letrave me vlerë që shënoi

rritje nga viti 2012 si rezultat i fillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjes aktive të bankave në këtë treg (grafik 21).

Grafik 21. Struktura e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Stoku i letrave me vlerë shënoi rritje vjetore prej 11.0 përqind. Investimet e sektorit bankar në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës u zvogëluan për 11.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, ndërsa investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja, shënuan rritje prej 21.4 përqind.


Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, të cilat në këtë vit shënuan rritje vjetore dyshifrore përkundër krizës së pandemisë Covid-19.

Gjithsej depozitat e sektorit shënuan rritje vjetore prej 11.5 përqind dhe arritën nivelin prej 4.36 miliardë euro, ndikuar kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme të ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve (publike dhe private), si dhe në nivel më të ulët depozitave të kursimit të ekonomive familjare. Në vitin 2020, depozitat përfaqësuan 81.4 përqind të burimeve të financimit të sektorit bankar (grafik 22).

Depozitat e ekonomive familjare, që përbëjnë 67.4 përqind të gjithëj stokut të depozitave, shënuan rritje prej 12.9 përqind (grafik 23). Pandemia Covid-19 ka ndikuar në rritjen e pasigurive për nivelin e të ardhurave tek ekonomitë familjare, duke ndikuar kështu në mbajtjen e mjeteve në dispozicion për tejkalimin e vështirësive të mundshme,

përkatësisht rritjen e depozitave të transferueshme. Pasiguritë për ecurinë e pandemisë, e rrjedhimisht masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 gjithashtu kanë ndikuar në mungesën e hapësirës për konsum në këtë periudhë, gjë që ka favorizuar rritjen e depozitave.

Grafik 22. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Në dinamikën e depozitave të ekonomive familjare rol të rëndësishëm kanë edhe remitencat, niveli i të cilave vazhdoi të rritet edhe gjatë vitit 2020. Përkundër numrit shumë më të vogël të vizitave të bashkatdhetarëve në vend, në rritjen e remitencave ka ndikuar dërgimi më i lartë i remitencave përmes kanaleve formale si institucionet financiare. Megjithatë, vazhdimi i gjendjes pandemike dhe ndikimi i saj negativ në aktivitetin ekonomik dhe nivelin e të ardhurave, mund të reflektohet në nivel më të ulët të rritjes së depozitave në vitin 2021. Gjithashtu, efekti i pandemisë në ekonomitë e shteteve prej ku edhe vijnë një pjesë e madhe e remitencave, mund të reflektohet në nivelin e remitencave, me efekt përcjellës edhe në dinamikën e depozitave.

Viti 2020 u karakterizua me rritje të depozitave edhe nga korporatat jo financiare dhe publike, përderisa depozitat e korporatave financiare shënuan rënie të ndikuar nga depozitat e fondeve pensionale.

Në kuadër të sistemit financiar, kompanitë e sigurimeve rritën nivelin e depozitave të mbajtura në bankat vendore, si pasojë e profitabilitetit më të lartë të sektorit gjatë vitit 2020 dhe mundësive më të kufizuara të

investimit të mjeteve në rrethanat e pasigurive të shtuara nga pandemia Covid-19. Ndërsa, fondet pensionale zvogëluan depozitat e afatizuara në sektorin bankar, kryesisht si pasojë e tërheqjes së 10 përqind të kursimeve pensionale nga kontribut-dhënësit.

Grafik 23. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Burimi: BQK.


Për shkak të nivelit më të ulët të alokimit të mjeteve në aktivitet kreditues, sektori mikrofinanciar po ashtu rriti depozitat në sektorin bankar, mirëpo pjesa më e madhe e këtyre depozitave ishte në formë të depozitave të transferueshme. Depozitat nga korporatat jofinanciare shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar, ndikuar kryesisht nga rënia e depozitave të afatizuara. Nevoja e korporatave jofinanciare për financimin e aktiviteteve të tyre biznesore nga depozitat, si pasojë e rënies së të ardhurave apo pasigurive në realizimin e tyre për shkak të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, mund të ketë ndikuar këtë ecuri.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të jetë i ulët, por shënoi rritje të theksuar krahasuar me vitin paraprak. Pozicioni neto kreditor ndaj sektorit të jashtëm shënoi rritje të konsiderueshme, për 41.5 përqind, duke arritur vlerën në 610.8 milionë euro (grafik 24 dhe 25). Kjo rritje e theksuar e pozicionit neto kreditor ishte kryesisht rrjedhojë e investimeve në sektorin e jashtëm, në formë të depozitave dhe letrave me vlerë.

Kërkesat ndaj jorezidentëve zënë 16.5 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar, ku 89.2

përqind e tyre janë depozita dhe investime në letra me vlerë.


Grafik 24. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve



Burimi: BQK.

Detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve zënë 5.1 përqind të gjithë detyrimeve të sektorit bankar, në formë të linjave kreditore dhe depozitave të sektorit të jashtëm të mbajtur në vend. Kreditë e marra nga sektori i jashtëm dhe depozitat e sektorit të jashtëm të mbajtura në vend, së bashku përbëjnë 99.4 përqind të gjithë detyrimeve ndaj jorezidentëve.

Grafik 25. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK.

Me gjithë rritjen në periudhën e fundit, në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Niveli i ulët i aseteve në valutë të huaj zvogëlon më tej efektet e bartjes së problemeve nga sektori i jashtëm si dhe eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet jo të favorshme në kurset e këmbimit kundrejt valutës euro.


4.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar shënoi rritje të ngadalësuar kundrejt vitit

paraparak, kryesisht si pasojë e ndryshimit të dinamikave të ekonomisë së brendshme dhe të jashtme në përballje me pandeminë Covid-19.

Kreditimi nga bankat në vitin 2020 u zgjerua për 7.1 përqind, përderisa vlera e gjithëj kredive arriti në 3.25 miliardë euro (grafik 27). Dinamika e rritjes gjatë këtij viti rezultoi të jetë më e ngadalësuar në krahasim me rritjet dyshifrore të katër viteve të fundit, ecuri që sipas Anketës së Kreditimit Bankar rezultoi të jetë ndikuar si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 u reflektuan në rritjen e rrezikut të perceptuar nga bankat, përkeqësimin e perspektivës së tregut vendor dhe global, rënien e cilësisë së portfolios kreditore si dhe uljen e tolerancës së bankave ndaj rrezikut.

Grafik 26. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Ndërsa, në gjysmën e dytë të vitit kishte lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore dhe rritje të kërkesës për kredi, të ndikuar pozitivisht nga lehtësimi i masave parandaluese si dhe masat e ndërmarra nga BQK për pezullimin e pagesës së kësteve të kredive dhe tutje ristrukturimit të kredive si pasojë e pandemisë. Gjithashtu, bankat deklaruan se kontribut pozitiv dhanë edhe mbështetja e FKGGK-së në kreditim, rritja e presioneve të konkurrencës dhe qasja e favorshme në financim.

Stoku i kredive për ndërmarrjet shënoi rritje prej 7.2 përqind dhe arriti vlerën prej 2.05 miliardë euro. Ndërsa, kreditë e reja gjatë vitit 2020 ishin 935.5 milionë euro (grafik 27), nga

të cilat për qëllime investuese ishin 604.6 milionë euro, ndërsa kreditë për qëllime jo-investuese ishin 310.2 milionë euro.

Pothuajse të gjithë sektorët ekonomik u karakterizuan me rritje të kreditimit, përjashtuar bujqësinë, energjetikën dhe minierat që u karakterizuan me rënie. Sektorët që u kredituan më shumë ishin tregtia, ndërtimtaria dhe prodhimtaria.


Grafik 27. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro



Burimi: BQK.

Kreditë për sektorin e ndërtimit dhe të prodhimit u rritën për 61.7 përqind dhe 21.4 përqind, duke arritur vlerën prej 275.4 dhe 317.4 milionë euro, respektivisht.

Grafik 28. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Megjithatë, rritja e theksuar e kreditimit të ndërtimtarisë i atribuohet rikategorizimit nga një bankë të një pjese të portfolios kreditorë nga zëri i shërbimeve tjera kryesisht në atë të sektorit të ndërtimtarisë, por edhe në atë të prodhimit dhe të tregtisë.

Kreditë ndaj sektorit të tregtisë, i cili dominon strukturën e gjithsej kredive, shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind (grafik 28). Ndërsa,

sektori i bujqësisë, i cili ka peshë të vogël në gjithsej stokun e kredive të ndërmarrjeve, u karakterizua me rënie prej 22.1 përqind.


Grafik 29. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Me gjithë pasiguritë e vazhdueshme rreth pandemisë dhe efekteve të saj në rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik, pritët që masat mbështetëse rregullative ndaj bankave dhe mbështetja nga FKGK të kontribuojnë në rritjen e qasjes në financim dhe sigurim të likuiditetit të NVM-ve në përgjithësi, e veçanërisht sektorëve më të prekur, për të zbutur vështirësitë nga kufizimi i aktivitetit të tyre ekonomik si pasojë e zhvillimeve rreth pandemisë.

Grafik 30. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Trendi i rritjes së kreditimit të ekonomive familjare u ngadalësua, ndikuar nga kujdesi i shtuar në kreditimin e këtij sektori si pasojë e rritjes së pasigurisë mbi aftësinë e tij paguese, të nxitur gjithashtu nga kriza pandemike.

Kreditë e reja konsumuese shënuan rënie të ngjashme vjetore me vitin paraprak, pas një

periudhe disa vjeçare të rritjes dyshifrore. Në anën tjetër, kreditë hipotekare përsheptuan rritjen, që reflekton hapësirën më të madhe për kreditim të këtij segmenti si dhe rrezikshmërinë më të ulët për shkak të mbulesës me kolateral (grafik 2). Stoku i gjithsej kredive të ekonomive familjare në fund të vitit arriti në 1.18 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.1 përqind nga 10.4 përqind një vit më parë (grafik 26).

Kreditë me maturitet afatgjatë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej kredive me pjesëmarrje prej 49.6 përqind,²¹ shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 13.5 përqind. Vlera e tyre arriti në 1.61 miliardë euro.

Kreditë me maturitet afatmesëm kishin rënie të lehtë prej 0.5 përqind me vlerë prej 1.26 miliardë euro.

Kreditë me afat të mesëm maturiteti janë kryesisht të dominuara nga kreditë e lëshuara për korporatat jofinanciare (grafik 29), përderisa kreditimi afatgjatë është kryesisht karakteristikë e portofolios kreditore të segmentit të ekonomive familjare (grafik 30). Gjithashtu, sipas Anketës së Kreditimit Bankar (kutia 3), kreditë afatgjata për ekonomitë familjare u ndikuan pozitivisht si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi.

²¹ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

Kutia 3. Anketa e Kreditimit Bankar²²

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar²³ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës tetor - dhjetor 2020 (referuar si TM4 2020)²⁴, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën janar - mars 2021 (referuar si TM1 2021).


Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë TM4 2020, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht, edhe pse në nivel të ulët, si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar në masë të vogël

standardet kreditore të aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Standardet kreditore u lehtësuan në masë të ngjashme për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (NVM dhe ndërmarrjet e mëdha).

Për tremujorin e parë të vitit 2021, bankat pritet t'i lehtësojnë tutje standardet kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, bazuar në vendimet për lehtësimin e masave kufizuese dhe rrjedhimisht pritjeve për rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve në vend (grafik 31).

Grafik 31. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Faktorët kryesor që ndikuan në lehtësimin e standardeve kreditore, sipas deklaratimit të bankave, ishin mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK-ja, përmirësimi i perspektivës në tregjet globale, si dhe masat lehtësuese të ndërmarrja për menaxhimin e efekteve të pandemisë, si ristrukturimi i kredive për shkak të pandemisë Covid-19.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan në masë të ulët.

Mbështetja e ndërmarrjeve nga FKGK, perspektiva e mirë e tregut vendor, rritja e presioneve të konkurrencës, si dhe në një masë më të vogël lehtësimi i masave kundër përhapjes së virusit Covid-19 dhe perspektiva e mirë e tregut bankar në vend, ndikuan në lehtësimin e kushteve të kreditimit. Konkretisht, kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, kryesisht përmes uljes së normës së interesit, ndërsa për NVM-të

²² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës 9 banka që operojnë në Kosovë dhe përfaqësojnë 99.9 përqind të kreditimit të gjithsej sektorit. Anketa realizohet në baza tremujore. Kjo anketë përfshinë periudhën tetor - dhjetor 2019 dhe pritjet për periudhën janar - mars 2020.

²³ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar.

Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në ëeb faqen e BQK.


²⁴ Periudhës tetor - dhjetor i referohemi si 'tremujori i katërt' – TM4, ndërsa periudhës janar - mars i referohemi si 'tremujori i parë' – TM1.

gjithashtu kishte rritje të madhësisë së kredive (grafik 32).

Bankat deklaruan që duke u mbështetur në pritjet e mbështetjes nga FKGK për NVM-të, rritjen e presioneve të konkurrencës dhe masave lehtësuese të ndërmarrja për menaxhimin e pasojave të Covid-19 në ekonomi, bankat për TM1 2021 presin lehtësim të mëtutjeshëm të kushteve dhe rregullave. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që pritet të ofrojnë kryesisht kushte

dhe rregulla të lehtësuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, e veçanërisht për NVM-të. Kushtet dhe rregullat pritet të lehtësohen përmes normave më të volitshme të interesit, rritjes së madhësisë së kredive, zgjatjes së maturitetit dhe kërkesave më të vogla për kolateral. Ndërsa, rritja e rrezikut kreditor në vend dhe jashtë tij, u cilësua si faktor që pritet të kontribuoj negativisht në kushtet dhe rregullat e ofruara nga sektori bankar.

Grafik 32. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Gjatë periudhës raportuese, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezultoi të jetë rritur deri në një masë, megjithëse në anketën e kaluar, bankat kishin raportuar pritje për kërkesë të pandryshuar nga segmenti i ndërmarrjeve. Rritja e kërkesës për ndërmarrjet i atribuohet vetëm kërkesës nga NVM-të, përderisa për ndërmarrjet e mëdha kishte rënie të kërkesës për kredi mirëpo me indeks negativ marginal (grafik 33). Për më tepër, cilësia e aplikacioneve të pranuar u përmirësua, veçanërisht për NVM-të. Raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve mbeti i pandryshuar gjatë TM4 2020 sipas deklaratave të bankave në anketë.


Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga NVM-të në masë më të madhe u ndikua nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, përderisa kërkesa për financimin e investimeve fikse kontribuoi negativisht në kërkesën për kredi.

Përgjatë tremujorit vijues bankat presin ngritje të aktivitetit për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve si pasojë e lehtësimit të masave

të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Këto pritje u pasqyruan në parashikimet e bankave për ndryshimet në kërkesën për kredi gjatë TM1 2021. Rrjedhimisht, kërkesa pritet të rritet dukshëm nga të dy kategoritë, e veçanërisht nga NVM-të. Rritja e kërkesës për kredi pritet të ndikohet nga rritja e kërkesës së ndërmarrjeve për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Po ashtu, bankat presin rritje mirëpo në nivel të ulët të kërkesës për investime fikse.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditorë të ndërmarrjeve, bankat presin që raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të rritet deri në një masë gjatë tremujorit të ardhshëm. Sa i përket afatit kohor të kredive, rezultatet e anketës tregojnë se rritje më të madhe të kërkesës gjatë kësaj periudhe kishte për kreditë afatshkurtra. Kërkesa për kredi afatgjata kishte rritje gjithashtu, por në një shkallë më të vogël. Ndërsa, oferta kreditorë, e ndarë sipas maturitetit të kredive, mbeti pothuajse e pandryshuar për kreditë afatshkurtra dhe me indeks pozitiv marginal për kreditë afatgjata.

Grafik 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.


Në tremujorin e ardhshëm, bankat presin lehtësim të standardeve kreditore për të dy afatet kohore, e veçanërisht për kreditë afatgjata. Njëkohësisht, sa i përket kërkesës, bankat presin rritje të kërkesës për kredi për të dy afatet kohore, e karakterizuar me indeks pozitiv të ngjashëm (grafik 37).

Dinamikat e aktivitetit kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan pozitivisht si nga oferta kreditore ashtu edhe nga kërkesa. Marr parasysh që masat kundër parandalimit të përhapjes së Covid-19 u lehtësuan deri në një masë gjatë tremujorit të katërt e rrjedhimisht edhe aktiviteti ekonomik u normalizua deri në një masë, standardet

kreditore të aplikuar gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan për të dy llojet e kredive në nivel të përafërt (grafik 34). Sipas anketës së kreditimit bankar faktorët që kontribuan pozitivisht në standardet kreditore të aplikuar gjatë këtij tremujori ishin rritja e presioneve të konkurrencës, pozita e favorshme e likuiditetit të sektorit dhe qasja në financim, si dhe përmirësimi i perspektivës së tregjeve si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

Pritjet e bankave për TM1 2021 japin indikacione për lehtësim të standardeve kreditore në nivel të përafërt me atë të TM4 2020. Lehtësim në masë më të madhe pritet të aplikohet për kreditë konsumuese.

Grafik 34. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare në përgjithësi u lehtësuan deri në një masë në tremujorin e katërt të vitit 2020. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e

shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes uljes së normës së interesit, uljes së kërkesave për kolateral dhe në një nivel më të ulët rritjes së shumës së aprovuar dhe zgjatjes së afatit të maturitetit. Njëkohësisht, ulja e

normës së interesit kishte indeksin më të lartë pozitiv për kreditë e reja konsumuese gjatë këtij tremujori (grafik 35). Rritja e presioneve të konkurrencës, kosto e volitshme e financimit (pozita e volitshme e likuiditetit të bankave dhe qasja e favorshme në financim), perceptimi më i ulët i rrezikut si pasojë përmirësimit të

prospekteve në tregun në përgjithësi dhe atë bankar në veçanti, rezultojnë të kenë qenë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020.

Grafik 35. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Në tremujorin e ardhshëm pritet që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen deri në një masë. Lehtësim më i lartë pritet të aplikohet për kreditë për blerjen e shtëpive, i fokusuar në rritjen e madhësisë së kredive dhe uljen e

normës së interesit. Përderisa për kreditë konsumuese bankat presin të lehtësojnë kushtet dhe rregullat përmes uljes së kërkesës për kolateral dhe rritjes së shumës së kredive.

Grafik 36. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Bankat raportuan rritje të theksuar të kërkesës për kredi të ekonomive familjare. Të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare kishin rritje të kërkesës, mirëpo kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte rritje më të lartë se sa kërkesa për kreditë konsumuese (grafik 36). Rritja e kërkesës nga ekonomitë familjare kryesisht i atribuohet perspektivës së kënaqshme të tregut të patundshmërive dhe rritjes së besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive, dhe në një masë

më të ulët rritjes së financimit të shpenzimeve tjera. Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar kishte rritje deri në një masë për të dy kategoritë e kredive për ekonomitë familjare, e veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive. Sipas anketës, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare kishte rritje edhe pse në nivel të ulët, e i cili për tremujorin vijues nuk pritet të ketë lëvizje të rëndësishme.

Në tremujorin e parë të vitit 2021, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për kreditë për blerjen e shtëpive, përderisa kërkesa për kredi konsumuese pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar. Rezultatet

e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuon këto pritje rritjes së besueshmërisë së kredimarrësve dhe rritjes së kërkesës për financim të shpenzimeve tjera.

Grafik 37. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se ekonomitë familjare gjatë TM4 2020 kishin rritje të kërkesës për të dy afatet kohore, sidoqoftë kreditë me maturim afatgjatë kishin indeks pozitiv më të lartë se sa kreditë me maturim afatshkurtër.

kreditore do të orientohet në nivel më të lartë drejt kredive afatgjata, se sa në kreditë afatshkurtra, e që mund t'i atribuohet lehtësimit të masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe masave mbështetëse të ndërmarra nga institucionet e vendit. Përderisa, kërkesa për kredi pritet të ketë rritje më të lartë për kreditë afatshkurtra se sa për ato afatgjata (grafik 37).

Gjithashtu, oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive rezulton të jetë lehtësuar deri në një masë për të dy periudhat kohore me indeks pozitiv të përafërt. Për dallim nga TM4 2020, bankat presin që në tremujorin e ardhshëm lehtësimi në ofertën

Grafik 38. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të **qasjes në financim** gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve. Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i

bankave gjatë këtij tremujori u ndikua pozitivisht dhe në nivel të lartë si nga depozitat e ekonomive familjare ashtu edhe nga depozitat e ndërmarrjeve. Përderisa, burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme. Sipas maturitetit, bankat deklaruan rritje të konsiderueshme të depozitave afatshkurtra, përderisa për ato

afatgjata në këtë tremujor nuk kishte ndryshime të rëndësishme.


Për tremujorin e ardhshëm TM1 2021, bankat presin rritje të qasjes në financim, mirëpo në nivel më të ulët krahasuar me TM4 2020. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ketë rritje më të lartë se sa përmes depozitave të ndërmarrjeve. Për dallim nga tremujori i katërt i vitit 2020, në tremujorin vijues dy banka me rëndësi sistemike presin mbështetje në financim të aktivitetit bankar nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Njëkohësisht, një nga bankat po ashtu me rëndësi sistemike deklaroi se pret mbështetje në financimin nga banka amë, e që rrjedhimisht rezultoi me një indeks pozitiv të ulët. Në tremujorin vijues, anketat sinjalizojnë pritjet për vazhdimin e dominimit të financimit afatshkurtër, përderisa financimi afatgjatë nuk pritet të ketë ndonjë lëvizje të rëndësishme (grafik 38).

5. Rreziqet e sektorit bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2020 ka vepruar në një ambient me rreziqe të rritura, si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid-19. Mirëpo, sektori bankar ishte mirë i pozicionuar për të përballuar rreziqet e rritura, si rezultat i pozitës së favorshme në treguesit e shëndetit të tij, siç janë: pozita e mirë e kapitalizimit, likuiditetit, cilësia e lartë e portfolios kreditorë si dhe profitabiliteti i qëndrueshëm. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, i elaboruar në vijim, bënë vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar, që reflektojnë stabilitetin e tij në periudhën e fundit në raport me gjendjen historike ndër vite.

Grafik 39. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas. Indeksi është kalkuluar në baza tremujore, përmes të cilit vlerësohet nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut.²⁵

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare është shënuar rritje vjetore e ndjeshmërisë ndaj rrezikut (grafik 39). Indikatorët me rritje rreziku ishin ai i rrezikut kreditor, profitabilitetit dhe rreziut të tregut. Ndërsa, ulje e ndjeshmërisë u shënuar në

indikatorët e rrezikut të likuiditetit dhe kapitalizimit.

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor kryesisht i atribuohet nivelit të kredive jo performuese, që edhe pse në nivel mjaftë të ulët historik, kanë filluar të rriten gjatë këtij viti (grafik 40). Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit i atribuohet profitit më të ulët të realizuar nga bankat, që vjen si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt të hyrave.

Grafik 40. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve



Burimi: BQK.

Indikatorit që vlerëson ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut, i matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, ka shënuar rritje. Megjithatë, ky indikator ka peshë shumë të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar.

Kurse, ulja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit ishte si rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve likuide krahasuar me rritjen e detyrimeve afatshkurtra. Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut që vjen nga mjaftueshmëria e kapitalit i atribuohet rritjes së raportit të kapitalizimit, i ndikuar nga rritja më e lartë e kapitalit rregullativ (profiti i akumuluar nga vitet paraprake) krahasuar me rritjen e aseteve që bartin

²⁵ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

rrezik, ritmi i të cilave u ngadalësua si rezultat i ngadalësimit të kreditimit

Indeksi i përgjithshëm i agreguar sugjeron rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, krahasuar me mesataren historike të indeksit (2008–2019), por edhe me mesataren e katër viteve të fundit. Përkundër këtyre zhvillimeve që u nxitën nga efektet e pandemisë Covid-19, gjendja e treguesëve të shëndetit të sektorit bankar mbetet e kënaqshme meqë sugjeron për kapacitet përballues të rreziqeve ndaj të cilave mund të përballet sektori.

5.1. Rreziku kreditor


Përhapja e pandemisë Covid-19 ka ndikuar në rritjen e rrezikut kreditor të sektorit bankar. Rreziku i rritur, reflektohet në migrimin e kredive nga shtylla e parë me klasifikimin më cilësor kreditor drejt shtyllës së dytë, e cila shënoi rritje të pjesëmarrjes. Masat lehtësuese të ndërmarra nga BQK, përkatësisht ristrukturimi i kredive, ndikuan që rritja e rrezikut kreditor të materializohet vetëm pjesërisht në rritje të treguesit kyç të cilësisë së portfolios kreditor në këtë fazë - normës së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive.

Norma e KJP-ve ndryshoi trendin rënës që kishte në gjashtë vitet e fundit, duke u ngritur në 2.7 përqind, nga niveli më i ulët historik prej 2.0 përqind që u shënuar në fund të vitit 2019. Rritja fillimisht i atribuohet ndryshimit metodik të vlerësimit të rrezikut kreditor²⁶ sipas SNRF9, që hyri në fuqi në fillim të vitit.²⁷ Si rezultat i këtij ndryshimi, norma e KJP-ve u ngrit në 2.5 përqind në muajin shkurt 2020. Në vijim, rritja e KJP-ve reflekton rritjen e rrezikut të nxitur nga situata pandemike. Stoku i kredive joperformuese në fundvit shënoi rritje vjetore prej 39.8 përqind dhe arriti në vlerën 85.9 milionë euro (nga 61.5 milionë euro në vitin 2019 (grafik 41).

²⁶ [Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor prill 2019.pdf \(bqk-kos.org\)](#)

²⁷ Vlerësimi i rrezikut kreditor, përkatësisht klasifikimi i kredive dhe provizionimi ka pësuar ndryshim metodik, konform rregullores së re të Menaxhimit të Rrezikut Kreditor, të aprovuar në vitin 2019 dhe të implementuar nga fillimi i vitit 2020. Metodologjia e re bazohet në


Grafik 41. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive joperformuese



Burimi: BQK.

Me përhapjen e pandemisë Covid-19, BQK ndër morri masa për lehtësimin e sfidave të shkaktuara nga kjo situatë. Ndër to ishte ofrimi i mundësisë për ristrukturim të kredive, gjegjësisht shtyrje të afatit të pagesës së kësteve, si dhe ristrukturim të kredive përmes ndryshimit të një apo më shumë kushteve të kontratës (kutia 4).

Grafik 42. Kreditë e ristrukturuara, sipas fazave



Burimi: BQK.

Faza e parë e ristrukturimeve përfshinë moratoriumin në pagesën e kredive për periudhën mars – qershor 2020. Pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara në fazën e parë ishte më e lartë, 40.9 përqind²⁸ në qershor 2020, për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të huamarrësve të shkaktuar si rezultat i mbylljes totale të ekonomisë. Në fazën e dytë të ristrukturimeve, që filloi nga muaji qershor, pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ishte më e ulët, përkatësisht në


Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 (IFRS 9) për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe matjen e rezervave për humbjet e pritshme të kredisë (kutia 2).

²⁸ Në grafik raportohet bilanci i mbetur i kredive që janë ristrukturuar në fazën përkatëse.

11.5 përqind ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2020 (grafik 42).

Ristrukturimi i kredive gjatë kësaj periudhe, si dhe pezullimi i aplikimit të dispozitave të rregullta të klasifikimit kreditor, ka ndikuar që rritja e rrezikut kreditor të mos reflektohet plotësisht në klasifikimin e kredive nëpër shtylla sipas rrezikut.²⁹ Megjithatë, në pjesën e dytë të vitit ka migrim të kredive nga kategoria me cilësinë më të lartë të klasifikimit drejtë asaj me cilësi më të ulët, përkatësisht nga shtylla 1 drejt shtyllës 2 të klasifikimit kreditor. Nga janari i këtij viti ku pjesëmarrja e kredive të shtyllës 2 ishte 4.4 përqind, në dhjetor kjo pjesëmarrje u rrit në 11.2 përqind të kredive (grafik 43).

Grafik 43. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla



Burimi: BQK.

Kutia 4. Masat e ndërmarra nga BQK për adresimin e sfidave të shkaktuara nga Covid-19

Më 16 mars 2020, BQK mori vendim për pezullimin e përkohshëm të zbatueshmërisë së dispozitave të caktuara të disa rregulloreve të mbikëqyrjes së institucioneve kredidhënëse, si mbështetje për sfidat e krijuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe sistemin financiar.

Masat e ndërmarra nga BQK ishin në linjë me masat emergjente të ndërmarra në nivel ndërkombëtar për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe mbështetjen e ekonomisë dhe kredimarrësve. Masat, të cilat kanë implikime në treguesit e rrezikut kreditor, përfshijnë:

1. Moratorium në pagesën e kredive - pezullim i pagesave të kësteve të kredisë, pa ngarkesë të interesit

²⁹ Klasifikimi i kredive nëpër shtylla kreditore ka pësuar ndryshim metodik në vitin 2020. Nga klasifikimi i mëhershëm në 5 kategori (standard, vrotuese, nënstandard, të dyshimta, të humbura), sektori bankar në janar të vitit 2020 ka kaluar në sistemin e klasifikimit të kredive në tri shtylla të klasifikimit kreditor.

ndëshkimit, për kredimarrësit të cilët kanë hasur vështirësi financiare, si rezultat i rënies së të hyrave personale apo të bizneseve për shkak të Covid-19. Fillimisht moratoriumi u lejua nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020, i cili më pastaj u vazhduar për tre muaj deri më datën 16 qershor 2020.

2. Pezullim i aplikimit të dispozitave të rregullta në klasifikimin kreditor dhe provizionim³⁰, i cili ka mundësuar që gjatë periudhës së moratoriumit të kredive dhe fazës së ristrukturimit të kredive, kredimarrësve të mos iu aplikohen masa të përkeqësimit të klasifikimit kreditor dhe bankat të mos ngarkohen me kërkesë për provizione shtesë për këto kredi.

3. Pezullim i dispozitave të Regjistrimit Kreditor, i cili ka mundësuar që me rastin e pezullimit të pagesave të kredive, kreditë të mos klasifikohen dhe kredimarrësit të mos pësojnë përkeqësim të notës kreditore në Regjistrin e Kredive.

4. Lejim i ristrukturimit të kredive për kredimarrësit, të cilët sipas vlerësimit të institucioneve kredidhënëse, janë ndikuar negativisht nga pandemia Covid-19. Më datën 8 qershor 2020, BQK miratoi Udhëzues për Ristrukturim të Kredive për shkak të Covid-19³¹, i cili u dha mundësinë kredidhënësve të ristrukturojnë kreditë në mënyrë që kredimarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësinë të përmbushin detyrimet e parapara me kontratë. Sipas udhëzuesit në fjalë, ristrukturimi/masat lehtësuese përfshijnë: a) lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës, të cilat lidhen kryesisht me afatin (duke përfshirë grace periudhën për fillimin e pagesës së kredisë), kryegjënë dhe normën e interesit (duke mos përfshirë kapitalizimin e interesit, i cili nuk duhet të ndodhë); b) marrjen e kolateralit apo asetëve (pasurive) tjera për shlyerjen e pjesëshme të kredisë; dhe c) zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një kredimarrësi shtesë. Afati për aplikim për ristrukturim të kredive, fillimisht u lejua deri më 31 gusht 2020, për t'u zgatur më pastaj deri më 30 shtator 2020. Në shkurt 2021, BQK nxorri Udhëzues të ri për ristrukturim të kredive për shkak të Covid-19³², sipas të cilit u mundësua aplikimi për ristrukturim të kredive deri më 31 mars 2021, me afat maksimal të zgjedhjes shtesë të afatit të ripagimeve prej 9 muajve. Shtesë ndaj këtyre masave rregullative, BQK ndërmori **masën e përkohshme të ndalimit të shpërndarjes së dividendës**, me qëllim të ruajtjes së profitit të realizuar për mbulimin e kërkesave për provizione shtesë dhe humbjeve të mundshme kreditore.


³⁰ Pezullim i të gjitha dispozitave të rregullores së Aplikimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9, të cilat ndërliiden me klasifikimin dhe provizionimin kreditor.

³¹ Udhëzues për ristrukturim të kredive Covid-19.PDF (bqk-kos.org)

³² Udhëzues-per-ristrukturim-te-kredive.pdf (bqk-kos.org)

Ndryshimi i metodologjisë së klasifikimit të kredive pamundëson krahasim ndërmjet viteve të pjesëmarrjes së kredive nëpër shtylla kreditore. Rrjedhimisht, janë paraqitur ndaras kreditë sipas klasifikimit të vonesave përgjatë vitit për vitin aktual si dhe për vitet paraprake (grafik 44A dhe 44B).


Grafik 44 A. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e vjetër



Burimi: BQK.

Në metodën e mëhershme të klasifikimit, dy kategoritë e fundit, më konkretisht kreditë me vonesa mbi 90 ditë dhe mbi 180 ditë, janë konsideruar si kredi jo-performuese, ndërsa në metodën e re, tri kategoritë e fundit, përfshirë kategorinë me probabilitet të ulët të pagesës që kanë vonesa deri në 90 ditë, cilësohen si kredi jo-performuese.

Grafik 44 B. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re



Burimi: BQK.

Në dhjetor 2020, ekspozimet kreditore pa vështirësi (me vonesa më pak se 30 ditë), kanë rritur pjesëmarrjen në 96.9 përqind nga 95.7 përqind në mars 2020. Kreditë me vonesa deri në 90 ditë kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 0.5 përqind të gjithsej kredive, nga 1.8 përqind në mars 2020. Ndërsa, kreditë jo-performuese (me probabilitet të ulët të pagesës dhe pa vonesa, si dhe ato me vonesa mbi 90 ditë) kanë rritur

pjesëmarrjen në 2.7 përqind nga 2.5 përqind në mars 2020.

Siç u theksua më sipër, rritja e rrezikut kreditor si rezultat i efekteve negative të pandemisë Covid-19 në ekonomi nuk është reflektuar krejtësisht në rritje të kredive jo-performuese për shkak të masave të ristrukturimit të kredive. Përkeqësimi i treguesit kyç të cilësisë së portfolios kreditore, megjithatë, mund të pritët pas përfundimit të masave të ristrukturimit, që është më së largu në fund të vitit 2021 nën supozimin që nuk do të ketë zgjatje të afatit për ristrukturim përtej atij të muajit mars 2021.

Kutia 5. Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF 9) dhe provizionimi i humbjeve

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (International Accounting Standards Board- IASB) dhe organet tjera relevante, në vitin 2014 prezantuan standard të ri të bazuar në parime për raportim financiar të aseteve dhe detyrimeve financiare, i cili ka implikime në mënyrën se si bankat duhet të llogarisin dhe raportojnë humbjet financiare në pasqyrat e tyre. Ky standard i ri, Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 9, prezantoi konceptin e 'humbjeve të pritura kreditore' për llogaritjen e humbjeve. Korniza e humbjeve të pritura kreditore (HPK) sipas SNRF 9 ka implikime në trajtimin rregullator të provizioneve nga bankat si dhe në kornizën rregullative të kapitalit.

Standardi paraprak i llogaritjes së humbjeve kreditore është bazuar në kornizën e 'humbjeve të ndodhura', i cili ka njohur humbjet kreditore pasi që është siguruar provë evidente e atyre humbjeve. Ndërsa, korniza e 'humbjeve të pritshme kreditore' kërkon llogaritjen e humbjeve kreditore në vazhdimësi, duke konsideruar ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale si dhe ngjarjet e pritshme për të përcaktuar në çdo moment të raportimit ndryshimet në rrezikun kreditor të asetit dhe vlerën e humbjeve të pritura nga ai aset. Qasja e HPK-ve që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, është qasje me perspektivë në të ardhmen, e cila mundëson njohje më në kohë të humbjeve kreditore në krahasim me qasjen paraprake.

HPK-të reflektojnë humbjet e pritshme të kredisë të njësisë ekonomike. Korniza e HPK-ve është e aplikueshme te të gjitha asetet që janë subjekt i

kontabilitetit të zhvlerësimit sipas SNRF-së. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kreditor i bazuar në HPK duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohë të bëjë vlerësimin e kualitetit të kredive dhe mjeteve tjera, duke përfshirë edhe përcaktimin e adekuatshmërisë së rezervave për humbjet që lidhen me këtë rrezik. Humbjet nga huatë, aseti kryesor i bankave që do të jetë subjekt i vlerësimit dhe raportimit sipas SNRF 9, do të vlerësohen dhe klasifikohen si në vijim:

Shtylla 1 – Huatë në datën e origjinimit, si dhe kreditë e më hershme të cilat nuk kanë pësuar rritje ‘domethënëse’ të rrezikut kreditor që nga data e origjinimit. Në momentin e origjinimit/blerjes së kredisë, bankat duhet të llogarisin humbjet e pritura kreditore që mund të materializohen nga ato ekspozime brenda 12 muajve pas origjinimit dhe të ndajë provizionet përkatëse. Nëse, në datën e raportimit, rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, një bankë matë rezervat e humbjes për atë instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme dymbëdhjetë (12) mujore të kredisë siç është përcaktuar nga SNRF 9 për zhvlerësimin e instrumenteve financiare. Në përcaktimin se a ka ndodhur rritje domethënëse në rrezikun kreditor që nga data e origjinimit, bankat duhet të vlerësojnë ndryshimin në rrezikun e dështimit përgjatë kohëzgjatjes së ekspozimit,

përkatësisht ndryshimin në probabilitetin e dështimit. Të ardhurat nga interesi për klasën llogariten mbi bazën bruto të kredisë.


Shtylla 2 – Huatë të cilat kanë pësuar rritje domethënëse të rrezikut kreditor që nga data e origjinimit, dhe ky rreziku nuk konsiderohet i ulët. Për këtë klasë të huave llogariten HPK për gjithë kohëzgjatjen e kredisë. Të ardhurat nga interesit llogariten si në Klasën 1.

Shtylla 3- Huatë të cilat kanë pësuar rritje të rrezikut kreditor në pikën që të konsiderohen të humbura. HPK-të llogariten për gjithë kohëzgjatjen e kredisë. Të ardhurat nga interesi llogariten mbi bazën neto (kreditë burto të zbritura për provizione).

Në klasifikimin e kredive dhe llogaritjen e HPK-ve, koncept i rëndësishëm është ai i rritjes ‘domethënëse’ të rrezikut. Bankat duhet të kenë një politikë të qartë duke përfshirë kriteret e zhvilluara mirë për atë që përbënë një rritje ‘domethënëse’ në rrezikun kreditor për lloje të ndryshme të ekspozimeve të huadhënies. Bankat duhet të marrin parasysh informacionin që shkon përtej të dhënave historike dhe aktuale për të marrë në konsideratë informacionin përkatës parashikues duke përfshirë faktorët makroekonomikë që janë të rëndësishëm për ekspozimin që vlerësohet në përputhje me kornizën e SNRF-së.

Tabela 5. Klasifikimi i kredive, provizionimi dhe akumulimi i interesit sipas SNRF 9

SNRF 9	Klasa 1 performuese	Klasa 2 të dyshimta	Klasa 3 joperformuese
Klasifikimi (kriteret për vendosje)	Rritje domethënëse të rrezikut kreditor që nga origjinimi	*Rritje domethënëse të rrezikut që nga origjinimi *Faktorë kualitativë sugjerojnë për rritje domethënëse rreziku, i cili ende nuk është definuar si i tillë *Vonesë mbi 30 ditë	*Vështirësi e theksuar financiare e huamarrësit *Vonesë mbi 90 ditë *Banka ka dhënë lehtësime për shkak të vështirësive financiare
Ndarja e provizioneve	Humbjet e Pritura për Kredi për 12 muaj		HPK për gjithë kohëzgjatjen e kredisë
Të hyrat nga interesi	Shuma e mbetur bruto	Shuma e mbetur bruto	Shuma neto (Mera bruto e huasë e zbritur për provizione)



Burimi: Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare - BIS (Maj 2020)

Koncepte kyçe janë gjithashtu ai i HPK-ve 12 mujore si dhe HPK-ve gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë. HPK-të në përgjithësi reflektojnë pritjet e menaxhmentit për mangësitë në realizimin e të

hyrave të kontraktuara. HPK-të 12 mujore përbëjnë pjesën e HPK-ve të gjithë kohëzgjatjes së kredisë, të asocuara me probabilitetin e dështimit të kredisë në 12 muajt në vijim. HPK-të 12 mujorë nuk përfshijnë

mungesën e të hyrave në 12 muajt e ardhshëm, por efektin e humbjes së plotë kreditore gjatë gjithë jetës së kredisë, të peshuar me probabilitetin që humbja do të ndodhë në 12 muajt e ardhshëm. Pra dallimi është se HPK-të 12 mujore nuk përbëjnë humbjet kreditore të kredive që pritet të dështojnë në 12 muajt e ardhshëm, ngase nëse kreditë e tilla, të cilat kanë pësuar rritje domethënëse të rrezikut kreditor, identifikohen, atyre duhet t'u llogariten HPK-të për gjithë kohëzgjatjen e kredisë. Ndërsa, HPK-të për gjithë kohëzgjatjen e kredië janë vlera e tanishme e humbjeve kreditore të pritshme në rast se ekspozimi kreditor dështon gjatë kohëzgjatjes së kredisë. HPK-të për kohëzgjatjen e kredisë paraqesin mesatare të peshuar të humbjeve, të peshuar me probabilitetin e ndodhjes. Për shkak se HPK-të marrin për bazë vlerën në kohë të parasë, humbjet kreditore (apo mungesat në rrjedhën e parasë) ndodhin edhe kur banka pret që të paguhet në të ardhmen, por më vonë se data e kontraktuar e pagesës. Bankat duhet të shpalosin informacionin mbi të cilin vlerësojnë HPK-të dhe ndryshimin në rrezikun kreditor, ngase për dallim nga metoda paraprake e cila është bazuar kryesisht në kritere objektive/sasiore për përcaktimin e dështimeve dhe humbjeve përkatëse (ditët e vonesës), modeli aktual kërkon vlerësim cilësor, krahas atij sasior të ditëve të vonesës, me të cilin 'banka konsideron se huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë në tërësi detyrimet kreditore ndaj bankës'.

Njohja në kohë e humbjeve kreditore dhe ndarja e provizioneve përkatëse janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për shkak të lidhshmërisë në ngushtë të pozitës së kapitalit dhe provizioneve, e cila reflektohet në kornizën e Baselit për kapital.

Për shkak të ndryshimeve rregullative dhe ndryshimeve në qasjen kontabël të trajtimit të provizioneve ndërmjet juridiksioneve të ndryshme, si dhe pasigurisë së efektit të aplikimit të SNRF 9 në pozitën e kapitalit, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Bankare ka vendosur dispozita tranzitore për aplikimin e SNRF 9. Koha e fillimit të aplikimit SNRF 9 ka ndryshuar në vende të ndryshme. Zbatueshmëria e plotë e SNRF 9 në Kosovë ka qenë e obligueshme që nga fillimi i vitit 2020.

SNRF 9 në kontekst të pandemisë Covid-19 Shpërthimi i pandemisë Covid-19 ka rezultuar në efekte të theksuara negative në ekonomi si dhe ka rritur rrezikun ndaj sistemit financiar. Për të kufizuar lëvizjet në kapitalin rregullativ dhe pasqyrat financiare të institucioneve kredidhënëse si rezultat i aplikimit të SNRF 9 në kushtet e pasigurisë së jashtëzakonshme të shkaktuar nga Covid-19, institucionet rregullative kanë ndërmarrë masa të lehtësuese duke iu mundësuar institucioneve financiare që të pezullojnë përdorimin e SNRF 9 dhe të

aplikojnë dispozitat tranzitore të SNRF 9 të përcaktuara në kornizën e kapitalit rregullativ. Autoritetet rregullative kanë reaguar në kohë duke publikuar udhëzime për mënyrën e aplikimit të SNRF 9 gjatë fazës së lehtësimeve. Këto udhëzime rekomandojnë bankat që të evitojnë supozime prociklike në modelet e tyre SNRF 9, në mënyrë që të shmangin efektet prociklike në shtrëngimin e kreditimit.

BQK, në Udhëzuesin për Ristrukturimin e kredive, ka udhëzuar që Institucionet kredidhënëse të zbatojnë parimet udhëzuese 'SNRF 9 dhe Covid-19' për aplikimin e HPK sipas SNRF 9 të publikuara më 27 mars 2020 nga Fondacioni i SNRF-ve.³³

Në këtë udhëzues, kërkohet që institucionet kredidhënëse të ushtrojnë gjykim të shëndoshë në zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9 (SNRF 9) veçanërisht në këtë kohë kur ekziston një situatë e konsiderueshme e pasigurisë.

Në mjedisin aktual ekonomik, vlerësimi i HPK-ve duhet të marrë parasysh natyrën e përkohshme të ndikimit të Covid-19, informacionin më të mirë të disponueshëm, masat përkatëse të mbështetjes fiskale dhe përdorimin e një sërë skenarëve për të mbështetur analizën e rrezikut të kredisë, duke përfshirë skenarin e pafavorshëm në situatën aktuale. Në të njëjtën kohë, institucionet kredidhënëse duhet ta kenë parasysh se SNRF 9 është i bazuar në parime dhe për këtë arsye nuk duhet të zbatohet mekanikisht dhe të shmangë aplikimin automatik. Si shembull, moratoriumi nuk duhet të rezultojë automatikisht në lëvizjen e ekspozimeve të rrezikut të kredisë në fazën 2 pasi kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht që ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.


Si përfundim, masat lehtësuese, përfshirë rristurimi i kredive, ka qenë mbështetje e domosdoshme për sektorin bankar dhe kredimarrësit për tejkalimin e problemeve afatshkurtra të nxitura nga pandemia Covid-19. Megjithatë, shtyrja e kredive ka transferuar rrezikun në të ardhmen për shkak se borxhi i përgjithshëm i huamarrësve është rritur. Sipas SNRF 9, bankat kanë llogaritur të hyrat nga interesi në kredi, të cilat në rast të mosperformimit, rrisin rrezikun në afat të mesëm. Ristrukturimet kanë për qëllim që të krijojnë lehtësim shtesë për huamarrësit që të ri negociojnë termat e kredisë në mënyrën më të përshtatshme për kapacitetin e tyre pagues, por që megjithatë kontribuojnë në zhvendosjen e rrezikut nga ai afat-shkurtër në periudhë afatmesme.

Burimi: Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (BIS), BQE dhe BQK.

³³ ifrs-9-ecl-and-coronavirus.pdf

Ekonomitë familjare dhe segmenti i ndërmarrjeve shënuan rritje të kredive jo performuese. Raporti i kredive jo performuese për ekonomitë familjare qëndroi në 1.4 përqind nga 1.1 përqind në vitin paraprak. Rritja dyshifrore e kreditimit për segmentin e ekonomive familjare në vitet e fundit është pritur që eventualisht do të reflektohet në rritje të problemeve në kthimin e kredisë, marrë parasysh që burimet e të ardhurave në ekonomi janë rritur me ritëm shumë më të ngadalshëm se kreditimi. Vlera e kredive joperformuese për këtë segment është rritur për 95.8 përqind, por që rritja e kreditimit prej 49.9 përqind ka zbutur efektin e kësaj rritje në normën e KJP-ve, e cila vazhdon të jetë nën nivelin e kredive joperformuese për segmentin e ndërmarrjeve (grafik 45). Në fazën e parë të ristrukturimeve, përkatësisht moratoriumit, u ristrukturuan rreth 33 përqind e kredive familjare, ndërsa në fazën e dytë pjesëmarrja ishte dukshëm më e ulët, në vetëm 1.8 përqind në fund të muajit dhjetor 2020.

Grafik 45. Kreditë joperformuese




Burimi: BQK.

Segmenti i ndërmarrjeve ka shënuar përkeqësim më të lartë të cilësisë kreditore, ku norma e KJP-ve arriti në 3.3 përqind nga 2.4 përqind një vit më parë. Vlera e kredive joperformuese të këtij sektori është rritur për 28.0 përqind, ndërsa kreditë u zvogëluan për 7.6 përqind.

Zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore të sektorëve ekonomik ishin të ndryshme, të ndikuara nga efekti asimetric i krizës pandemike ndërmjet sektorëve. Sektori i tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të

kredituar, shënoi rritje të normës së KJP-ve për 0.5 pikë përqindje. Sektori i bujqësisë, i cili karakterizohet me normën më të lartë të KJP-ve, shënoi rritje të mëtejme të kësaj norme për 4.6 pikë përqindje dhe arriti në 8.0 përqind. Rritje në normën e KJP-ve shënoi edhe sektori i shërbimit dhe turizmit, nga 0.2 përqind në 3.1 përqind. Ndërsa, sektori i prodhimit shënoi përmirësim të normës së KJP-së me 0.1 pikë përqindje (grafik 46).


Grafik 46. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve



Burimi: BQK.

Në grafikun 47 janë paraqitur ristrukturimet kreditore sipas sektorëve ekonomik. Mesatarja e kredive të riskstrukturuara për sektorin e ndërmarrjeve ishte 45 përqind e gjithsej kredive të këtij sektori në fazën e parë të ristrukturimeve, ndërsa në dhjetor 2020 pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ishte 16.8 përqind. Sektorët që u ndikuan më së shumti nga masat e aplikuar kufizuese për të zbutur përhapjen e Covid-19 gjithashtu kanë pjesën më të lartë të kredive të ristrukturuara, me ç' rast sektori më i prekur rezultoi ai i shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit me gjithsej 65.2 përqind kredi të ristrukturuara në fazën e parë të ristrukturimeve, dhe 40.8 përqind në fazën e dytë, përkatësisht në fund të vitit 2020. Pasonë sektori i ndërtimitarisë dhe pasurive të patundshme. Sektori i tregtisë, i cili ka peshën më të madhe në gjithsej struktura të kredive, në fazën e parë të ristrukturimeve kishte 42.3 përqind kredi të ristrukturuara ndaj gjithsej kredive të destinuar për tregti, ndërsa bilanci i mbetur i kredive të ristrukturuara në fazën e dytë, përkatësisht në fund të muajit dhjetor 2020 ishte 14.6 përqind në raport me gjithsej kreditë e këtij sektori.

Grafik 47. Pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ndaj gjithsej kredive në sektorët përkatës




Burimi: BQK.

Cilësia e portfolios kreditore pritet të përkeqësohet si pasojë e ndikimeve të krizës ekonomike të nxitur nga vazhdimi i pandemisë Covid-19 dhe pasigurive rreth vaksinimit. Efektet e plota të krizës në portfolion kreditore pritet të shihen pas përfundimit të fazës së lehtësimeve, përkatësisht ristrukturimit të kredive si pasojë e Covid-19, që do të përfundoj plotësisht në dhjetor 2021 kur maturojnë masat lehtësuese për të gjitha kreditë e ristrukturuara. Ndërprerjet në funksionim normal të ndërmarrjeve në sektorë të caktuar ekonomik veçse ka dëmtuar pozicionin financiar të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, që reflektohet edhe nga nevoja për ristrukturim të kredive Për më tepër, pasiguritë e krijuara nga rritja e rasteve në të ashtuquajturën ‘valën e dytë’ të ballafaqimit të virusit, dhe masat eventuale parandaluese mund të ngadalësojnë rimëkëmbjen ekonomike gjatë vitit 2021. Andaj, kjo situatë, mund të reflektohet në rënie të cilësisë së portfolios kreditore me efekt më të theksuar në sektorët e caktuar më të ndjeshëm ndaj këtyre zhvillimeve.³⁴

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi pozicionimin në nivelin më të mirë në rajon për nga cilësia e portfolios kreditore. Kosova ndër vite qëndron me raportin më të ulët të kredive jo performuese krahasuar me vendet e rajonit, të cilat kanë kaluar nëpër fazë disa vjeçare të përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore (grafik 48).

Grafik 48. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit



Burimi: FMN dhe Bankat Qendrore përkatëse.


Sidoqoftë, pritet janë që ky trend të ndërrojë kahje për të gjitha vendet, si rezultat i pasojave të pandemisë Covid-19. Mali i Zi dhe Kosova veçse kanë shënuar rritje të normës së KJP-ve. Magnituta e përkeqësimit të cilësisë kreditore në masë të madhe do të varet nga mënyra e menaxhimit të pandemisë, kohëzgjatja dhe shtrirja e masave për parandalimin e saj, aplikimi i masave mbështetëse të qeverive dhe autoriteteve përkatëse, dhe specifikave në strukturën e ekonomisë së vendeve.

Raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit ka shënuar rënie në 139.4 përqind nga mbulueshmëria 163.5 përqind në dhjetor 2019. Rënia në normën e provizionimit është rezultat i rritjes më të lartë të vlerës së KJP-ve (grafik 49).

Vlera e provizioneve pritet të rritet në periudhën në vijim si rezultat i rritjes së rrezikut kreditor. BQK ka lejuar bankat që të pezullojnë metodën e rregullt të provizionimit, atë të bazuar në parimet e SNRF-9, deri në fund të muajit nëntor të këtij viti, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19. Përkundër këtij vendimi, sektori bankar ka ndarë shkallë më të lartë të provizioneve, me ç'rast shkalla e provizionimit (shpenzimet për provizione ndaj kredive) për sektorin, në mesatare, ishte dyfish më e lartë në dhjetor 2020 krahasuar me një vit më parë.

³⁴ Të dhënat për Bosnen dhe Hercegovicen janë të periudhës qershor 2020.

Grafik 49. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

Shkalla e ekspozimit kreditor ka shënuar rritje më të lartë, në 85.5 përqind nga 61.3 përqind një vit më parë, megjithëse vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin maksimal rregullator.³⁵ Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha për 48.6 përqind krahas rritjes më të ngadalshme të kapitalit të klasit të parë për 6.5 përqind ndikuan në ngritjen e shkallës së ekspozimit (grafik 50).


Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, është zvogëluar. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha³⁶ u zvogëluar në 9.3 milionë euro nga 10.1 milionë euro si rezultat i efektit të rritjes më të lartë të numrit të ekspozimeve të mëdha.

Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore u zvogëluar lehtësisht në 41.6 përqind nga 41.8 përqind. Shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore në vitin 2020 është ngritur si rezultat i rritjes së ekspozimeve nga bankat që nuk kanë rëndësi të përgjithshme sistematike.³⁷

³⁵ Raport i gjithsej Ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj Kapitalit të Klasit të parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm ose grup të ndërlidhur personash, vlera e të cilit tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditore së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300 përqind të kapitalit të klasit të parë.

³⁶ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.

Grafik 50. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK.


Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve në tri dhe pesë ekspozimet më të mëdha të bankave, në përgjithësi tregojnë për ndjeshmëri të sektorit ndaj goditjeve në këto ekspozime. Andaj, megjithëse sektori qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione. Kriza e shkaktuar nga Covid-19 mund të rrisë rrezikun në aspektin e performancës së këtyre ekspozimeve ndaj dhe kjo situatë rritë nevojën për qasje pro-aktive dhe dinamike në mbikëqyrjen dhe trajtimin e ekspozimeve të mëdha.

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Sektori bankar i Kosovës ruajti pozitën e profitabilitetit përkundër përballjes me sfidën pandemike. Rritja e shpenzimeve për provizione ndikoi kryesisht që profiti i sektorit bankar të jetë më i ulët kundrejt vitit paraprak për 7.4 përqind. Të hyrat u karakterizuan me rritje vjetore më të ngadalshme se shpenzimet, ku përveç shpenzimeve për interesa, të gjitha kategoritë e tjera të shpenzimeve shënuan rritje.

³⁷ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare nuk janë përfshirë në analizë, për herë të parë kësaj radhe, ngase nuk kualifikohen si të tilla sipas rregullores në fuqi. Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë subjekt i rregullativës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, dhe pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumën prej 25 milion euro.


Grafik 51. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK.

Vlera e profitit neto zbriti në 79.9 milionë euro nga 86.2 milionë në vitin paraprak (grafik 51). Kontribuesit kryesorë të rritjes së shpenzimeve, dhe njëherit rënies së profitit, ishin shpenzimet për provizione për humbje nga kreditë, që reflekton rritjen e rrezikut kreditor të ndikuar nga pandemia Covid-19. Shkalla e provizionimit, e shprehur si raport i shpenzimeve për provizione ndaj kredive neto pothuaj u trefishua në 1.2 përqind në vitin 2020 nga 0.4 përqind e mesatares së sektorit për periudhën 2017 - 2019, si reagim i bankave ndaj rritjes së rrezikut kreditor dhe pritjeve për rritje të kërkesave për provizione pas përfundimit të fazës së ristrukturimit të kredive.

Grafik 52. Kontribuesit kryesor në rritjen / zvogëlimin e profitit




Burimi: BQK.

Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rritje prej 1.1 përqind. Ndikimi i rritjes së shpenzimeve të interesit në zvogëlimin e profitit ishte shumë më i ulët se ndikimi që pati rritja e shpenzimeve të jo-interesit (grafik 52).

Të hyrat neto nga interesi për sektorin bankar u rritën për 6.6 përqind si rezultat i rritjes më

të lartë të të hyrave nga aktiviteti kreditor. Por, margjina neto e interesit shënoi rënie të lehtë në 4.6 përqind nga 4.8 përqind në vitin paraprak, si rezultat i rritjes më të lartë të stokut të aseteve që sjellin interes, rritje prej 11.0 përqind respektivisht (grafik 53).

Grafik 53. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit




Burimi: BQK.

Gjithsej të hyrat nga interesi u rritën për 11.3 milionë euro (apo 5.6 përqind). Ndërsa vetëm të hyrat nga interesi në kredi u rritën për 6.9 milionë euro (apo 3.6 përqind), dhe ishin ndër kontribuesit kryesor në realizimin e profitit.

Të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet si dhe të ardhurat tjera operative) shënuan rritje prej 8.1 përqind, dhe arritën vlerën 65.5 milionë euro (grafik 54 dhe 55).

Grafik 54. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit




Burimi: BQK.

Shpenzimet e jo-interesit u rritën për 64 përqind, në 61.1 milionë euro, kryesisht si rezultat i shpenzimeve për provizione të cilat u rritën konsiderueshëm, për 23.3 milionë euro. Shpenzimet për tarifa dhe komisione u rritën për 2.3 përqind, përkatësisht 0.5 milionë euro.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative u rritën për 0.9 përqind, të ndikuara nga shpenzimet e personelit dhe shpenzimet tjera nga jo-interesi (grafik 56).


Grafik 55. Struktura e të hyrave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Profiti i sektorit bankar pritet të përballet me presionin e vazhdueshëm nga kriza e pandemisë Covid-19. Pasiguritë rreth ndikimit që do të ketë kjo situatë në aftësinë paguese të klientëve si dhe rritja e nevojës për ndarje të shpenzimeve për provizione për të mbuluar humbjet e mundshme, mund të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve.

Grafik 56. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Me përfundimin e masës lehtësuese si moratoriumi, është rritur migrimi i kredive nga shtylla e parë në shtyllën e dytë të klasifikimit kreditor, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut kreditor. Megjithatë efektet e rritjes së rrezikut kreditor do të vërehen akoma më shumë pas përfundimit të

masës tjetër lehtësuese të BQK-së si restrukturimi i kredive.

Përkeqësimi i portfolios kreditor të klientëve do të ndikojë në të ardhurat e sektorit përmes rënies së të hyrave të interesit nga kreditë, përkatësisht përmes mos-arkëtimit të principalit si dhe zbritjes së interesit të përlogaritur (angl: accrued interest), për shkak të rritjes së pritshme të KJP-ve. Kërkesat për provizionim gjithashtu pritet të rriten konform rritjes së rrezikut kreditor, ndaj efekti negativ në pozitën e profitit pritet të ndjehet si nga ana e të hyrave ashtu edhe nga shpenzimet.

Ndikim i mundshëm pozitiv i pandemisë Covid-19 në performancën e bankave mund të jetë intensifikimi i përpjekjeve të bankave për digjitalizim të shërbimeve, si dhe rritja e kërkesës apo shfrytëzimit të këtyre shërbimeve nga ana e klientëve. Për pasojë, sektori mund të përfitojë në rritje të efikasitetit të menaxhimit të kostove dhe rënie të shpenzimeve operative.

Grafik 57. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Indikatorët e profitabilitetit u zvogëluan si rezultat i rënies së profitit, megjithatë vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të lartë në rajon. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës zbriti në 1.8 përqind, përkatësisht 15.6 përqind nga 2.2 përqind dhe 18.9 përqind një vit më parë (grafik 57). Këto nivele janë mjaft mbi mesataren e rajonit që shënoi normë të kthimit në asete prej 0.9 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 7.1 përqind. Vendet e rajonit pësuan rënie më të lartë në treguesit e profitabilitetit gjatë këtij viti, duke rritur

dallimin mes mesatares së Kosovës dhe këtyre vendeve.³⁸

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë nga bankat në një të anë dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave me afat më të shkurtër maturimi në anë tjetër, në përgjithësi, kanë rritur ekspozimin e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit ngase kanë rritur mospërputhjen e maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve që bartin interes.


Hendeku kumulativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në vitin 2020 ishte pozitiv dhe i zgjeruar tutje në 918.6 milionë euro, si rezultat e rritjes më të lartë të aseteve me ndjeshmëri ndaj normave të interesit, në të gjitha afatet e maturimit përveç në afatin e maturimit “1-5 vite” ku rritja e aseteve ishte më e ngadalshme dhe u tejkalua nga detyrimet.

Megjithatë bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi (83.1 përqind e kredive janë me norma fikse), andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Në afat të shkurtër, rritja e mundshme e kostos së financimit, mund të ndikoj në rritjen e presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë kategoria kryesore e aseteve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Nëqoftëse analizojmë vetëm kreditë dhe depozitat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bilancit të bankave, hendeku kumulativ ndërmjet tyre rezulton negativ si pasojë e nivelit më të lartë të depozitave krahas kredive, posaqërisht për grupin me afat maturimi ‘1-5 vite’.

Krahasuar me vitin paraprak, hendeku pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve u zgjerua për

të gjitha afatet e maturimit ndërsa hendeku negativ për kategorinë me afat maturimi ‘1 deri në 5 vite’ u thellua tutje si rezultat i rritjes së depozitave me këtë afat maturimi (grafik 58).

Grafik 58. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK.

Zgjerimi i mospërputhjeve në këto kategori të afatave të maturimit mes aseteve dhe detyrimeve mund të paraqes rritje të ekspozimit ndaj rrezikut në luhatjen e normave të interesit për periudhat kohore përkatëse, ngase mund të rritë bilancin e shpenzimeve që ndodhin për refinancim të aseteve në raport me të hyrat që do të gjenerohen nga riinvestimi i mjeteve në këto afate.

5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kurset valutore është rritur krahasuar me vitin paraprak. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja u ngrit në 21.6 milion euro ekuivalente nga 5.6 milion euro, që konsiston në raport prej 4.2 përqind të kapitalit të klasit të parë krahasuar me 1.2 përqind sa ishte në vitin 2019 (grafik 59).


Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto pozitiv ndaj kapitalit të klasit të parë është rritur për frangun zviceran, për shkak të rritjes së aseteve në këtë valutë. Po ashtu edhe pozicioni neto për funtën britanike u zgjerua, por si rezultat i zvogëlimit të detyrimeve në

³⁸ Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Burimi i informacionit është databaza e Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së dhe bankat qendrore përkatëse. Të dhënat për Bosnen dhe Hercegovinën reflektojnë

gjendjen në qershor 2020 për shkak të mungesës së të dhënave më të vonshme.

këtë valutë. Kjo do të thotë se sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të këtyre valutave ndaj euros. Për dollarin amerikan, pozicioni neto i hapur rezulton negativ, që nënkupton se bankat posedojnë më shumë detyrime në këtë valutë se asete.

Grafik 59. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Burimi: BQK.


Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve të hapura në valuta të huaja. Kjo dëshkohet edhe përmes analizës ‘stres test’ që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel marginal. Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.1 përqind të gjithëj kredive, dhe shënuan rënie prej 2.0 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 4.4 përqind, ndërsa u rritën për 25.1 milionë euro nga viti paraprak (grafik 60).

³⁹ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jetë në çdo kohë mbi nivelin 12 përqind ndaj Aseteve të peshuara me rrezik. Kapitali bazë i klasit të parë duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9 përqind të APR-ve, ndërsa

Grafik 60. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Burimi: BQK.

5.4. Kapitali

Sektori bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar, me normë kapitali mbi nivelet e kërkuara rregullative.³⁹ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK) u rrit për 0.7 përqind, në 16.5 përqind në fund të vitit 2020.

Grafik 61. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK.

Norma e kapitalit ndryshon ndërmjet bankave, me ç’rast bankat me rëndësi sistemike kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Në nivel sektori, varianca midis TMK-së së bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie (përafrit të TMK-së ndaj mesatares së sektorit). Pozita e mirë e kapitalizimit të sektorit reflektohet edhe në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, i cili

Kapitali rregullativ i klasit të parë duhet të qëndrojë minimalisht në 9 përqind në raport me APR-të.


qëndroi në 14.7 përqind, me rritje vjetore prej 0.5 pikë përqindje (grafik 61).

Norma e kapitalit ndryshon ndërmjet bankave, me ç'rast bankat me rëndësi sistemike kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Në nivel sektori, varianca midis TMK-së së bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie (përafrim të TMK-së ndaj mesatares së sektorit). Pozita e mirë e kapitalizimit të sektorit reflektohet edhe në treguesin e

mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, i cili qëndroi në 14.7 përqind, me rritje vjetore prej 0.5 pikë përqindje (grafik 61).

Rritja e TMK dhe TMK1 prej 0.7 dhe 0.5 pikë përqindje respektivisht, i atribuohet efektit më të lartë pozitiv të rritjes së kapitalit prej 7.2 përqind, me kontribut rritës prej 1.13 pikë përqindje në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ndërsa asetet e peshuara me rrezik shënuan rritje vjetore prej 2.6 përqind dhe kontribuan negativisht në TMK- për 0.40 pikë përqindje (grafik 62).

Grafik 62. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK.

Krahasuar me një vit më parë, norma e rritjes vjetore të APR-ve ishte pothuajse për katër herë më e ulët, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit kreditues në rrethanat e pandemisë Covid-19. Ndërsa kapitali rregullativ shënoi rritje vjetore prej 3.0 pikë përqindje më të lartë se rritja e vitit paraprak, e ndikuar nga profiti më i lartë i mbajtur nga vitet paraprake.

⁴⁰ Sipas Basel III, norma e leves llogaritet si raport ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimeve pas ndryshimeve rregullative. Kjo normë duhet të

Sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 88.7 përqind e të cilit është kapital

Grafik 63. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK.

i klasit të parë. Profiti i mbajtur ka pjesëmarrje të lartë në kapital të klasit të parë (41.7 përqind), që sugjeron që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre (kapitalizimit të fitimit).

Në kuadër të gjithsej kapitalit rregullativ rritje shënuan kapitali aksionar, fitimi i mbajtur nga vitet paraprake, dhe provizionet. Me rënie u karakterizua vetëm borxhi i ndërvarur (grafik 63). Shpërndarja e dividendës u pezullua përkohësisht nga BQK si masë mbrojtëse për përforsimin e pozitës së kapitalit, me qëllim të rritjes së kapacitetit për përballimin e humbjeve të mundshme të shkaktuara nga pandemia Covid-19 si dhe për mbështetje të aktivitetit kreditues.


Indikatori i levës financiare (raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj ekspozimeve pas korrigjimeve rregullative)⁴⁰ në dhjetor 2020 qëndroi në 10.0 përqind (grafik 64).

Ky raport qëndron lartë mbi minimumin e sugjeruar me kornizën e Basel III për levë financiare, dhe sugjeron për pozitë të mirë të kapitalit.

Në kuadër të asetëve të peshuara me rrezik, asetet e peshuara për rrezik kreditor shënuan normë më të ngadalësuar të rritjes prej 2.5 përqind nga 12.5 përqind një vit më parë, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit kreditor.

jetë e barabartë apo mbi 3 përqind. BQK filloi llogaritjen e kësaj norme, sipas standardit të Basel III, nga viti 2020.


Grafik 64. Norma e levës



Burimi: BQK.

Ndërsa asetet e peshuara për rrezik operacional shënuan rritje prej 3.6 përqind nga 3.3 përqind. Pjesëmarrja e aseteve të peshuara sipas rreziqeve mbetet e ngjashme, me 92.7 përqind të APR-ve të peshuara për rrezik kreditor, 7.3 përqind për rrezik operacional dhe pjesë shumë e ulët, 0.0002 përqind për rrezik të tregut (grafik 65).⁴¹

Grafik 65. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit




Burimi: BQK.

Asetet e peshuara për rrezik kreditor shënuan vlerën 3.3 miliardë euro (3.2 miliardë në vitin 2019). Në kuadër të këtyre aseteve dominojnë kreditë me pakicë (ang. retail loans) me 39.9 përqind, pasuar nga ekspozimet ndaj korporatave me 22.3 përqind. Kreditë hipotekare të mbështetura me pronë të paluajtshme komerciale dhe rezidenciale kanë pjesëmarrje prej 16.1 dhe 8.2 përqind respektivisht. Ekspozimi ndaj bankave tjera, qeverive dhe bankave qendrore ishte

relativisht i ulët prej 5.0 përqind dhe 1.4 përqind respektivisht.

Grafik 66. Asetet e peshuara me rrezik kreditor, pjesëmarrja




Burimi: BQK.

Ekspozimet tjera të mbetura përbëjnë 7.2 përqind të ekspozimeve, që përfshijnë autoritetet lokale, sektorin publik, bankat zhvillimore, organizatat ndërkombëtare (grafik 66).

Sipas peshës së rrezikut, kategoria e peshuar me 75 përqind, e cila përfshinë ekspozime me pakicë (retail) dhe kredi hipotekare të mbështetura me pronë rezidenciale (grafik 67), shënoi rritjen më të theksuar këtë periudhë (për 469.4 milionë euro). Po ashtu edhe asetet me peshë rreziku 150 përqind shënuan rritje prej 27.8 përqind (apo për 2.5 milionë euro).

Grafik 67. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut




Burimi: BQK.

Ndërsa asetet me peshë rreziku 100 përqind, që kanë pjesëmarrjen më të lartë në asetet e peshuara me rrezik kreditor, shënuan rënie për 14.0 përqind duke e zvogëluar

⁴¹ Asetet e peshuara për rrezik të tregut u raportuan për herë të parë me fillim nga vitin 2020, sipas formatit të ri të raportimit të kërkuar nga BQK.

pjesëmarrjen për 8 pikë përqindje. Ky zhvillim mund të sugjeroj për apetit më të ulët rreziku nga bankat në periudhën me pasiguri të larta të shkaktuara nga pandemia Covid-19 (grafik 68).

Grafik 68. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor, sipas peshës së rrezikut



5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Kriza e nxitur nga pandemia fillimisht rriti presionin për menaxhimin e likuiditetit nga sektori bankar; megjithatë si pasojë e pozicionit të favorshëm të gjendjes së likuiditetit para krizës së pandemisë, sektori bankar u gjend mirë i mbuluar dhe me rezerva të mjaftueshme për të mbështetur në vazhdimësi aktivitetin bankar në vend. Pozita e mirë e likuiditetit u mbështet tutje nga rritja e vazhdueshme e depozitave, në veçanti depozitave të ekonomive familjare, të cilat njëherit janë burimi kryesor i financimit të sektorit. Sidoqoftë pasiguritë e lidhura me kohëzgjatjen e pandemisë, programin e vaksinimit, si dhe nivelin e masave qeveritare kufizuese për mbrojtje nga përhapja e virusit mbeten ende prezent, dhe paraqesin sfida për ekonominë e vendit. BQK, megjithëse më e kufizuar në spektrin e mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg (në mungesë të politikës monetare, BQK ka në dispozicionin instrumentin e Fondit të Likuiditetit Emergjent për injektim direkt të mjeteve në sektorin bankar), nevojat e mundshme për likuiditet mund t'i përmbushë edhe përmes mekanizmave tjera si menaxhimit të rezervave të likuiditetit,

marrëveshjeve ndërbankare për likuiditetin si dhe financimit nga bankat amë.


Nën ndikimin e gjendjes me pandeminë si dhe normave të ulëta të interesit, pjesëmarrja e depozitave të transferueshme është zgjeruar, që në kombinim me rritjen e kreditimit afatgjatë kontribuan në theksimin e mospërputhjeve të maturimeve në mes të këtyre zërave. Megjithatë, indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit të bankave që mbahen në BQK por edhe i gjithsej aseteve likuide, e bën sektorin më rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë nga mospërputhjet e afateve të maturimit në mes të investimeve dhe financimit.

5.5.1 Financimi bankar

Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga financimi prej sektorit jo-bankar, kryesisht depozitave, të cilat vazhduan rritjen.


Financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët, ndaj bankat janë shumë pak të ekspozuara ndaj financimit në sektorin e jashtëm (grafik 69).

Grafik 69. Struktura e financimit



Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 134.3 përqind, tregues që u rrit për 5.4 pikë përqindje nga viti paraprak, nën ndikimet e rritjes më të lartë të depozitave (grafik 70).


Grafik 70. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Rritja e depozitave të ekonomive familjare në këto rrethana të rënies ekonomike dhe pasigurive rreth zhvillimeve me pandeminë reflekton preferencat për kursim në dëm të konsumit dhe investimeve. Ndërsa, rritja e depozitave në muajin e fundit të vitit, i atribuohet kryesisht tërheqjes së lejuar të 10 përqind të kursimeve pensionale.

Grafik 71. Struktura e depozitave




Burimi: BQK.

Depozitat e ekonomive familjare përshpejtuan trendin e rritjes në 13.2 përqind nga 11.5 përqind në vitin 2019 (grafik 71). Stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti në 3.0 miliardë euro. Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme, të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 19.0 përqind kontribuan në rritjen e gjithsej depozitave të ekonomive familjare (grafik 72).

Depozitat e ndërmarrjeve ngadalësuan trendin e rritjes vjetore në 16.2 përqind (29.3 përqind rritje vjetore në vitin 2019), që mund të jetë shkaktuar nga kufizimi i

aktivitetit të tyre biznesor për shkak të masave parandaluese të pandemisë Covid-19, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit 2020.

Grafik 72. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Burimi: BQK.

Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 968.9 milionë euro, me pjesëmarrje 21.9 përqind në gjithsej depozitat.


Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 14.4 përqind, për shkak të efektit të bazës. Për shkak të pasigurive në sigurimin e të ardhurave si pasojë e kufizimit të aktivitetit të tyre ekonomik nga pandemia Covid-19, mbështetja më e madhe ishte në depozita të transferueshme për të mbuluar nevojat e tyre të likuiditetit, kundrejt mbajtjes së mjeteve në formë të depozitave të afatizuara.

Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 17.5 përqind. Depozitat e transferueshme arritën në 63.4 përqind të gjithsej depozitave në vitin 2020 (grafik 72). Ndërsa, depozitat e transferueshme vetëm të ekonomive familjare përbëjnë 41.5 përqind të gjithsej depozitave. Depozitat e afatizuara shënuan rritje vjetore prej 3.1 përqind, dhe ato të kursimit prej 10.2 përqind.

Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet 'deri në 1 vit' dhe 'mbi 1 vit deri në 2 vite'. Depozitat me afat të maturimit 'mbi 2 vite'

dominuan strukturën e depozitave të afatizuara, përkundër rënies së pjesëmarrjes nga 47.8 në 43.6 përqind. Përderisa, kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' janë ato që kanë pjesëmarrjen më të lartë, prej 38.8 përqind në gjithsej kreditë (grafik 73).

Grafik 73. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive




Burimi: BQK.

Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe e dominimit të depozitave me maturim afatshkurtër në njërin anë, dhe në anën tjetër rritja e kreditimit afatgjatë shton nevojat për mbikqyrje më prudente të financimit të qëndrueshëm të bankave, e veçanërisht në këtë periudhë të pasigurisë mbi kthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik dhe rimëkëmbjes ekonomike të vendit.

5.5.2 Rreziku i Likuiditetit

Sektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit, duke dëshmuar kapacitet për mbështetje të aktivitetit kreditues si dhe kapacitet të lartë për përballje me rreziqe të mundshme. Në vitin 2020, raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra u ngrit në 39.8 përqind krahasuar me 37.6 përqind në vitin 2019. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e aseteve likuide se sa rritja e detyrimeve afatshkurtra prej 20.6 përqind, dhe 13.8 përqind respektivisht. Po ashtu, raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshinë vetëm asetet shumë likuide, në raport me detyrimet afatshkurtëra, u ngrit në 30.7 përqind nga 30.1 përqind një vit më parë.

Grafik 74. Indikatorët e likuiditetit



Burimi: BQK.

Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve u rrit lehtësisht në 30.1 përqind (28.0 përqind në vitin 2019), si rezultat i rritjes më të lartë të aseteve likuide kundrejt gjithsej aseteve (grafik 74). Norma më e lartë e raportit të likuiditetit (raportit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra) se minimumi rregullator⁴², tregon për potencial të sektorit për financim të zgjerimit të aktivitetit kreditues.

Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi kryesisht nga rritja prej 143.4 milionë euro e rezervave të likuiditetit me bankën qendrore, apo një rritje vjetore prej 34.6 përqind. Po ashtu kontribut në rritje të aseteve likuide treguan rritja e depozitave të transferueshme për 88.5 milionë euro, apo rritje vjetore prej 56.8 përqind, pastaj rritja e parave të gatshme për 22.6 milionë euro apo 10.9 përqind, si dhe rritja e fletëobligacioneve të qeverisë së Republikës së Kosovës prej 14.6 milionë euro, apo rritje vjetore prej 8.1 përqind.


Ndërsa, rënie shënuan bonot e thesarit të Republikës së Kosovës prej 49.7 përqind, të cilat nuk e afektuan në masë të madhe stokun e aseteve likuide për shkak të pjesëmarrjes së ulët në asete likuide (1.6 përqind). Depozitat dhe plasmanët me bankat vendore shënuan rënie prej 75.5 përqind, apo për 20.0 milionë euro.

Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar

⁴² Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është i definuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit prej 25 përqind (neni 17. Norma e likuiditetit)

të mbajtur në BQK për 82.3 përqind. Nga gushti i vitit 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepricën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me vendimin e BQE-së për aplikim të normave negative në depozita.

Grafik 75. Rezervat e likuiditetit



Burimi: BQK.

Aplikimi i normës negative ndikoi tepriçën e rezervës menjëherë në muajin vijues, ku në shtator të vitit 2016 teprica u zvogëlua për 29.9 përqind (grafik 75).⁴³ Megjithatë, nuk janë vërejtur efekte afatgjata të masave të ndërmarra përmes normës negative në nivelin e tepriçës së rezervës, potencialisht për shkak të mundësive të kufizuara për mbajtje dhe investim të mjeteve.


Ambienti i normave të ulëta të interesit në vitet e fundit ka stimuluar ekonomitë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të rritjes së kreditimit afatgjatë ka rezultuar në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve.

Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit po rriten në kushtet kur depozitat e transferueshme janë rritur dhe afatet e maturimit të kredive janë zgjatur, lëvizje kjo që rritë ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

⁴³ Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendenda për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse.

Hendeku kumulativ i likuiditetit në vitin 2020 u zgjerua në 597.7 milionë euro nga 513.6 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar kryesisht zgjerimi më i theksuar i hendekut pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të afateve të maturimit “1 deri në 5 vite”, për shkak të rritjes më të lartë të kredive në këtë maturitet. Rreth 36.1 përqind e gjithsej asetëve kategorizohen në afatin ‘1-5 vite’ në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë vetëm 10.2 përqind të gjithsej detyrimeve.

Grafik 76. Hendeku i likuiditetit*



Burimi: BQK.

Hendeku negativ rezulton në afatin e maturimit ‘1-7 ditë’, vlera e të cilit qëndron në -2.13 miliardë euro. Në këtë kategori të afatit të maturimit bëjnë pjesë 73.2 përqind e gjithsej detyrimeve, ndërsa asetet konsistojnë 23.8 përqind. Rrjedhimisht mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit ‘1-7 ditë’ dhe ‘1-5 vite’ (grafik 76). Kjo situatë paraqet sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave për rritje të kreditimit afatgjatë.

5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test⁴⁴

Për të testuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj krizës ekonomike si pasojë e pandemisë Covid-19, janë kalibruar skenarë të bazuar në parashikime të mundshme të ngjarjeve për periudhë një vjeçare. Megjithatë, zhvillimet dhe rrjedhimisht supozimet janë

⁴⁴ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve negative, pa paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

përcjellë me pasiguri të mëdha, për shkak se masat e ndërmarra nga autoritetet vendore për të zbutur krizën kanë izoluar efektet direkte të pandemisë në bilancet e sektorit bankar. Në këtë publikim ndërtimi i skenarëve nuk do të përfshijë goditjet makroekonomike në portfolion kreditor dhe pozitën kapitale, pasi që modeli aktual i analizës nuk është i kalibruar për mbulimin e krizave të paprecedent si kriza e pandemisë Covid-19. Më konkretisht, koeficienti i elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj BPV-së dhe hendekut të prodhimit, që matë ndjeshmërinë e portfolios kreditor ndaj aktivitetit ekonomik, është modeluar bazuar në të dhëna që nuk përfshijnë asnjë situatë krize në historikun e sektorit bankar në Kosovë.

Për pasojë, në këtë publikim janë ndërtuar skenarë sensitiviteti, bazuar në supozime më realiste të ndodhjes. Ushtrimi përqëndrohet në përcaktimin e disa normave të goditjeve në cilësinë e portfolios kreditor, nisur nga gjykime të bazuara në informacione të marra nga sektori bankar si dhe nga performanca e sektorit privat, përkatësisht të dhënat e qarkullimit të ndërmarrjeve gjatë vitit 2020. Në këtë ushtrim janë konsideruar tre skenarë në nivel sektori, por me efekte të ndryshme në bankat individuale për shkak të strukturës së bilancit dhe performancës së tyre financiare.

Në këtë analizë nuk është përfshirë supozimi i ndryshimeve në norma të interesit. Praktikisht dëshmojnë se në kohë krize kreditë e reja do të konsideroheshin me rrezikshmëri më të lartë prandaj edhe mund të pritej rritje e normës së interesit, megjithatë intervenimi emergjent i BQK-së dhe institucioneve të qeverisë, e po ashtu FKGK-së, me masa lehtësuese për nxitjen e kreditimit, nënkupton uljen e normave të interesit apo mbajtjen në nivelet ekzistuese. Rrjedhimisht në skenarët e përpiluar është supozuar që këto dy efekte e përjashtojnë njëra tjetrën dhe normat e interesit nuk do të kenë lëvizje domethënëse. Sipas rezultateve nga testi i goditjeve në portfolion kreditor, pozita kapitale e sektorit

bankar, në përgjithësi, do të mund të përballonte goditjet në tre skenarët e dizajnuar (tabela 6). Por, në nivel të bankave, disa prej tyre do të përballëshin me nevojën për kapital shtesë për përballim të goditjeve në portfolion e tyre kreditor.

Rezultatet nga testi i goditjeve në pozitën e likuiditetit sugjerojnë se sektori bankar posedon kapacitet financiar për të përballuar situatat e supozuara të tërheqjes së një shume të konsiderueshme të depozitave. Në të gjithë skenarët e supozuar, pozita e likuiditetit e shumicës së bankave rezulton e qëndrueshme, përjashtuar në supozimin e tërheqjeve të 38.5 përqind të depozitave në fund të ditës së pestë me radhë, ku shtatë banka do të paraqiteshin me mungesë të mjeteve likuide (tabela 6).

5.6.1. Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në portfolion kreditor dhe pozitën kapitale

Analiza stres-test për rrezikun kreditor vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për periudhën një vjeçare bazuar në gjendjen e këtij viti, ndaj tronditjeve të mundshme në portfolion kreditor si dhe në pozitën kapitale, të cilat mund të paraqiten nga zhvillimet e pafavorshme. Analiza është realizuar përmes aplikimit të tri skenarëve që si pikënisje kanë përcaktimin hipotetik të shkallëve të dështimit të kredive ekzistuese.⁴⁵


Në të tre skenarët rritja e kreditimit është supozuar të jetë 12.4 përqind, mbështetur në parashikimet për rritje të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021. Në këtë aspekt pritet se do të ndikojnë edhe masat lehtësuese të BQK-së si dhe masat ndihmëse qeveritare, si Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Në skenarin e parë është supozuar rritje e raportit të kredive joperformuese për 3 pikë përqindje. Po ashtu është supozuar se do të realizohet profit më i lartë ngase të hyrat nga interesi në kredi mund të rriten nga rritja e kreditimit. Në këtë rast profiti do të rritej për 1.4 përqind krahas rritjes së kreditimit, dhe pas zbritjes së interesit të përealizuar për

⁴⁵ Raporti i provizionimit sipas shtyllave kreditorë për secilën bankë, për të llogaritur provizionet shtesë të nevojshme me rritjen e KJP-ve, është përcaktuar të jetë i njëjtë me raportin mesatar të provizionimit të sektorit.

shkak të rritjes së KJP-ve. Në këtë skenar sektori rezulton të jetë rezistent ndaj rritjes së KJP-ve, me ç'rast norma e kapitalizimit do të zbriste në 15.7 përqind nga niveli aktual 16.5 përqind. Përkeqësim të pozitës së kapitalit do të kishin dy banka, njëra nga të cilat degë bankare e cila nuk është subjekt i kërkesës minimale për kapital prej 12 përqind. Ndërsa, për dy nga bankat vërehet rritje e normës së kapitalizimit, për shkak se të hyrat e pritura për t'u realizuar në vitin në vijim janë më të mëdha se kërkesat për provizionet e pritura shtesë, si dhe për shkak të përfshirjes së profitit të realizuar në vitin aktual në përllogaritjen e nivelit të kapitalit, nën supozimin që nuk do të shpërndahet dividendë (grafik 77, tabela 6).

Grafik 77. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve



Burimi: BQK.

Në skenarin e dytë është supozuar rritje e raportit të kredive joperformuese për 5 pikë përqindje. Profiti do të pësojë tronditje si rezultat i rritjes së shkallës së dështimit të kredive ekzistuese. Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për periudhë një vjeçare ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar për vitin 2020, i rritur për shkallë të caktuar krahas rritjes së kreditimit, mirëpo pastaj i reduktuar për të hyrat që nuk do të realizohen për shkak të rritjes së normës KJP.⁴⁶ Profiti do të zvogëlohej me normë vjetore prej 4.1 përqind, për shkak të rritjes së interesit të përllogarituar nga rritje e KJP-ve. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 112.4 milionë euro (grafik 78). Këto humbje do t'i ngarkohen direkt kapitalit, duke e zbritur treguesin e

mjaftueshmërisë së kapitalit në 14.3 përqind. Katër banka do të rezultonin të nënkapitalizuara përfshirë edhe një bankë me rëndësi të përgjithshme sistemike, për të cilën norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të zbriste në 11.1 përqind. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrijnë vlerën prej 19.5 milionë euro.

Në skenarin e tretë është vlerësuar ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj zhvillimeve negative më ekstreme, përkatësisht rritje e raportit të kredive joperformuese për 8 pikë përqindje. Supozimi është bazuar në supozimin e vazhdim të krizës pandemike, e përcjellë me kufizime të mëtutjeshme si pasojë e vonesave në sigurimin e vaksinës dhe pasigurive rreth marrjes së saj, e rrjedhimisht vonesës në imunizimin e popullsisë. Kjo gjendje mund të karakterizohet me pasiguri të shtuara në realizimin e të ardhurave dhe dobësim të mëtejshëm të aftësisë paguese të huamarrësve. Në analizë nuk konsiderohet mundësia e realizimit të kolateralit apo rritja e kapitalit nga burime të tjera, duke qenë se efikasiteti dhe mundësia e realizimit të këtyre veprimeve është shumë e pasigurt në kohë krize. Profiti do të pësojë tronditje nga rritja e shkallës së dështimit të kredive ekzistuese, duke u zvogëluar për 12.3 përqind.

Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 186.4 milionë euro (grafik 78). Niveli i lartë i provizioneve të mbajtura për të mbuluar dështimin e kredive ekzistuese bën që sektori të jetë rezistent ndaj goditjeve të supozuara në këtë skenar. Niveli i kapitalizimit pas goditjes rezulton 12.2 përqind (tabela 6).

Megjithatë, numri i bankave me probleme në pozicionin e kapitalit do të rritej në gjashtë, prej tyre banka e njëjtë me rëndësi sistemike si në skenarin e dytë, TMK e së cilës do të zbriste në 9.0 përqind. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrinin vlerën 60.4 milionë euro (grafik 78, tabela 6).

⁴⁶ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi

për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.


5.6.1.1 Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve sipas sektorëve ekonomik

Zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditorë të sektorëve ekonomik ishin të ndryshme, të ndikuara nga efekti asimetric i krizës pandemike ndërmjet sektorëve.

Për të vlerësuar efektet e mundshme të dështimit të kredive ndaj sektorëve ekonomik në pozitën kapitale të bankave, është marrë për bazë rënia e qarkullimit të ndërmarrjeve për këta sektorë përgjatë vitit 2020. Norma rënëse e qarkullimit të aktiviteteve ekonomike është aplikuar në kredite ekzistuese për sektorë përkatës, duke supozuar se nivel i njejtë i kredive ekzistuese të sektorëve përkatës potencialisht do të mund të dështonin.

Rezultatet e testit të ndjeshmërisë bazuar në këto supozime sygjerojnë se portfolio kreditorë e sektorit do të përkeqësohej për 8.3 pikë përqindje. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 194.5 milionë euro dhe sektori nuk do të mund të përmbushte kërkesat rregullore për kapital, me normë të kapitalizimit që do të zbriste në 11.9 përqind (tabela 6, grafik 78).

Grafik 78. Rezultatet e stress testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi



Burimi: BQK.

Dështimi i kredive sipas sektorëve për secilën bankë është asimetric për shkak të ekspozimit të tyre të ndryshëm në sektor përkatës dhe të efektit asimetric të krizës pandemike ndërmjet sektorëve. Sektorët më të ndikuar, bazuar në qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve, rezultojnë të jetë sektori i shërbimeve dhe akomodimit, sektori i tregtisë dhe sektori i

patundshmërive. Prandaj edhe bankat që janë më të ekspozuara ndaj kreditimit të këtyre sektorëve të ndjeshëm rezultojnë më të ndjeshme në pozitën e tyre të kapitalit. Dy nga gjashtë bankat që rezultojnë të nën kapitalizuara pas goditjes, kanë ekspozim më të lartë relativ ndaj sektorit të shërbimeve dhe për pasojë do të rezultojnë me normë kapitali prej 10.8 përqind dhe 7.5 përqind. Ndërsa një bankë tjetër që po ashtu është mjaftë e ekspozuar ndaj kreditimit të sektorit të shërbimeve dhe akomodimit, rezulton rezistente ndaj testimit, për shkak të nivelit të lartë të kapacitetit absorbues përmes profitit dhe nivelit të lartë të provizioneve të mbajtura.

5.6.1.2 Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve të mëdha kreditorë

Në këtë skenar është vlerësuar qëndrueshmëria e bankave ndaj dështimit të mundshëm të tre dhe pesë kredimarrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj do të ndikonte që niveli i kapitalizimit në nivel sektori të bie në 14.5 përqind dhe humbja të arrijë në 113.8 milionë euro (grafik 78 dhe tabela 6).⁴⁷ Tri banka do të përballeshin me humbje të larta, ndër to një bankë me rëndësi të përgjithshme sistemike, TMK e së cilës do të zbriste në 10.9 përqind.

Dështimi i pesë kredi marrësve më të mëdhenj do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen në këto tri banka, si dhe një bankë tjetër që gjithashtu do të rezultonte e nën kapitalizuar. Humbjet do të arrinin në 162.8 milionë euro dhe TMK e sektorit do të zbriste në 13.2 përqind. Katër bankave të nën-kapitalizuara do të iu nevojiteshin 76.6 milionë euro shtesë për ngritje të kapitalit (grafik 78 dhe tabela 6). Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori është i ndjeshëm ndaj ekspozimeve të mëdha, performanca e të cilave duhet të monitorohet për së afërmi në kushtet e krizës aktuale. Gjithashtu theksohet se rritja e përqendrimit të ekspozimeve kreditorë në kushte të thellimit të mëtejme të krizës

⁴⁷ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare nuk janë përfshirë në analizë, ngase nuk kualifikohen si të tilla sipas rregullores në fuqi. Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë

subjekt i rregullativës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, dhe pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumën prej 25 milion euro.

ekonomike do ta vinte sektorin në pozitë jo të kënaqshme.

5.6.1.3 Kapacitet kapitale të bankave për absorbim të rritjes së kredive-joperfomuese

Sektori bankar është në gjendje të përballoj një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 11.6 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së së sektorit në nivelin e kërkuar rregullator. Po ashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalin paraqiten të larta për

shumicën e bankave. Përjashtim bën njëra bankë që do të mund të përballonte rritje të normës së KJP-së prej vetëm 1.7 përqind para se të rezultoj e nënkapitalizuar si dhe një bankë me rëndësi sistemike e cila do të mund të përballonte rritje të normës së KJP-së prej vetëm 7.1 përqind. Niveli më i lartë i përballimit të rritjes së normës së KJP-së është 18.9 përqind të gjithsej portofolit të kredive, para se bankës të i paraqitet nevoja për kapital shtesë.

Tabela 6. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave me TMK<12%	Norma e kapitalizimit			Norma e KJP-ve			Mjetet shtesë të nevojshme për rikapitalizim (në mijëra euro)
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
Nivelet aktuale (para goditjeve)		66.2	11.9	16.5	3.4	0.0	2.6	
Rezultatet e skenarëve								
Skenari i parë: Rënia e normës KJP për 3pp, rritja e kreditimit për 12.4%, rritja e profittit për 1.4%	2	30.7	9.9	15.7	6.4	3.0	5.6	4,248
Skenari i dytë: Rritja e normës KJP për 5pp, rritja e kreditimit për 12.4%, rënia e profittit për 4.1%	4	29.8	8.7	14.3	8.4	5.0	7.6	19,526
Skenari i tretë: Rritja e normës KJP për 8pp, rritja e kreditimit për 12.4%, rënia e profittit për 12.3%	6	28.5	7.0	12.2	11.4	8.0	10.6	60,351
Tronditjet në portfolion kreditorë sipas aktiviteve ekonomike: Dështimi i një përqindjeje të kredive bazuar në rënie e qarkullimit të aktiviteve	6	31.1	6.7	11.9	12.4	2.1	10.9	58,977
Dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenjë	3	20.5	5.3	14.5	12.6	2.6	7.9	31,796
Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenjë	4	20.5	3.4	13.2	14.8	2.6	10.0	76,555

Burimi: BQK.

5.6.2 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësoj aftësinë financuese të bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga dështimi i depozitave të koncentruara. Skenarët janë mjaftë konservativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore

Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të tërheqjeve në baza ditore (tabela 7), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite ndahen 5 përqind të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jo-likuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

Tabela 7. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit


Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK.

Për arsye të pasigurive dhe panikut të krijuar në ditët e para të izolimit nga masat e ndërmarra për shkak të përhapjes së pandemisë Covid-19, depozitorët patën tendencë të tërheqin mjetet e tyre nga sektori bankar gjë që shkaktoi reduktim të depozitave mujore dhe zvogëlim të përkohshëm të likuiditetit. Megjithatë, rënia ishte efekt i shkurtër, dy mujor, dhe në nivel të ulët me normë mujore rënëse prej afërsisht 0.6 përqind, e cila nuk paraqiti fare vështirësi për sektorin bankar. Përderisa sektori bankar në Kosovë nuk ka historik të krizave të mëparshme financiare dhe praktika e pandemisë nuk na dha nivele të larta të tërheqjeve të depozitave, atëherë janë supozuar nivele më ekstreme për të vlerësuar kapacitetin e sektorit bankar për të përballuar humbjet po qe se situatë e tillë do të ndodhte dhe ky nivel i tërheqjeve të depozitave do të materializohej. Këto nivele më ekstreme janë bazuar në eksperiencat e vendeve të rajonit, të cilat kanë përjetuar situatat të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave në të kaluarën.

Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që pjesa më e madhe e bankave do të mund të përballojnë tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore deri në ditën e dytë, ku një bankë do të paraqitej me nevoja për likuiditet. Në ditën e pestë probleme me likuiditet do të paraqiteshin në shtatë banka, duke përfshirë këtu edhe tri banka me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë për këto banka do të arrinte në 156.8 milionë euro (grafik 78, tabela 8). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të


depozitave në sektorin bankar në ditën e pestë do të arrinte në 38.5 përqind të gjithsej depozitave (tabela 8).

Grafik 79. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -Skenari 1


Burimi: BQK.

Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj

Pozita e likuiditetit të bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë tërheqjet e depozitave nga pesë depozitarët më të mëdhenj, me përjashtim vetëm të një banke.

Grafik 80. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - Skenari 2


Burimi: BQK.

Ndërsa nën supozimin se njëzet depozitarët më të mëdhenj të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohej edhe në një bankë

tjetër. Mungesa e mjeteve për këto dy banka do të arrinte në 35.4 milionë euro (grafik 79, tabela 8). Rezultatet e këtij skenari përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të financimit, përkatësisht depozitave.

5.6.2.1 Niveli përballues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Problemet me likuiditet për tërë sektorin bankar do të paraqiteshin në rast të tërheqjes së 29.2 përqind të depozitave brenda ditës, që

nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë (grafik 79 dhe tabela 8). Ndërsa në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 14.5 përqind, ndërsa banka me më të lartin në 37.6 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedon kjo bankë).

Tabela 8. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	7	-38.5%	(156,833)	121.2%
Skenari 2.1: Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenjë	1	-9.9%	(8,987)	82.7%
Skenari 2.2: Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenjë	2	-16.4%	(35,399)	89.1%
Pragu - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-29.2%	(83,018)	105.2%


Burimi: BQK.

6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Sektori pensional në vitin 2020 shënoi rritje më të ngadalësuar të aseteve, atribuar kryesisht efekteve negative të pandemisë Covid-19 si dhe masës së tërheqjes së 10 përqind të mjeteve të trustit prej kontributdhënësve.

Grafik 81. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.


Sektori pensional u karakterizua me rritje të ngadalësuar vjetore prej 1.2 përqind, përderisa vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit arriti në 2.0 miliardë euro në fund të vitit 2020 (grafik 81). Ecuria e aseteve të sektorit pensional u ndikua nga rritja më e ngadalësuar e kontributeve të arkëtuara gjatë vitit, si dhe kthimit më të ulët në investime krahasuar me vitin 2019. Megjithatë, sektori ruajti ritmin pozitiv të rritjes, përkundër pasigurive të ngritura nga gjendja pandemike dhe efektet e saj në tregjet e jashtme dhe krizën e brendshme ekonomike, si dhe masën e aprovuar në kuadër të Ligjit për Rimbëkëmbje Ekonomike që mundësoi tërheqjen e 10 përqind të kursimeve pensionale për kontribut-dhënësit.

Rritja e aktivitetit në sektorin pensional i atribuohet kryesisht performancës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që ka pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej asetet e sektorit (99.6 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Arkëtimet e reja shënuan

rritje të përgjysmuar vjetore prej 4.1 përqind (8.1 përqind në vitin 2019), vlera e të cilave arriti në 194.9 milionë euro në fund të vitit. Ngadalësimi i rritjes së arkëtimeve prej kontributdhënësve i'u atribua efekteve që shkaktoi pandemia në ekonomi, duke u përkthyer në rënie të aktivitetit ekonomik dhe rënie të shkallës së punësimit. Sektori pensional mbylli vitin 2020 me kthim pozitiv nga investimet, megjithëse kthim më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Kjo dinamikë kryesisht u ndikua nga kthimi negativ në investime të shënuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 (efektet e pandemisë në tregjet financiare në këtë periudhë), rënie që u kompensua në tremujorët vijues të vitit.

Struktura e aseteve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, edhe pse krahasuar me periudhën paraprake ka shënuar rënie të pjesëmarrjes. Në fund të vitit 2020, portfolio investuese në tregjet e huaja zbriti në 1.35 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore për 8.6 përqind (rritje vjetore prej 20.6 përqind në vitin 2020).

Grafik 82. Struktura e investimeve të sektorit pensional




Burimi: BQK.

Investimet jashtë vendit në dhjetor 2020 kishin pjesëmarrje prej 68.0 përqind të gjithsej aseteve të FKPK-së (75.2 përqind në vitin 2019). Ndërsa, investimet brenda vendit shënuan rritje të pjesëmarrjes në gjithsej asetet e FKPK-së në 32.0 përqind në fund të vitit 2020 (24.8 përqind në vitin 2019). Vlera e investimeve brenda vendit arriti në 637.7

milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 30.7 përqind (grafik 82).

Në kuadër të investimeve brenda vendit, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdojnë të jenë kategoria me peshën më të madhe, pasuar nga ajo e certifikatave të depozitit dhe parasë së mbajtur në vend. Pësha e letrave me vlerë u rrit në 70.7 përqind (61.3 përqind në vitin 2019), ndërsa e certifikatave të depozitit u zvogëlua në 20.3 përqind (38.1 përqind në vitin 2019).

Grafik 83. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale



Krahasuar me periudhën paraprake, investimet në tregun e brendshëm të letrave me vlerë shënuan rritje të konsiderueshme (për 50.8 përqind), e që reflekton kërkesën më të lartë të Qeverisë së Kosovës për mjete shtesë për të financuar paketat fiskale në ndihmë të qytetarëve dhe bizneseve që janë prekur nga pandemia Covid-19. Kurse, plasimet në certifikatave të depozitit u zvogëluan për 30.2 përqind, e që reflekton tërheqjen e kursimeve pensionale prej qytetarëve në fund të dhjetorit të vitit 2020. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, në dhjetor 2020 vlera e aseteve të FKPK-së arriti në 1.99 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.1 përqind (rritje vjetore prej 17.0 përqind në dhjetor 2019).

Në fund të vitit 2020, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 8.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.5 përqind. Arkëtimet e reja shënuan vlerën prej 554.1 mijë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 0.8 përqind (grafik 83).


Pjesa më e madhe e aseteve të FSKP-së vazhdon të investohet jashtë vendit,

përkatësisht 76.3 përqind e gjithsej aseteve. Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve (84.5 përqind), letrave me vlerë (13.5 përqind), dhe letrave komerciale (1.5 përqind). Në anën tjetër, investimet në Kosovë u rritën për 5.9 pikë përqindje, me pjesëmarrje prej 23.7 përqind të gjithsej aseteve të FSKP-së. Investimet në tregun e brendshëm ishin të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (52.6 përqind), depozita në bankat komerciale (3.5 përqind), para të gatshme në trezor të FSKP-së (13.8 përqind), dhe të tjera (30.1 përqind).

6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional vitin 2020 e mbylli me performancë pozitive financiare pavarësisht efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19, duke kompensuar humbjet e shkaktuara në tremujorin e parë gjatë tremujorëve vijues të vitit.

Grafik 84. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës




FKPK kishte kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 71.9 milionë euro (160.7 milionë euro në vitin 2019) (grafik 84). Kthimi më i ulët në investime ndër tjerash erdhi si rezultat i performancës negative, përkatësisht humbjeve prej 90.4 milionë euro në TM1 2020 (efekteve negative të Covid-19 në tregjet fi nanciare ndërkombëtare), por që u kompensua në tremujorët vijues të vitit, përkatësisht nga kthimi bruto prej 162.3 milionë euro gjatë periudhës prill-dhjetor..

Rezultat pozitiv financiar u reflektuan edhe në nivelin e çmimit të aksionit të FKPK-së, i

cili në ditën e fundit të vitit ishte 1.56 euro, krahasuar me 1.51 euro në ditën e fundit të vitit 2019. Rritja e theksuar e fitimeve të realizuara, në veçanti gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, u reflektua në rikuperim të konsiderueshëm të humbjeve të shkaktuara gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Kjo rritje kryesisht iu atribua rikuperimit të shpejtë të tregjeve të aksioneve (veçanërisht atyre amerikane). Stabilizimi i tregjeve të aksioneve u ndikua pozitivisht nga politika ekspansioniste e FED, intervenimi global fiskal, ngritja e sentimentit biznesor dhe besueshmërisë së konsumatorit si dhe kombinimi i instrumenteve financiare, aset menaxherëve konzervativ (multi-asete) si dhe fondeve të tregtueshme.

Grafik 85. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK.

Me kthim pozitiv nga investimet dhe rritje të çmimit të aksionit u karakterizua edhe FSKP.


FSKP-ja shënoi kthim pozitiv nga investimet në vitin 2020 në vlerë prej 388.8 mijë euro (grafik 85). Vetëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, FSKP kishte shënuar kthim negativ prej 910.0 mijë euro, dinamikë që u përmirësua gjatë tremujorëve vijues të vitit. Çmimi i aksionit në ditën e fundit të vitit ishte 1.84 euro, krahasuar me 1.79 euro në ditën e fundit të vitit 2019.

6.2 Sektori i Sigurimeve

6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në vitin 2020 u karakterizua me rritje të aseteve, duke ruajtur nivelin e primeve të arkëtuara nga viti paraprak dhe zvogëluar nivelin e dëmeve të paguara. Përhapja e pandemisë Covid-19 kishte efekt më të theksuar në rënien e nivelit të dëmeve të paguara (pasojë e kufizimeve në lëvizje), duke ndikuar kështu që sektori i sigurimeve të realizoj fitim në vitin 2020.

Grafik 86. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Me një pjesëmarrje prej 2.8 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia.

Niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit të sektorit të sigurimeve ka mbetur ngjashëm me vitin e kaluar, me ndryshime marginale krahasuar me vitet e fundit. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit, vazhdon të qëndroj në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian, në 1.46 përqind (1.40 përqind në vitin 2019). Ngjashëm i ulët mbetet niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili në vitin 2020 shënoi vlerën prej 54.82 euro (54.77 euro në vitin 2019).⁴⁸


⁴⁸ Sipas statistikave të publikuara në databazën e Insurance Europe, niveli i densitetit gjatë periudhës 2009-2018 në 32 vende të Evropës ishte 1,904 Euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit

(ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 7.25 përqind. <https://www.insuranceeurope.eu/insurancedata>

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e siguruesve ‘jo-jetë’, që përfaqësojnë 91.4 përqind të asetëve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e siguruesve ‘jetë’. Numri i siguruesve mbeti i pandryshuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 13 sosh, prej të cilave 11 janë sigurues ‘jo-jete’ dhe 2 sigurues ‘jetë’.

Gjysma e tregut të sigurimeve përfaqësohet nga siguruesit vendor (rreth 51.0 përqind), përderisa pjesa tjetër nga siguruesit me origjinë të huaj. Në kuadër të kompanive me kapital të huaj, siguruesit nga Shqipëria kanë pjesëmarrjen më të lartë në asete, pasuar nga siguruesit nga Sllovenia dhe siguruesit nga Austria (grafik 87).

Grafik 87. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2020)



Burimi: BQK.


Tregu i sigurimeve në Kosovë ka koncentrim të ulët, e që është parakusht për funksionalizimin e një konkurrence më të madhe në treg. Indeksi i Herfindahl-it⁴⁹ i kalkuluar për primet e shkruara bruto në vitin 2020 tregon 925 pikë (930 pikë në vitin 2019). Ndërsa, po i njëjti indeks i kalkuluar duke marr për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, përkatësisht 845 pikë për vitin 2020 nga 853 pikë në vitin 2019.

Në të njëjtën kohë, indeksi CR5⁵⁰ për prime, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e

⁴⁹ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej tregjet (primet e shkruara bruto - PSHB) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet

sigurimeve, rezultoi në 55.1 përqind në vitin 2020 (54.7 përqind në vitin 2019), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezultoi me 50.1 përqind (50.8 përqind në vitin 2019). Sipas sektorëve, koncentrimi është më i lartë tek sektori i sigurimeve ‘jetë’, kjo si rezultat i numrit më të vogël të operatorëve në këtë sektor.

Grafik 88. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 220.5 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 12.2 përqind (grafik 88). Asetet e siguruesve ‘jo-jetë’ u rritën për 12.7 përqind, përderisa asetet në kuadër të siguruesve ‘jetë’ shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind.


Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Pozicioni tjetër me rritjen më të lartë ishte investimi në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Kurse, pozicioni i investimeve në prona, paraja e gatshme dhe depozitat në BQK shënuan rënie krahasuar me vitin e kaluar.

Struktura e investimeve të siguruesve është e koncentruar vetëm në investime brenda vendit. Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës rritën peshën në investimet e industrisë së sigurimeve në 16.1 përqind në vitin 2020, nga 14.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 89).

intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁵⁰ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.


Grafik 89. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve (dhjetor 2020)



Burimi: BQK.

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike vazhdojnë të jenë kategoria dominuese (grafik 90). Në vitin 2020, rezervat teknike shënuan rritje vjetore prej 7.6 përqind, kryesisht të ndikuar nga rritja vjetore prej 10.3 përqind e rezervave për primet bruto. Rezervat për dëmet bruto shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind.

Grafik 90. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2020)



Burimi: BQK.


Kapitali i sektorit të sigurveve shënoi rritje të theksuar, prej 26.1 përqind, duke arritur në 59.7 milionë euro në fund të vitit 2020. Rritja e kapitalit i atribuohet kryesisht rritjes prej 7.1 milionë euro të kapitalit aksionar të paguar, i cili në fund të vitit arriti vlerën në 91.3 milionë euro. Ndikim në rritje, por në masë më të ulët kishte dhe fitimi i realizuar gjatë vitit. Kurse, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite, prej 43.6 milionë euro, kishte efekt negativ në rritjen e mëtejme të gjithëj kapitalit të sigurimeve.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurvezit në vitin 2020 arriti në 99.3

milionë euro, duke ruajtur nivelin e arkëtimeve të vitit të kaluar (rritje vjetore prej vetëm 0.1 përqind).

Vlera e primeve të shkruara nga sigurvezit në vitin 2020 arriti në 99.3 milionë euro, duke ruajtur nivelin e arkëtimeve të vitit të kaluar (një rritje vjetore prej vetëm 0.1 përqind).

Grafik 91. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK.

Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 96.4 përqind të gjithëj primeve të shkruara (grafik 91). Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jojetë” arriti në 95.7 milionë euro, ngjashëm me vitin e kaluar. Përhapja e pandemisë Covid-19 në masë të madhe ka ndikuar në pothuajse përgjysmim të numrit të polisave të shitura, veçanërisht polisave kufitare. Mirëpo, rritja e çmimeve të primeve për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palës së tretë në fund të vitit 2019 ka ndikuar në ruajtjen e nivelit të përgjithshëm të primeve të arkëtuara gjatë vitit 2020, pavarësisht rënies së numrit të polisave të shitura. Sigurimet “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 62.3 përqind në gjithëj bruto primet e shkruara “jojetë”, ndërsa sigurimet vullnetare përbëjnë 37.7 përqind të gjithëj primeve të shkruara bruto “jojetë”.

Në vitin 2020, produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind, dhe pjesëmarrja e tyre në gjithëj primet “jojetë” shënoi rritje krahasuar me vitin paraprak. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve

të detyrueshme u ndikua kryesisht nga produktet “MTPL”. Ndërsa, sigurimet vullnetare shënuan rënie vjetore prej 5.9 përqind, njëkohësisht edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet “jojetë” shënoi ulje. Rënia e pjesëmarrjes së sigurimeve vullnetare në gjithsej primet e shkruara bruto “jojetë” u ndikua nga tkurrja e primeve për produktet

“Aksidenti dhe Shëndeti”, dhe “Kreditë dhe Garancionet” (tabela 9)

Kurse, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 3.6 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 3.5 përqind krahasuar me vitin 2019.

Tabela 9. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2019	2020	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2019	Pjesëmarrja: 2020
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	95.7	95.7	0.0%	96.5%	96.4%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	47.0	53.8	14.6%	47.3%	54.2%
TPL+	2.5	1.8	-29.8%	2.5%	1.8%
Sigurime kufitare	8.0	4.1	-48.3%	8.0%	4.1%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	19.6	16.4	-16.3%	19.8%	16.5%
Kasko	5.4	5.5	1.2%	5.5%	5.5%
Kredi dhe garancione	4.5	4.4	-2.1%	4.6%	4.5%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	5.3	6.1	14.8%	5.3%	6.1%
Përgjegjësi e përgjithshme	3.5	3.6	4.6%	3.5%	3.7%
<i>Gjithsej jetë</i>	3.5	3.6	3.5%	3.5%	3.6%
Gjithsej tregu	99.2	99.3	0.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Tabela 10. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2019	2020	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2019	Pjesëmarrja: 2020
<i>Gjithsej Jo-jetë</i>	47.2	45.1	-4.5%	98.5%	98.0%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	25.5	25.9	1.6%	53.3%	56.4%
TPL+	0.7	0.1	-86.1%	1.5%	0.2%
Sigurime kufitare	2.8	2.2	-21.3%	5.8%	4.8%
Marrëveshja MoU	0.4	0.3	-26.6%	0.8%	0.6%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	9.9	9.8	-1.1%	20.8%	21.4%
Kasko	3.1	3.2	0.8%	6.5%	6.9%
Kredi dhe garancione	0.8	1.8	123.8%	1.7%	3.9%
Sigurime në pronë	3.6	1.5	-58.5%	7.5%	3.2%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.3	0.3	-15.8%	0.7%	0.6%
<i>Gjithsej jetë</i>	0.7	0.9	25.6%	1.5%	2.0%
Gjithsej tregu	47.9	46.0	-4.1%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e sigurveve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rënie për 6.6 përqind, duke zbritur vlerën në 51.5 milionë euro nga 55.1 milionë euro në vitin 2019. Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 46.0 milionë euro (47.9 milionë euro në vitin 2019) ishin dëme të paguara nga

sigurveve, ndërsa 5.5 milionë euro (7.1 milionë euro në vitin 2019) dëme të paguara nga BKS-ja. Dëmet e paguara nga risigurveve marrin pjesë me 10.7 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga sigurveve (15.5 përqind në vitin paraprak). Masat kufizuese të lëvizjes brenda vendit dhe mbyllja e aktiviteteve ekonomike joesenciale ndikuan në rënien e dëmeve të ndodhura dhe rrjedhimisht atyre të

paguara. Po ashtu, edhe ndalimi dhe masat kufizuese të hyrjeve / daljeve në territorin e Kosovës, kanë ndikuar që të zvogëlohet edhe numri i ardhjeve të bashkatdhetarëve, e që u reflektua në rënien e numrit të polisave të shitura kufitare.

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jojetë” zbriti në 45.1 milionë euro nga 47.2 milionë euro në vitin 2019. Kurse, shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet “jetë” u rrit në 902.2 mijë euro nga 718.3 mijë euro sa ishte në vitin 2019, përkatësisht rritje vjetore prej 25.6 përqind (tabela 10).

Rënia e nivelit të dëmeve të paguara në kuadër të sigurimit “jojetë” u ndikua si prej pagesave të dëmeve të sigurimeve vullnetare, ashtu edhe atyre të detyrueshme. Shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare zbriti në 16.6 milionë euro, rënie vjetore prej 7.0 përqind, e ndikuar kryesisht nga produkti “Zjarr dhe dëmtime tjera në pronë”. Kurse, dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme, që kanë edhe pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej portofolin e dëmeve të paguara, shënuan rënie më të ngadalësuar vjetore, prej 3.1 përqind, duke zbritur në vlerën 28.5 milionë euro.


Si rrjedhojë e zhvillimeve në të hyrat dhe shpenzimet e sektorit, përkatësisht nivelit të ngjashëm të primeve të arkëtuara dhe rënies më të theksuar të dëmeve të paguara, raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara u zvogëlua për 3.7 pikë përqindje, në 51.8 përqind (grafik 38).

6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Sektor i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 4.1 milionë euro, për dallim nga viti i kaluar ku kishte shënuar rezultat negativ financiar prej 4.7 milionë euro. Siguruesit “jo-jetë” shënuan fitime në vlerë prej 3.9 milionë euro, krahasuar me humbjet në vlerë prej 5.2 milionë euro gjatë vitit 2019. Ndërsa, siguruesit “jetë” realizuan fitim neto më të ulët, në vlerë prej 263.8 mijë euro krahasuar me 460.5 mijë euro fitim në vitin 2019. Rezultati pozitiv financiar i sektorit reflekton

rënien më të lartë të shpenzimeve, si rrjedhojë e uljes së nivelit të dëmeve të ndodhura (rënie vjetore për 9.1 përqind), dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative (rënie vjetore për 12.9 përqind). Në anën tjetër, të hyrat, që kanë burim kryesor nivelin e primeve të shkruara, mbetën në nivel pothuajse të ngjashëm me vitin e kaluar (për 97.7 mijë euro arkëtime më shumë se në vitin 2019).

Grafik 92. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Raporti i kombinuar i sektorit gjithashtu pasqyron përmirësimin e pozitës financiare. Në dhjetor 2020, ky raport qëndroi në 97.6 përqind, duke reflektuar raportin e dëmeve ndaj primeve të fituara neto prej 53.3 përqind dhe raportin e shpenzimeve ndaj primeve të fituara neto prej 44.4 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat prej investimeve. Sipas këtij raporti, tregu i sigurimeve për 1 euro të fituar ka shpenzuar 0.976 euro.


Sektor i rriti nivelin e likuiditetit krahasuar me gjendjen në fund të vitit të kaluar. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike qëndroi në nivel prej 102.9 përqind (96.6 përqind në vitin 2019), si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 14.7 përqind, krahasuar me rritjen më të ulët prej 7.6 përqind të rezervave teknike. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u rrit gjithashtu, në 89.1 përqind nga 83.8 përqind në vitin 2019.

6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes së aktivitetit kundrejt viteve paraprake, që i'u atribua aktivitetit kreditor dhe të lizingjeve. Ngadalësimi i rritjes së asetëve të sektorit mikrofinanciar është kryesisht rezultat i revokimit të licencës së dy institucioneve mikrofinanciare.⁵¹ Ecuria e aktivitetit të sektorit mikrofinanciar është ndikuar edhe nga efektet negative të pandemisë Covid-19 në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend.

Grafik 93. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Sektori mikrofinanciar kryesisht financohet nga huazimet nga sektori i jashtëm, përderisa aktivitetet që financon ky sektor janë kreditimi i ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare (sektorit privat), dhe aktiviteti i lizingjeve për këto dy kategori. Përhapja e pandemisë Covid-19 ka ndikuar në rënie të ritmit të rritjes së aktivitetit të lizingjeve dhe tkurrje të kredive aktive, për herë të parë në shtatë vitet e fundit për këto të fundit.


Asetet e sektorit arritën vlerën prej 316.2 milionë euro në vitin 2020, që korrespondon me një rritje vjetore prej 2.1 përqind, e që paraqet nivelin më të ulët të rritjes në gjashtë vitet e fundit. (grafik 93). Në tregun vendor operojnë 20 institucione mikrofinanciare,⁵² nga të cilat 12

⁵¹ Pasqyrat financiare të këtyre institucioneve do të reflektohet në pasqyrat financiare të sektorit deri në shlyerjen e gjithsej portfolios së kredive të pakthyera

kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 93.0 përqind të gjithsej asetëve të sektorit.

Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,487 pikë në vitin 2020, që paraqet rritje të lehtë të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,478 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e asetëve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u rrit në 56.1 përqind, nga 55.3 përqind sa ishte në vitin 2019, rritje që mund ti atribuohet deri në një masë revokimit të regjistrimit të dy institucioneve mikrofinanciare në vitin e kaluar.

Grafik 94. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar (dhjetor 2020)



Burimi: BQK.


Kreditë përbëjnë 64.8 përqind të gjithsej asetëve të sektorit. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha vazhdojnë të jenë lizingjet, me pjesëmarrje prej 18.1 përqind (grafik 94). Krahasuar me vitin paraprak, pesha e lizingjeve në gjithsej asetet e sektorit është rritur kundrejt rënies së peshës së kategorisë së kredive.

Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet, që përbëjnë 63.9 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbën 62.4 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Krahasuar me vitin e kaluar, financimi nga sektori i jashtëm u zvogëluar për 0.4 përqind, duke zbritur në vlerë prej 197.2 milionë euro në fund të vitit 2020. Rënia e financimit prej sektorit të jashtëm ndodhi për herë të parë në gjashtë vitet e fundit, duke

⁵² Këtu përfshihen edhe dhjetë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitetet të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.

ndërprerë ritmin e rritjes dyshifrore gjatë kësaj periudhe, e që reflekton rënien e kërkesës për financim të aktiviteteve të sektorit si rezultat i pandemisë Covid-19.

Grafik 95. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar në vitin 2020 zbritën në vlerën prej 205.0 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 6.8 përqind (rritje vjetore prej 19.6 përqind në vitin 2019). Zvogëlimi i kredive aktive, e që ndodhi për herë të parë në shtatë vitet e fundit nuk reflekton vetëm goditjet që ka marr sektori nga pandemia Covid-19, por dhe revokimin e licencës së dy institucioneve mikrofinanciare. Me rënie më të theksuar të kredive aktive u karakterizuan ekonomitë familjare, 9.2 përqind rënie kundrejt rritjes vjetore prej 21.9 në vitin 2019, krahasuar me korporatat jofinanciare të cilat shënuan rënie vjetore prej 1.9 përqind nga 15.3 përqind rritje vjetore në vitin 2019. Vlera e kredive për ekonomitë familjare zbriti në 134.4 milionë euro në fund të periudhës, përderisa për korporatat jofinanciare zbriti në 70.6 milionë euro. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ dominojnë strukturën e këtyre kredive, pasuar nga ato me maturim “mbi 1 deri 2 vite” (grafik 95).

Struktura e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare sipas veprimtarive ekonomike mbeti e ngjashme me periudhat paraprake. Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe në kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar, pasuar nga kreditë

e destinuar për sektorin e ndërtimtarisë, tregtisë dhe industrisë (grafik 96).


Grafik 96. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2020)



Burimi: BQK.

Situata e re e krijuar pas përhapjes së pandemisë Covid-19 ka ndikuar edhe ecurinë e kreditimit të pothuajse gjitha veprimtarive ekonomike që financojnë institucionet mikrofinanciare (grafik 97). Përrjashtuar kreditimin ndaj sektorit të ndërtimtarisë dhe industrisë që shënuan rritje, sektorët tjerë u karakterizuan me rënie vjetore të kreditimit.

Grafik 97. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK.

Kriza e paprecedent shëndetësore dhe ekonomike e shkaktuar nga pandemia Covid-19 ndikoi edhe aktivitetin e lizingjeve i cili shënoi ngadalësim të rritjes vjetore në 8.8 përqind nga 38.5 përqind vitin paraprak. Stoku i lizingjeve arriti vlerën në 57.3 milionë euro, (grafik 98). Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej lizingjeve e kishin lizingjet ndaj korporatave jofinanciare, të cialt kanë një pjesëmarrje prej 68.0 përqind në gjithsej lizingjet. Kjo kategori e lizingjeve shënuan rritje vjetore prej 11.7

përqind dhe arritën vlerën prej 31.4 milionë euro. Sipas maturitetit të lizingjeve për korporatat jofinanciare, pjesa më e madhe dominohet nga lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 75.5 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 1 deri në 2 vite’ me pjesëmarrje prej 17.7 përqind.

Grafik 98. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar




Kurse, lizingjet ndaj ekonomive familjare, shënuan rritje më të ngadalësuar prej 5.4 përqind, duke arritur në 25.9 milionë euro në fund të vitit 2020. Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, ‘lizingu hipotekar’, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënoi rritje vjetore prej 6.3 përqind në vitin 2020 (15.7 përqind rritje vjetore në vitin e kaluar).

Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 51.8 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 32.2 përqind.

Normat e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në përgjithësi nuk kishin ndryshime të theksuara krahasuar me vitin e kaluar. Mesatarja e normës së interesit për kredi zbriti në 20.3 përqind nga 20.5 përqind sa ishte në dhjetor 2019 (grafik 99). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizua sektori i korporatave jofinanciare, kurse normat e interesit në kreditë për ekonomitë familjare kishin tendencë të rritjes.


Grafik 99. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit në 21.6 përqind në fund të vitit 2020. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare u zvogëlua në 18.3 përqind (grafik 99). Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, norma mesatare e interesit u zvogëlua për sektorin e bujqësisë dhe industrisë, ndërsa u rrit për sektorin e shërbimeve, që ka normën më të favorshme të interesit. Kurse, kreditë për sektorin e industrisë vazhdojnë të kenë normën më të lartë të interesit prej 20.3 përqind përkundër rënies prej 1.2 pikë përqindje nga viti i kaluar (grafik 100).

Grafik 100. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK.

6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi fitim dukshëm më të ulët krahasuar me trendin e pesë viteve të kaluara. Në vitin 2020, sektori realizoi fitim në vlerë prej 0.3 milionë euro, e që është dukshëm më i ulët se fitimi i realizuar prej 9.3 milionë euro në vitin e

kaluar. Rënia më e përshpejtuar e të hyrave krahasuar me rënien e shpenzimeve ka ndikuar në ulje të theksuar të fitimit (grafik 101).


Grafik 101. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Të hyrat e sektorit mikrofinanciar zbritën në vlerën prej 45.6 milionë euro, një rënie për 20.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave nga interesi në kredi, e që reflekton tkurrjen e aktivitetit kredidhënës gjatë vitit 2020. Shpenzimet e sektorit zbritën në vlerën 45.3 milionë euro, e që parqet rënie vjetore prej 6.0 përqind. Rënia e shpenzimeve erdhi si rezultat i reduktimit të shpenzimeve për interesa, si rrjedhojë e zvogëlimit të huazimeve nga sektori i jashtëm (që në vitet e fundit kishte shënuar rritje të theksuar), dhe uljes së shpenzimeve tjera operative.

Grafik 102. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Kurse, kategoria e vetme që shënoi rritje ishte ajo e shpenzimeve të jointeresit, e që reflekton nivelin më të lartë të provizionimit për humbjet e mundshme nga kreditë.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar rritje të theksuar, për 15.4 pikë përqindje, si rrjedhojë e rënies më të lartë të të hyrave kundrejt rënies më të ngadalësuar të shpenzimeve. Në vitin 2020, ky indikator qëndroi në 99.3 përqind, nga 83.9 përqind në vitin paraprak.


Rezultatet financiare gjatë vitit 2020 u reflektuan dhe në treguesit tjerë të profitabilitetit të sektorit, të cilat shënuan rënie të konsiderueshme krahasuar me periudhën e kaluar. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) qëndroi në nivel prej 0.1 përqind (3.2 përqind në vitin 2019), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 0.4 përqind (13.7 përqind në vitin 2019) (grafik 102).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe mbulueshmëri të mirë me provizione (grafik 103). Niveli i kredive joperformuese në vitin 2020 qëndroi në 3.0 përqind (2.6 përqind në vitin 2019), përderisa mbulueshmëria e tyre me provizione arriti në 142.2 përqind (117.0 përqind në vitin 2020).

Sektori i ndihmësve financiar përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.2 përqind të gjithsej asetëve. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Vlera e asetëve të ndihmësve financiar në vitin 2020 arriti në 18.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.2 përqind. Të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rritje vjetore prej 20.0 përqind dhe arritën vlerën në 10.0 milionë euro.

Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 76.1 përqind), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 34.1 përqind.

Grafik 103. Treguesite e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK.

Shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 10.9 përqind, duke arritur vlerën në 5.6 milionë euro. Neto fitimi i realizuar nga këto institucione financiare në vitin 2020 arriti në 4.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 34.2 përqind.

Rritja e aktivitetit të sektorit, që u reflektua në të hyrat dhe fitimin e realizuar gjatë vitit 2020, është ndikuar nga dinamikat e ndërlidhura me pandeminë Covid-19. Mbyllja e kufijve tokësor dhe ajror të cilat pamundësuan ardhjen e mërgatës si dhe rënduan gjendjen ekonomike të popullatës, ndikuan që mërgata të risë ndihmat ndaj familjarëve përmes kanaleve formale. Si rezultat, remitencat arritën vlerë rekorde prej pothuajse 1.0 miliard euro, pjesa më e madhe e të cilave u dërguan përmes ATP-ve, duke ndikuar në rritjen e aktivitetit të tyre.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Sistemi i pagesave luan rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tij paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Gjatë vitit 2020, në përballje me krizën e pandemisë Covid-19, sfidën më të madhe ndonjëherë të përjetuar nga sistemi financiar i Kosovës, sistemi i pagesave ka dëshmuar qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë në përmbushje të funksionit të tij. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës së pandemisë, sistemi i pagesave, pavarësisht kufizimit të lëvizjes dhe ndryshimit të orareve të punës së pjesëmarrësve, ka qenë vazhdimisht aktiv dhe i qasshëm për pjesëmarrësit, duke siguruar procesimin dhe shlyerjen pa pengesa të të gjitha transaksioneve të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe qeverisë. Kjo ka dëshmuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit edhe në kushte të operimit nga distanca. Gjithashtu, është dëshmuar se sistemi i pagesave ofron fleksibilitetin e nevojshëm për nevojat specifike të pjesëmarrësve, si rritja e numrit të sesioneve të kliringut dhe bashkëpunimit, për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e hershëm të problemeve të mundshme.

Regjistri i Llogarive Bankare, sistem ky i mirëmbajtur nga BQK, në të cilin regjistrohen të gjitha llogaritë bankare nga ana e bankave, gjithashtu është dëshmuar efikas gjatë kësaj periudhe, duke ndihmuar institucionet në pagesën e lehtë dhe të sigurt të mjeteve në kuadër të masave emergjente fiskale të ndërmarra nga qeveria, si dhe masës së tërheqjes së 10 përqind të kursimeve

pensionale në kuadër të planit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Situata pandemike ka ndikuar kryesisht zhvillimet në tremujorin e dytë të vitit, përkatësisht periudhen mars – maj 2020. Gjatë kësaj periudhe, është vërejtur një rënie e konsiderueshme e volumit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara, me nivelin minimal të arritur në muajin prill, kur numri i transaksioneve ka pësuar rënie rreth 36 përqind, me rënie në vlerë prej rreth 33 përqind. Kjo rënie ka filluar rikuperimin në muajin maj dhe ka arritur afër nivelit të trendit të zakonshëm përgjatë qershorit, kur edhe janë lehtësuar në masë të madhe masat kufizuese të ndërmarra nga qeveria. Kurse, në dhjetor numri i transaksioneve të procesuara ka shënuar rritje për 45.3 përqind ndërsa vlera e tyre rritje prej 15.9 përqind, që reflekton ndër tjerash tërheqjen e 10 përqind të mjeteve të kursimeve pensionale nga qytetarët.

Numri i transaksioneve të përpunuara nga SPN në vitin 2020 arriti në 13.0 milionë (12.4 milionë në vitin 2019), që përbën një rritje vjetore prej 4.7 përqind (8.1 përqind në vitin paraprak). Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara zbriti në 14.0 miliardë euro (14.1 miliardë euro në vitin 2019), që paraqet një rënie vjetore prej 1.0 përqind (rritje vjetore prej 9.1 përqind në vitin 2019). Pagesat e rregullta masive dhe pagesat prioritare masive përfaqësuan rreth 79.2 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 11). Pagesat prioritare masive përfaqësojnë rreth 6.1 milionë transaksione të realizuara (46.8 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Kurse, pagesat masive të rregullta, përfaqësojnë rreth 4.2 milionë transaksione të realizuara (apo 32.4 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj. Ndërsa 0.6 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 11).

Tabela 11. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2019	2020	2019	2020
Të rregullta	12.9%	12.5%	10.9%	10.8%
Prioritare	3.2%	3.4%	39.5%	38.4%
Të rregullta - masive	39.3%	32.4%	5.8%	5.3%
Prioritare - masive	39.1%	46.8%	8.4%	11.7%
Pagesat xhiro	5.2%	4.6%	8.6%	7.8%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	5.2%	5.8%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.0%	0.0%	21.5%	20.0%
Te kthyera	0.3%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK.

Sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, kategori që arriti vlerën në 5.38 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 2.81 miliardë euro deri në fund të vitit 2020. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁵³ në vitin 2020 arriti në 2.29 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 përqind. Në rritjen e numrit të llogarive bankare ka ndikuar edhe tërheqja e parakohshme e 10 përqind të kursimeve pensionale, realizimi i së cilës është kushtëzuar të bëhet vetëm përmes llogarive bankare aktive në bankat e regjistruara në Kosovë.

Trendi i shpejtë dhe i sigurtë i zhvillimit të infrastrukturës virtuale ka vazhduar, i nxitur edhe nga rrethanat e krijuara nga gjendja pandemike. Bankat kanë rritur përpjekjet e

përgjithshme për digjitalizim dhe automatizim të shërbimeve, në funksion të ofrimit të mundësive për realizim të shërbimeve duke ruajtur shëndetin e klientëve. Shumica e bankave kanë rritur limitin e pagesave pa kontakt që mund të bëhet përmes kartelave bankare. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar rritjen. Deri në fund të vitit 2020, numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 411.3 mijë⁵⁴ (tabela 12), që paraqet një rritje vjetore prej 21.8 përqind. Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 86.8 përqind të gjithsej llogarive E-banking, pasuar nga ato afariste me pjesëmarrje prej 13.2 përqind.

Tabela 12. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020
Numri i degëve bankare	45	46	47	50
Numri i nëndegëve bankare	183	166	159	149
Numri i ATM-ve	512	491	497	513
Numri i POS-ve	11,501	13,183	13,769	13,421
Numri i llogarive 'e-banking'	301,841	250,733	337,693	411,346

Burimi: BQK.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u

rrit për 6.5 përqind. Numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje vjetore prej 8.4 përqind dhe arriti në 1,201,902, kurse me

⁵³ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

⁵⁴ Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të numrit të llogarive të qasshme (aksessueshme) nga interneti.

Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

funksion krediti shënoi rënie 5.2 përqind dhe zbriti në 175,205.

Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat Visa (55.4 përqind) pasuar nga ato Master Card (41.6 përqind), kurse kartelat lokale kishin një pjesëmarrje prej 3.0 përqind. Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar

në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM), kurse në kontekst të numrit të paisjeve POS (angl. Point-of-Sale) është zvogëluar krahasuar me periudhën paraprahe. (tabela 13).

Tabela 13. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020
ATM tërheqje në para të gatshme	61.9%	58.9%	59.5%	62.7%
ATM depozitime	29.3%	30.9%	29.9%	27.3%
Kredit transfere nëpërmjet ATM	0.0%	0.1%	0.1%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%
Pagesa me kartela në terminale POS	8.5%	9.8%	10.3%	9.8%

Burimi: BQK.

Numri i depozitimeve në sektorin bankar përmes ATM-ve gjatë kësaj periudhe arriti në 2.0 milionë transaksione në vlerë prej 1.25 miliardë euro. Si rrjedhojë, 27.3 përqind nga gjithsej vlera e transaksioneve me kartela përmes terminaleve ishin të ATM-ve me funksion depozitimi (tabela 13).

Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në terminalet POS arriti në 14.3 milionë në vlerë prej 447.8 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2020 kishte një pjesëmarrje prej 9.8 përqind.

8. Korniza për Makroprudencë

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë.

Me qëllim të përforcimit të bazës ligjore të BQK-së në ushtrimin e mandatit për makroprudencë, draft ligji i ri për banka që pritet të procedohet për aprovim, përcakton BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale të bankave. Gjithashtu, ligji i ri i jap autoritet BQK-së të nxjerrë instrumente rregullative përkatëse.

8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës

Në vitin 2020, dinamikat e përgjithshme në tregues të zgjedhur të makroprudencës në Kosovë u karakterizuan me qëndrueshmëri, duke rezultuar në parametra lartë mbi kërkesat rregullative, pavarësisht përballjes me pandeminë Covid-19.

Ndërmjetësimi financiar në vend vazhdon të zgjerohet, konkretisht, rritja e kreditimit, edhe pse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën paraprahe. Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar vazhdoi të jetë në nivel të lartë, edhe pse ka shënuar tendencë të rritjes në vitin e fundit, pas shfaqjeve të pandemisë Covid-19. Pjesëmarrja e kredive jo-performuese (KJP) ndaj gjithsej kredive ka shënuar rritje marginale, por krahasuar me nivelin e vendeve të rajonit, Kosova ka nivelin më të ulët të KPJ-ve në rajoni dhe nën mesataren e Bashkimit Evropian. Krahas cilësisë së mirë të portofolit kreditor, edhe niveli i mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione është në nivel të lartë.

Sektorit bankar në tërësi por edhe bankat sistemike në veçanti vazhdojnë të mbeten mirë të kapitalizuara dhe likuide gjatë kësaj periudhe. Raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar dhe bankat sistemike qëndrojnë lartë mbi kërkesat

rregullatore. Kapitalizimi i mirë i sektorit bankar mbështetet edhe nga analiza e alokimit të kapitalit shtesë në raport me shkallën e rëndësisë sistemike të bankave.

Ngjashëm me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti i levës së gjithsej sektorit bankar dhe i bankave me rëndësi sistemike vazhdoi të mbetet mbi kërkesat minimale ligjore. Indikatorët e likuiditetit ishin në nivel të kënaqshëm, në veçanti raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta që ishte mbi kërkesat rregullative. Koncentrimi i ekspozimeve të mëdha në sistem bankar edhe pse kishte tendencë të rritjes, nuk është në nivel të lartë.

Treguesit e profitabilitetit, në veçanti Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), qëndroi në nivel të kënaqshëm, përderisa hendeku Kredi/BPV (anglisht: *credit to GDP gap*), megjithëse është zgjeruar në vitin 2020, sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron. Në vitin 2020, sektori bankar rezultoi të ketë pesë banka me rëndësi sistemike.

Edhe analiza e përgjithshme e treguesve të shëndetit të sektorit të sigurimeve, si indikatorë potencialisht të rëndësishëm për makroprudencën, sugjerojnë që stabiliteti financiar i Kosovës nuk kërcënohet nga sektori i sigurimeve, marrë parasysh peshën e vogël të sektorit në sistem financiar. Gjithashtu, ndërlidhja në mes të sektorit të sigurimeve dhe atij mikrofinanciar dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve ndërmjet segmenteve të ndryshme të sistemit financiar të Kosovës.

8.2. Kapitali shtesë kundërciklik

Kapitali shtesë kundërciklik ka për qëllim forcimin e stabilitetit financiar përmes mbrojtjes së sektorit bankar ndaj humbjeve që mund të shkaktohen nga akumulimi i rrezikut sistematik ciklik në një ekonomi, si dhe përmes ndikimit në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofertës kreditore përgjatë gjithë ciklit

financiar. Kapitali shtesë kundër-ciklik është pjesë e kornizës rregullative të Bazeli III dhe njëherit një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar dimensionin ciklik të rrezikut sistemik.

Duke rritur kërkesat për kapital në kohën kur kreditimi është në fazën e rritjes përtej fundamentaleve të ekonomisë (rritet në shpejtësi më të madhe se sa bruto prodhimi i një vendi dhe perceptohet si rritje e tepërt e kreditimit), ky instrument synon rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit (solvencës së bankave) për të përballuar situatat e stresit financiar që mund të pasojnë nga akumulimi i rrezikut si rezultat i rritjes së tepërt të kreditimit. Njëherit, ky instrument ndihmon që në periudha të stresit financiar të nxisë kreditimin, përmes liritimit të rezervave të kapitalit të akumuluar gjatë fazës së rritjes së kreditimit dhe kushteve të mira ekonomike, me qëllim të evitimit të bartjes së pasojave negative të rënies së kreditimit në gjithsej sistemin financiar dhe ekonominë e vendit.

Për llogaritjen e kapitalit shtesë kundër-ciklik, udhëzimet e Komitetit për Mbikëqyrje Bankare të Bazelit⁵⁵ sugjerojnë monitorimin e disa parametrave për vlerësimin nëse kreditimi është duke u rritur përtej fundamentaleve të qëndrueshme dhe rrjedhimisht është duke ndikuar në akumulimin e rrezikut sistemik. Krahas vlerësimit të parametrave sipas udhëzimeve përkatëse, autoritetet relevante duhet të gjykojnë relevancën e aplikimit të kërkesave kundër-ciklike të kapitalit.

BQK, në Politikën për Makroprudencë⁵⁶, liston instrumentin e kërkesave kundër-ciklike të kapitalit si instrument të mundshëm të objektivitetit të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale për zvogëlimin dhe parandalimin e rritjes së tepruar të kredive dhe të levës. Konform udhëzimeve të Bazelit, parametri kryesor për përcaktimin e normës së Kapitalit shtesë kundër-ciklik theksohet të jetë hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit

vendor (BPV) në Kosovë, krahas tregueseve të tjerë relevant që do të informojnë vendimin përfundimtar për aktivizimin e mundshëm të instrumentit.

Në vijim, paraqitet i ashtuquajtur i model për vlerësimin e kërkesës për kapital kundër-ciklik për sektorin bankar të Kosovës. Devijimi i raportit të kreditimit ndaj BPV-së nga trendi i tij afat-gjatë paraqet parametrin kryesor të modelit. Llogaritja e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së bëhet duke u mbështetur në udhëzimet e Bazelit si dhe praktikatat e unifikuara të mënyrës së kalkulimit nga shumica e vendeve në botë të bazuara në rekomandime nga hulumtimet empirike, përmes filterit të njëanshëm Hodrik-Prezcott (parametri zbutës 400,000).

Në kreditim janë përfshirë kreditë ndaj sektorit privat⁵⁷ nga bankat si dhe institucionet financiare jo bankare. Këto të fundit, megjithëse në pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin, janë duke u rritur më normë të lartë të rritjes dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen në sektorë të caktuar. Andaj, përfshirja e kredive të sektorit jo bankar përkundër që ka pjesëmarrje të ulët dhe aktualisht pa ndonjë efekt të theksuar në rezultat të hendekut të kreditimit, siguron konsistencë në mënyrën e llogaritjes me vendet tjera, si dhe siguron që të përfshihen efektet e rritjes së mundshme të peshës së kreditimit ndaj sektorit privat nga institucionet financiare jo bankare. Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së në Kosovë në vitin 2020 qëndroi në 50.5 përqind. Rezultatet e hendekut të kreditimit në fund të dhjetorit 2020 sugjerojnë që sektori privat në Kosovë ka kaluar në të ashtuquajturën periudhë të ‘mbi kreditimit’. Periudha e ‘mbi kreditimit’ ka filluar që nga tremujori i tretë i vitit 2020, e që është kryesisht si rrjedhojë e tkurrjes ekonomike në vitin 2020 (për shkak të pandemisë Covid-19), përderisa kreditimi ka ruajtur ritmin pozitiv të rritjes.


⁵⁵ Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit, dhjetor.

⁵⁶ BQK (2018). *Politika për Makroprudencë, Prishtinë, qershor*.

⁵⁷ Mospërfshirja e kredive të sektorit publik dhe kredive ndaj ndërmarrjeve financiare në llogaritjen e hendekut të kreditimit siguron që dinamikat në kreditim nuk ndikohet nga ndryshime të mundshme në kreditimin e sektorit publik apo sektorin financiar.

Si rrjedhojë, në vitin 2020, hendeku i kredisë ndaj BPV-së rezulton në 2.767 përqind, më i zgjeruar në rrafshin pozitiv krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (+0.168 përqind) (grafik 104).

Grafik 104. Hendeku i kreditimit




Zgjerimi pozitiv i hendekut të kredisë ndaj BPV-së në periudhat e fundit nënkupton që kreditimi është duke u rritur me ritëm më të shpejtë kundrejt bruto produktit vendor. Mirëpo, në rastin e Kosovës, rritja e theksuar e kreditimit në vitet e fundit krahasuar me ritmin e rritjes së BPV-së nuk duhet të konsiderohet që të jetë në nivel të tepruar. Kjo për faktin që sistemi financiar në Kosovë është ende në fazë të hershme të zhvillimit dhe ekonomia e Kosovës është në fazën e rritjes së ndërmjetësimit financiar dhe konvergimit me vendet tjera; si dhe historiku i shkurtër i sektorit bankar me njëtrajtshmëri të zhvillimeve financiare, pa ndonjë periudhë të stresit, e vështirëson vlerësimin adekuat të ciklit të kreditimit në vend dhe të sinjalizimit të akumulimit të rrezikut sistemik. Rrjedhimisht në dhënien e një vlerësimi gjykues të ciklit kreditues duhet patjetër të konsiderohen edhe indikatorët e tjerët financiar dhe ekonomik, dhe në veçanti gjykimi i ekspertëve. Megjithatë, kapitali shtesë kundër-ciklik përbën instrument adekuat, për adresimin e hendekut të kredisë, me qëllim të përforcimit të aftësisë përballuese të sektorit bankar ndaj cikleve financiare.

Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është bërë sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç ‘rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të aseteve të peshuara me rrezik)

është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind. Sipas rezultateve të dhjetorit 2020, është paraqitur nevoja për kërkesë të mundshme të kapitalit kundër-ciklik (grafik 104). Nëse rritet hendeku mbi 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet kapital shtesë deri në nivelin maksimal prej 2.5 përqind. Por duke marrë parasysh që jemi në kushte të jashtëzakonshme, për shkak të pandemisë Covid-19, nuk kemi realisht periudhë “të mbikreditimit”, por tkurrje të paprecedent ekonomike në vend, përderisa kreditimi vazhdon të rritet – edhe pse me ritëm më të ngadalësuar se në vitin 2019 (grafik 105).

Grafik 105. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Po ashtu, indikatorë tjerë relevant monitorohen në baza të rregullta krahas hendekut të kreditimit, të cilëve së bashku me informacionet kualitative dhe gjykimin e ekspertëve relevant, iu alokohet peshë e veçantë në formimin e gjykimit përfundimtarë rreth zhvillimeve në fushën e rrezikut sistemik dhe raportit të kredisë ndaj BPV-së. Këta indikatorë, ndër tjera, përfshijnë dinamikën e rritjes kreditore të përgjithshme dhe rritjen në sektorë specifik, ekspozimet kreditore në sektorë të veçantë, raportin e kredisë ndaj kolateralit, raportin e borxhit ndaj të hyrave, etj.

8.3. Bankat me rëndësi sistemike

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për

vlërësimin e vazhdueshëm të dimensionit strukturor dhe ndër-sektorial të rrezikut sistemik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike (tabela 14). Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit


dhjetor 2020, sugjerojnë që pesë banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike, ngjashëm me vitin e kaluar (grafik 106).

Tabela 14. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë⁵⁸

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 25%)	Asetet (pa provizione)
Zëvendësueshmëria (pesha 25%)	Vlera e transaksioneve në raport me gjithsej vlerës së transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 25%)	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (pesha 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK.

Grafik 106. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK.

Të pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret përbërëse (tabela 14). Kurse, bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike, nuk kanë rezultuar të tilla në asnjërin prej indikatorëve. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,283 pikë bazë deri në 2,120 pikë bazë. Kjo paraqet rënie të lehtë të shkallës më të ulët të rëndësisë sistemike (rënie për 22 pikë bazë), kurse shkalla e sipërme sistemike mbeti pothuajse e ngjashme me vitin e kaluar (rritje për 5 pikë bazë).

Në përgjithësi, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike, kanë rritur shkallën e pikëve sistemike, kundrejt rënies së shkallës së pikëve të bankave që nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike në vitin 2020 kundrejt vitit paraprak.

Kjo rritje e pikëve të bankave të rëndësisë së përgjithshme sistemike ishte e shprehur vetëm në indikatorin e ndërlidhjes, në të cilin kishte diferencë mjaftë të lartë të pikëve bazë. Përderisa në indikatorët tjerë, atë të madhësisë, zëvendësueshmërisë, dhe aktivitetit ndërshtetëror & kompleksitetit; kishte rritje të shkallës së pikëve tek bankat e rëndësisë josistemike, kundrejt rënies së shkallës në bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike. Mirëpo diferenca në pikë bazë ishte mjaftë e ulët.

Kriteri i madhësisë –


Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,272 pikë bazë në 2,139 pikë bazë. Katër nga pesë bankat me rëndësi sistemike u karakterizuan me rënie të

⁵⁸ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull

'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

rëndësisë sistemike në këtë kriter krahasuar me periudhën paraprake (grafik 107).


Grafik 107. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK.

Kriteri i zëvendësueshmërisë – Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,125 pikë bazë në 2,351 pikë bazë (grafik 108).

Grafik 108. Kriteri i zëvendësueshmërisë




Burimi: BQK.

Shumica e bankave kanë shënuar rritje të shkallës sistemike në këtë kriter krahasuar me periudhën e kaluar, por që ishte më e theksuar tek bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kjo u reflektua në të gjitha nënkategoritë përkatëse. Në përgjithësi, shkalla e agreguar e pikëve tek bankat josistemike shënoi rritje kundrejt rënies së agreguar të pikëve tek bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike. Kjo dinamikë u vu re në nënkategoritë e kreditimit për korporatat jofinanciare dhe ekonomive familjare, depozitave prej ekonomive familjare, si dhe pjesëmarrjes në transaksionet ndërbankare - ku u shënuar rritje më e përshpejtuar tek

bankat e vogla krahasuar me ritmin e rritjes tek bankat e mëdha.

Kriteri i ndërlidhjes – Ky kriter karakterizohet me luhatjet më të mëdha ngase bankat mund të ndërrojnë me lehtësi bilancin e tyre ndaj institucioneve financiare, si dhe investimet në letrat me vlerë.

Grafik 109. Kriteri i ndërlidhjes



Burimi: BQK.

Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,053 pikë bazë në 2,841 pikë bazë (grafik 109). Bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike rritën shkallën e pikëve konsiderueshëm kundrejt rënies së shkallës së pikëve tek bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit më të theksuar me bankat dhe institucionet financiare nga bankat e mëdha, krahasuar me nivelin më të ulët të ndërveprimit prej bankave të vogla.


Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit – Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,101 pikë bazë në 2,768 pikë bazë (grafik 110).

Krahasuar me periudhën paraprake, shkalla e rëndësisë sistemike ka shënuar rënie kundrejt rritjes së shkallës nga bankat josistemike. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit më të lartë me sektorin e jashtëm nga bankat jo-sistemike krahasuar me ndërveprimin prej bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike.

Në përgjithësi, duhet theksuar se sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike, mbi kapitalin e klasit të parë siç rekomandohet nga

Bazel dhe ABE, nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit rregullator të sektorit bankar në Kosovë.

Grafik 110. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Andaj, modeli aktualisht shërben vetëm për monitorimin e dinamikës së rëndësisë sistemike dhe mbikëqyrjen më të informuar dhe adekuate të institucioneve konform rëndësisë së tyre sistemike, dhe nuk paraqet rekomandim për aplikim të shtesës së kapitalit për institucione me rëndësi sistemike vendore.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

9. Shtojca Statistikore

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Figura 2. Ekonomia e brendshme




Figura 3. Ekonomitë familjare






Figura 4. Sektori i ndërmarrjeve




Burimi: BQK.

Figura 5. Sektori qeveritar




Burimi: BQK.

Figura 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK.

Figura 7. Kapitalizmi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK.

Figura 8. Lkuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK.

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut	18.1	17.0	15.9	16.5
	Kapitali i klasit të parë ndaj aseteve të peshuara ndaj riskut	16.2	15.5	14.2	14.7
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	1.2	1.5	1.5	4.5
Cilësia e aseteve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	3.1	2.5	1.9	2.5
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.2	0.2	0.2	0.2
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	63.6	63.4	63.3	63.3
	Ekonomitë familjare	36.2	36.3	36.4	36.4
	QUSHEF	0.01	0.01	0.03	0.03
	Jo-rezidente	0.0	0.0	0.0	0.1
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
	Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)*	2.8	2.3	2.1
Kthimi në kapital (KNK)*	22.1	18.3	17.2	14.0	
Margjina e interesit ndaj te hyrave bruto	65.1	78.4	80.6	79.2	
Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	45.3	48.2	48.1	46.1	
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të aseteve	25.4	29.0	28.8	30.1
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të aseteve	30.1	23.8	23.3	23.2
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	32.2	32.2	31.2	31.1
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	37.9	38.5	37.6	39.8
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	1.2	3.8	4.7	3.5
Grupi i zgjeruar i indikatorëve					
	Kapitali ndaj aseteve	12.6	12.2	11.2	11.7
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	81.7	65.9	81.8	89.5
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	40.3	44.0	43.5	43.3
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	5.5	4.5	4.8	4.7
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	119.5	122.8	129.2	133.9
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	3.9	5.0	4.4	4.2

*Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org